



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8 DHE 15 MARS 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 8. I 15. MARTA 2018. GODINE**

**MARS - MART
2018**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional

Dnevni red

2. Parlamentarna debata protiv nasilja u porodici i institucionalnom adresiranju

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra në Kabinetin qeveritar,

Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë.

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2018.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të fillojmë me rendin e ditës, më lejoni që ne emrin tuaj dhe në emrin tim personal të gjitha grave t'ua uroj 8 Marsin- Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Urime!

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Siç mund ta shihni, sot jemi veshur ndryshe nga ditët e zakonshme, secili prej deputetëve ka një bluzë me një luledielli, e cila simbolizon fushatën e nisur nga organizata “Ti je një luledielli”, që udhëhiqet nga zonja Albana Osmani, të cilën sot e kemi këtu dhe e falënderojmë për këtë iniciativë humane, e cila ka për qëllim ndihmën e fëmijëve të Kosovës që vuajnë nga sëmundjet e gjakut, leukemia dhe kanceri.

1. Debat parlamentar lidhur me dhunën në familje dhe adresimin institucional

Të nderuar deputetë,

Deputetja Fatmire Kollçaku, e mbështetur edhe nga tetë deputetë nënshkrues nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka kërkuar debat parlamentar lidhur me dhunën në familje dhe adresimin institucional.

E ftoj zonjën Fatmire Kollçaku, që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

FATMIRE KOLLÇAKU: Të nderuara kolege deputete,

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Dhe ju, qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,

E kemi vlerësuar se në këtë ditë të shënuar është e një rëndësie të veçantë të debatojmë lidhur me dhunën në familje dhe adresimin institucional.

Shteti është përgjegjës për veprimet e përfaqësuesve dhe qytetarëve të tij, duke përfshirë edhe dhunën në familje.

Se si duhet t'i përgjigjen shtetet dhunës në familje, është përcaktuar në parimet e përgjithshme të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.

Në rekomandimin e përgjithshëm numër 19 mbi dhunën ndaj grave, Komiteti i Konventës kërkon që shtetet duhet të ndjekin, me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesa, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundër grave.

Dhe gjithashtu të kenë kujdes për të parandaluar, për të hetuar dhe në pajtim me ligjin nacional të dënojnë aktet e dhunës kundër grave, pa marrë parasysh se a janë kryer këto vepra nga shteti a personat privatë.

Komiteti i Konventës në interpretimin e Konventës ka thënë se shtetet mund të jenë përgjegjëse për veprimet private, nëse ato kanë dështuar së vepruari me kujdes për të parandaluar shkeljen e të drejtave ose për të hetuar dhe për të dënuar aktet e dhunës dhe të ofrojnë kompensim.

Kur shpalli pavarësinë, shteti sovran, Kosova, miratoi disa detyrime ndërkombëtare dhe duke inkorporuar standarde ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si pjesë e të drejtës së saj të aplikueshme.

Kosova emëroi në mënyrë specifike konventën ndërkombëtare kundër eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokollet e saj të zbatueshme drejtpërdrejt në ligjet e Kosovës. Kosova hoqi dorë nga zbatueshmëria e ligjeve të saj dhe akteve të tjera të institucioneve publike të saj në rastet kur ato bien ndesh me dispozitat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kosova kështu i konsideron këto dispozita ndërkombëtare që të kenë prioritet mbi ligjet e Kosovës.

Më tej, Kushtetuta thekson: “Të drejtat e njeriut dhe liritë personale, themelore interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Kjo gjykatë ka nxjerrë disa vendim për rastet e dhunë në familje që mund të përdoren për përmirësimin e zbatimit të dispozitave ligjore në Kosovë.

Megjithatë, zbatimi praktik i këtyre klauzolave kushtetuese rrallëherë është përdorur në gjykatat e Kosovës.

Vetëm kohët e fundit Gjykata Kushtetuese e Kosovës iu referua Konventës në vendimin e saj të paprecedent në rastin e Diana Kastratit, duke deklaruar se vonesa për lëshimin e urdhrin të

mbrojtjes nga Gjykata Komunale në Prishtinë, e paraparë me Ligjin e Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje, përbën shkelje të të drejtave të njeriut. Kjo shkelje ka ndikuar në mbrojtjen e të drejtës së personit për jetën dhe të drejtën për mjete efektive të garantuar me Konventën Ndërkombëtare dhe Kushtetutën.

Në instanca të tjera, në kuadër të gjykatave dhe ligjit, dispozita kushtetuese për zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të dispozitave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk është dokumentuar sa duhet në Kosovë.

Dhuna në familje është akt që shkel të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut janë të drejta themelore, në të cilat ka të drejtë çdo qenie njerëzore.

Në instanca të tjera, në kuadër të gjykatave, të ligjit, dispozita kushtetuese për zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të dispozitave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk është dokumentuar sa duhet.

Janë bërë 10 vjet nga hyrja në fuqi e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, nga viti 2008 e deri më sot më shumë se 15 gra janë vrarë, mbi 20 mijë gra kanë raportuar dhunën në familje, ndërsa mbi 68% të grave kanë përjetuar dhunë në forma të ndryshme.

Jemi të sigurt që drejtësia për secilën grua është e stërvonuar, me vetë faktin se sa lëndë janë trajtuar nga ana e drejtësisë. Edhe ato pak raste që janë trajtuar nga vetë gjykata, dënimet kanë qenë shumë të buta në krahasim me krimin e bërë në familje.

Statistika mbi dhunën në familje e dëshmojnë këtë gjendje. Nga janari e deri në dhjetor të vitit 2017 janë evidentuar 1196 raste të dhunës në familje.

Sevdije Berisha nga Peja, më 17 nëntor 2017 gjeti vdekje pasi u godit me sëpatë nga bashkëshorti i saj. Por, Sevdije Berisha nuk është rasti i vetëm i dhunës në familje, e cila ka pësua me fatalitet, janë edhe pesë viktima të tjera si pasojë e dhunës në familje.

Krahasuar me periudhën e njëjtën dhe nëse u referohemi shifrave që ne i posedojmë te rastet e evidentuara nga viti në vit, mund të themi se dhuna në familje është mjaft e shprehur dhe se statistikat nuk e tregojnë tërësisht realitetin, se dihet që jo të gjitha rastet raportohen. Shumë prej tyre mbahen në heshtje, sepse gratë në këtë rast janë pa mbrojtje ligjore.

Nga 1196 raste të raportuara, të procedura në prokurori janë 1134 dhe 56 raste janë nën hetime.

Krahas infrastrukturës ligjore, duhet rishikuar i gjithë mekanizmi institucional veprues, si përgjigje ndaj dhunës në familje, në veçanti dhunës ndaj grave.

Në këtë kuptim disa nga masat që adresojnë këtë çështje të rëndë janë si më poshtë:

Të ndryshohet Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, me qëllim që të përfshijë rolet e përgjegjësitetë e secilës agjenci që lidhet me masat e rehabilitimit dhe riintegrimin si dhe të përcaktojnë qartë procedurat që mbeten të paqarta, në veçanti lidhur me qëllimin e ligjit, synimet e tij dhe aktet nënligjore. Kjo do të siguronte hetime, ndjekje penale, kompensim efektiv dhe efikas për viktimat e dhunës në familje.

Të sigurohet që ligji ofron një mjet efektiv ligjor, në rastet kur ekzistojnë ende kushtet për dhënien e urdhrave për mbrojtjen.

Kufizimet aktuale të ligjit lidhur me zgjatjen e urdhrave për mbrojtje, pa ofrimin e masave alternative në rastet kur vazhdojnë kushtet, përbëjnë shkelje të të drejtave të viktimave të dhunës në familje, nëpërmjet efektivitetit ligjor dhe mbrojtjes nga ana e shtetit kundër akteve të dhunës në familje.

Duke marrë parasysh rrethanat, kufizimi kohor prej 24 muajsh për urdhrat për mbrojtje, i cili përcaktohet me ligj, do të duhej të ofrojë një numër të pakufizuar të zgjatjeve.

Të ndryshohet ligji me qëllim që të përcaktohen më qartë mjetet ligjore penale si dhe të nxitet zbatimi i mjeteve juridike civile në rast të shkeljes së urdhrave për mbrojtje.

Të ndryshohet ligji me qëllim që kryesit t'i referohet si “kryerës i dyshuar”.

Të ndryshohet Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, Ligji i familjes dhe Kodi Penal, me qëllim që të ndalohen zgjidhjet alternative të kontesteve në rastet e dhunës në familje, në pajtim me nenin 48 të Konventës të Këshillit të Evropës.

Të fillojë hartimi i amendamenteve të Kodit Penal, ku dhuna në familje të përcaktohet si vepër penale, duke u mbështetur në rekomandimet e Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Kjo konventë u kërkon shteteve të ofrojnë kujdes të duhur dhe të ndërmarrin masat e nevojshme ligjore për të siguruar hetim dhe ndjekje penale efektive për veprat penale.

Po ashtu, është shumë e rëndësishme që strehimoret që deri më tani kanë qenë të organizuara dhe të financuara nga sektori i shoqërisë civile, të përfshihen në skema zyrtare institucionale dhe për të ketë program financimi e ndihme të kualifikuar të përhershme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli,
Kolegë,
Kabinet qeveritar,
Të nderuara media,

Detyra ime sot është vetëm të them se Qeveria e vendit, institucionet e vendit, e ndjejnë përgjegjësinë, pra, barrën që u takon, detyrat që i kanë, e që dhuna në familjet tona të ndalet, të mos ndodhë. E përshëndesim këtë seancë, këtë debat parlamentar, do t'i mbështesim ato konkluzione që i aprovoni sot, nëse i aprovoni.

Në të njëjtën kohë e shfrytëzoj rastin t'ju uroj 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, dhe të thirrëmi në një vetëdije më të lartë që të përmirësohet pozita e femrës në shoqërinë tonë.

Njëkohësisht e falënderoj Albana Osmanin, që është e pranishme sot, për një kampanjë të saj, e plot të tjerëve që e përkrahin, e që është në përkrahje të fëmijëve, pra të fëmijëve të sëmurë, fëmijëve me kërkesa shëndetësore. Faleminderit të gjithëve!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Sot, jo pak apo thënë më saktë, pamë jo pak hipokrizi edhe në këtë Kuvend edhe nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për dy çështje, edhe për shkak se ne uruam për 8 Mars, por si duket, ka harruar edhe kryetari i Kuvendit që jo rrallëherë pikërisht në këtë Kuvend janë fyer edhe gratë deputete dhe jo vetëm gratë deputete dhe nuk e kuptoj prapë se gratë deputete të PDK-së i dalin në mbrojtje kryetarit të Kuvendit kur ai i fyen gratë deputete, por edhe gratë profesioneve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, pamë hipokrizi tjetër kur këtu para mediave dhe para qytetarëve të Republikës u bëmë bashkë, ishte një hipokrizi e radhës, sepse sot në Republikën e Kosovës na vdesin fëmijët për shkak të leukemisë, për shkak se nuk ndahet buxhet për këta fëmijë, për shkak se QKUK nuk ka aparaturo të mjaftueshme që fëmijët të trajtohen me dinjitet dhe të mos vdesin në Republikën e Kosovës.

Prandaj, edhe nuk u bashkuam ndaj hipokritëve që janë përgjegjës që e kanë sjellë vendin në këtë situatë.

Po i kthehem temës. Unë e falënderoj nënkryetaren e Lëvizjes “Vetëvendosje” që në emër të “Vetëvendosjes” e ka thirrur këtë debat parlamentar.

Sot, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, po flasim për një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme dhe të ndjeshme. Po flasim për jetën dhe respektimin e dinjitetit të vajzave dhe grave.

Të gjithë sot këtu jemi dëshmitarë që vajzat dhe gratë përballen me shumë probleme e vështirësi dhe unë sot dua këtu t’i bëj kritika edhe këtij Kuvendi që dështoi për vite radhazi të pasqyrojë dhe të adresojë problemet me të cilat ballafaqohen vajzat dhe gratë.

Po, kemi krijuar grupe joformale, e çfarë kemi bërë?! Asgjë në raport me problemet që kanë vajzat e gratë. Zëri i 50% të vajzave e grave mbeti pothuajse i papërfaqësuar.

Madje, këtu më kujtohet kur e patëm propozuar projektligjin që njeh statusin e personave të dhunuar gjatë luftës, disa nga deputetët e këtij Kuvendi talleshin dhe i fyenin viktimat e dhunës seksuale.

Të nderuar qytetarë,

Dhunën ndaj vajzave dhe grave nuk mund ta shkëpusim nga problemet socio-ekonomike që po kalon vendi ynë.

Derisa jetojmë me një vend ku ka papunësi ekstreme, varfëri ekstreme, pra mungesë të mirëqenies, pabarazi të madhe, krim të organizuar e korrupsion, arsim jocalësor, edhe dhuna ndaj vajzave e grave vjen duke u shtuar e rënduar.

Diana, Zejnepja, Dafina, Donjeta, e shumë vajza e gra të tjera sot do të ishin në mes nesh, nëse shteti do të tregonte seriozitet në adresimin e problemeve shoqërore.

Diana u vra nga bashkëshorti, sepse shteti nuk i doli në ndihmë, ende edhe pas 7 vjetëve dorasi nuk ka dalë para përgjegjësisë!

Zejnepja, siç thuhej nga familjarët, ka pasur jetë nën dhunë fizike, derisa në fund u vra nga bashkëshorti në sy të fëmijëve. Po të mos kishte reagim qytetar, institucionet e drejtësisë do ta dënonin me burg minimal.

Dafina Zhubi sipas ekspertizës së institutit zviceran thuhet se është vëllorë, ndërsa prokurorja e rastit ka thënë se është vetëvëllorë, dhe e ka liruar të dyshuarin kryesor nga paraburgimi, me urdhër të kryeprokurorit të Prishtinës, Imer Beka.

Dy ditë para këtij debati, gjykata liron të dyshuarin kryesor për vrasjen e Donjeta Pajazitajt.

Këto ditë kam pasur shumë takime me vajza e gra që kanë qenë viktime të dhunës fizike, është e tmerrshme, e paimagjinueshme me çka përballen kur ato i drejtohen policisë për raportime.

Pyetje si këto: “Mos ke pas faj najsen ti që ai ta ka mshu, burri a i dashuri?”

“Paj, ju gratë e lypni kanihere!”

“Burrat duhet me i ndëgju! Ju gratë e sotit jeni tranu krejt”.

Këto janë komentet që viktimat e dhunës fizike i marrin në stacionet policore, madje edhe nga prokurorë e gjyqtarët!

Unë e di që ka edhe policë të ndershëm, por ka edhe të tillë që tallen me viktimat e dhunës fizike.

Unë do të doja të ndalesha në një nga pikat e rezolutës që kemi propozuar sot.

Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje i vitit 2010 ka nevojë urgjente për plotësim e ndryshim. Aty gjenden nene të paqarta, terminologji e vjetër, hapësira për interpretime e keqinterpretime.

Ndryshimi, të cilin ne si grup do ta iniciojmë duhet të përmbajë ashpërsim të gjobave dhe dënimeve, por po ashtu përgjegjësi penale për zyrtarët që nuk i respektojnë detyrat dhe obligimet e tyre.

Sa i përket Kodit Penal, së fundi kemi dëgjuar që është në rishikim, për mua është e papranueshme se si ministria nuk ka pranuar që dhunën ndaj bashkëshortes ta cilësojë si vepër të veçantë penale.

Sa u përket strehimoreve, në muajin janar në mungesë të buxhetit janë mbyllur.

Kjo qeveri nuk guxon të lejojë që për shkak të buxhetit të mbesin në rrugë viktimat e dhunës në familje.

Ne kërkojmë që për strehimoret të ketë linjë të veçantë dhe të përhershme buxhetore. Ato nuk janë një luks, por një domosdoshmëri. Për punën dhe mbështetjen e tyre kemi përgjegjësi të gjithë.

Trajnimet për prokurorët e gjyqtarët për këto raste dhe trajtimit special të tyre nuk ia kanë mbërritur qëllimit.

Ne jemi në fazën kur thirrja në përgjegjësi për vonesat, neglizhencat apo paragjykimet mbi bazën e stereotipave diskriminuese është urgjente. Kanë ndodhur shumë raste tragjike, për ta lënë ende të parregulluar qartë dhe në mënyrë strikte këtë fushë në sistemin e drejtësisë.

Paragjykimi për jetën dhe sjelljen e një gruaje ndaj të cilës ushtrohet dhunë brenda, në shtëpinë e saj, është paragjykim. Në shtetin tonë nuk mund ta lëmë këtë paragjykim të na bëhet rregull praktik i veprimit institucional.

Ndaj, ne jemi të vendosur ta shtyjmë përpara ndryshimin e Kodit Penal, Ligjin për dhunën në familje dhe sa më parë të nxisim seriozitet të lartë e të shtuar për ta parandaluar dhunën në familje ndaj grave.

Ne nuk kemi nevojë për lule, por për drejtësi, punë dhe barazi.

Kursehuni nga lulet, e çlirojeni mendjen nga paragjykimet. Faleminderit!

KRYETARI: Urime 8 Marsi, ju kisha ftuar që sa më shumë lule të shpërndani!

Urdhëroni zonja Kajtazi, fjala për ju në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Dhe e vetmja ministre, pakicë në këtë Qeveri.

Po e filloj fjalën time me deklaratën e UNESKO-s, ku aspirojmë të anëtarësohemi që këtë vit: “Paqja nuk mund të arrihet pa zhvillim dhe nuk mund të ketë zhvillim pa barazi të plotë të burrit dhe gruas. Shoqëria është ekuilibruar me femrën e integruar në jetën sociale, politike dhe ekonomike”.

Modeli i shoqërisë demokratike, kuptimi bazik i saj kërkon përfaqësim të drejtë të potencialeve njerëzore. Mospranimi i këtij përfaqësimi është shprehje e deficitit optik apo reflektim i stereotipave.

Menaxhimi me resurse humane është po aq i rëndësishëm sa edhe përcaktimi i politikave nacionale dhe kjo sjellje kodifikohet me ligje, e për fat të mirë, Kosova ka avancuar mjaft në rregullimin juridik për të mbrojtur secilin nga diskriminimi. Por këtyre ligjeve vazhdon t’u bëjnë rezistencë barrierat kulturore.

Shumë fakte tregojnë se shoqëria jonë nuk ofron mundësi të barabarta për gratë dhe burrat. Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar, vazhdojnë të mos jenë mjaftë të punësuara, përparimi në karrierë, e drejta në pronë e trashëgimi, diskriminime e tjera, e për fat të keq, duke përfshirë edhe temën e sotme, dhunën në baza gjinore.

E dhuna buron nga paedukata, nga i ligu që nuk mund të menaxhojë veten dhe situatën. Për fat të keq, si instinkt natyror që me daljen e njeriut nga shpella.

Ka shumë rëndësi ruajtja e dinjitetit vetjak, nga i cili del ai familjar për të reflektuar në dinjitetin nacional.

Dhuna ndaj grave ndikon seriozisht edhe në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Kostot për shërbimet e viktimave të dhunës, humbja e produktivitetit në punë nga indisponimi dhe shumë çështje të tjera, por mbi të gjitha mbetet esenciale respektimi i të drejtave njerëzore.

Nuk po prezantoj shifra, u thanë edhe këtu disa, kanë prezantua shumë institucione, ngase ato kamuflohen edhe nga heshtja, edhe nga frika dhe nga justifikimi i asaj si rrjedhojë e durimit të mësuar dhe e pafuqisë institucionale për të mbrojtur viktimat e dhunës, si rrjedhojë e kësaj ato ndodh të riviktimizohen të bien pre linçimeve, pre trafikantëve dhe formave të tjera abuzimi.

Nga shifrat në rritje të dhunës në familje si element shumë i rëndësishëm është vërejtur se nuk janë matur sa duhet pasojat, të cilat na i ka lënë lufta, duke çrregulluar balancën familjare, duke çrregulluar ekonominë familjare dhe shumë çështje të tjera, të cilat kanë reflektuar në jetën dhe në sjelljen tonë.

Po ashtu, edhe tendenca e agresorit që ta godisë esencialisht familjen si shumë bazike për ta mbajtur jetën.

Fëmijët që kanë pësuar nga dhuna, transformimet sociale, ekonomike dhe politike që ka kaluar vendi.

Ka pasur fare pak programe rikuperimi, programe psiko-sociale dhe kapacitete të pamjaftueshme dhe pambulueshmëri me fonde të institucioneve të kujdesit.

Edhe institucionet tona, edhe ky Parlament nuk ka hezituar të nxjerrë ligje, të bëjë strategji, të themelojë mekanizma, të miratojë rezoluta, të rreshtohet në zbatimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm, e mbi të gjitha që dokumenti më i lartë juridik i saj, Kushtetuta e Republikës, t'i përfshijë disa konventa ndërkombëtare që garantojnë barazi sociale, ekonomike dhe politike.

Ne bashkë këtu, edhe me një adresim nga një nga kolege deputete e kemi mbyllur vitin 2017 me 16 ditë të aktivizimit kundër dhunës mbi baza gjinore, jo vetëm ne si Kosovë, po edhe shumë vende që konsiderohen me demokraci më të konsoliduar, por vazhdon që dhuna të mbetet e evidente në çdo mes.

E për të mos përsëritur, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke mbrojtur dhe proklamuar kujdesin, mbrojtjen e familjes si fundament programor të saj, bën thirrje edhe një herë që ky Kuvend të respektojë të gjitha këto akte që i ka miratuar, duke forcuar monitorimin e zbatimit dhe për t'i dënuar shkelësit dhe neglizhentët.

Është koha t'i themi stop dhunës në baza gjinore, ta ruajmë familjes si qelizë e organizmit shtetëror, të ofrojmë standarde për shërbime sociale.

Më lejoni këtu të përmend, në vizitat që u kemi bërë disa qendrave për punë sociale dhe disa strehimoreve, me të vërtetë janë në një gjendje të mjerueshme dhe është shumë vështirë që ato të garantojnë kujdesin ndaj viktimave të dhunës, prandaj le të shërbejë ndoshta kjo ditë që të adresojmë këtë çështje dhe të kemi më tepër kujdes, duke pasur parasysh edhe fonde të qëndrueshme në këtë aspekt.

Efikasiteti në gjyqësor, ne marrim edhe një broshurë, “Padrejtësitë në drejtësi”, të cilën edhe më herët e kemi pasur në dorë dhe do të habiteni, siç edhe raporton edhe vetë Avokati i Popullit, që shumë lëndë mbesin ndoshta një dekadë të tërë në proces dhe në fund përfundon me një padrejtësi apo me një vendim, të cilin nuk kujdeset askush ta zbatojë.

Investim në fuqizimin ekonomik të grave përmes zhvillimit të shkathtësive të saj dhe shkollimit adekuat, ndërtimi i më shumë institucioneve të kujdesit ndaj kategorive në nevojë që bien barrë mbi gruan, siç është ai kujdesi ndaj fëmijëve, të moshuarve dhe të tjerëve dhe para së gjithash, të kemi respektin e duhur dhe të mjaftueshëm për njëri-tjetrin.

Uroj suksese në betejën për barazi dhe jetë më të mirë për të gjithë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Nga grupi PDK-së, zonja Mjaku e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, i uroj të gjitha nënat - urime 8 Marsi!

Mbase është një ditë që në këtë festë nënash më shumë se kurrë të ngremë zërin për t'i siguruar gruas statusin e merituar në shoqëri dhe për ta luftuar idenë e gjykimeve kanunore, viktimë e së cilës është gruaja dhe po ashtu për ta promovuar barazinë e gruas dhe të burrit si e drejtë kushtetuese dhe universale.

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Sot po debatojmë për një temë të ndjeshme - dhuna në familje. Ky është një problem serioz dhe me shtrirje të gjerë, që i kapërcen të gjithë kufijtë dhe kulturat. Në mbarë botën, shkak kryesor i vdekjes dhe plagosjes së grave është dhuna e ushtruar nga partnerët e tyre. Megjithatë, ekzistojnë disa shoqëri, sidomos në vendet në tranzicion, ku problemi ka mbetur pothuajse i padukshëm dhe shpesh nuk pranohet dhe nuk raportohet. Për ndryshim nga dhuna e rrugës, që në përgjithësi konsiderohet si krim, dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve është parë si legjitime, e pranueshme, ndonjëherë edhe e dëshirueshme, ose injorohet për arsye se është dukuri që ndodh në sferën private të familjes. Ky fenomen vazhdon të trajtohet nga shumica e popullsisë si një problem privat që i përket vetëm familjes, e jo shoqërisë.

Me gjithë punën ndërgjegjësuese që është bërë veçanërisht gjatë dhjetë vjetëve të fundit për ta sensibilizuar publikun, qëndrimet ndaj dhunës nuk kanë ndryshuar shumë. Vështirësia e studimit të fenomenit rritet edhe më shumë po ta kemi parasysh se fenomeni ndodh prapa dyerve të mbyllura. Si i tillë, ai është i vështirë për t'u vëzhguar dhe studiuar nga afër. Vetëm rreth 5% e grave të dhunuara në gjirin e familjes e denoncojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre. I vetmi burim i informacionit, në shumicën e rasteve mbetet vetë viktimja, e cila në çdo rast nuk është e çliruar nga paragjykimet dhe stereotipat që ekzistojnë në shoqëri apo në komunitetin ku ajo apo ai bën pjesë.

Dhuna në familje vetëm në rastet e rralla përcaktohet dhe penalizohet si krim brenda familjes, duke mos e paraqitur kështu në statistikat zyrtare. Dhuna ndaj gruas është një problem kompleks, që përfshin më shumë se një akt në vetvete në marrëdhëniet personale ndërmjet burrit dhe gruas. Mund të themi se është edhe problem social me përmasa të gjera që i ka rrënjët në qëndrimet historike ndaj gruas.

Shteti ynë ka detyrime ndaj shtetasve të vet, respekton, mbron, plotëson dhe promovon të drejtën e të gjithë shtetasve për të jetuar një jetë pa dhunë, po ashtu zhvillon mekanizma efektive juridike dhe institucionale për të reaguar ndaj akteve të dhunës në familje. Në vendin tonë, deri më tani dhuna ndaj grave është më e përhapur, por ekziston edhe dhuna ndaj burrave, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, si dhe fëmijëve. Mirëpo, dhuna ndaj grave është identifikuar ndërkombëtarisht si një nga format më të përhapura të dhunës. Statistikat globale, të mbledhura nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare, tregojnë se dhuna në familje është e përhapur në mbarë botën.

Statistikat tregojnë se në nivel global deri në 38% të vrasjeve të grave janë kryer nga familjarët. Këto statistika shqetësuese janë arsye për të cilat janë hartuar edhe traktatet ndërkombëtare, të cilat janë inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës, e cila synon t'u japë fund të gjitha formave të dhunës dhe diskriminimit ndaj grave.

Të nderuar qytetarë,

Vendi ynë kur e shpalli pavarësinë e vet si shtet sovran i miratoi disa detyrime ndërkombëtare duke i inkorporuar standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si pjesë e së drejtës së saj të aplikueshme. Po ashtu, e miratoi një numër të ligjeve dhe politikave për të reaguar ndaj akteve të dhunës në familje. Qeveria, nëpërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore, e ka hartuar dhe miratuar programin e Kosovës kundër dhunës në familje. Por, ajo që vlen të përmendet është shumë e rëndësishme që ekziston edhe Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020, një plan pesëvjeçar. Ajo strategji është hartuar duke u mbështetur dhe duke e respektuar legjislacionin nacional në fuqi për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe në bazë të vlerësimit të programit të mëparshëm nacional kundër dhunës në familje, të viteve 2011-2014.

Veprimet e aplikuara për t'u zbatuar për pesëvjeçarin në vijim tërhoqën vëmendjen drejtë rëndësisë së njohjes dhe aplikimit të standardeve ndërkombëtare të prezantuara nga një sërë konventash dhe direktivash, një pjesë e të cilave tashmë janë të zbatueshme edhe në Kosovë, veçanërisht janë sugjeruar veprime që çojnë drejt harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar, në përputhje me konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, apo Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Në këtë mënyrë, kemi përpara përgjegjësitë e kryerësve nëpërmjet trajtimit të dhunës në familje si vepër penale, kemi zgjerimin e gamës së shërbimeve të ofruara për viktimat e dhunës në familje, sigurimin e mbrojtjes së menjëhershme dhe trajtimit afatgjatë të të gjithë anëtarëve në familje të dëmtuar nga dhuna e ushtruar, apo përgatitja e një gjenerate të re dhe mendjehapur pa paragjykime dhe pa stereotipa gjinorë, si dhe tërësisht kundër dhunës në familje.

Ndjekja dhe zbatimi me sukses i veprimeve të planifikuara dhe përmbushja e objektivave dhe qëllimeve të strategjisë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, e viteve 2016-2020, është një periudhë pesëvjeçare, siç e ceka edhe pak më lart, pa dyshim që sjell trajtimin dhe menaxhimin e rasteve me prioritet dhe efektivitet nga punonjës më të aftësuar, institucione më të përgjegjshme, si dhe shërbime më cilësore të standardizuara dhe të shtrira në vend, të cilat në çdo hap kujdesen për nevojat e viktimës së dhunës në familje. Funksionalizimin dhe shtrirjen e mekanizmave koordinues, të përbërë nga palët pjesëmarrëse të vetëdijesuara, për rëndësinë e koordinimit dhe burimeve të nevojshme që duhen dedikuar për këtë qëllim, vendosjen e kryerësve përpara përgjegjësisë nëpërmjet masave të parapara në legjislacionin e përmirësuar,

duke i ndjekur ata penalisht, por edhe duke ua ofruar më pas trajtimin e duhur për rehabilitim nëpërmjet programeve të obligueshme.

Përveç strategjisë pesëvjeçare, kemi edhe rekomandimet e vitit 2016, të dala nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut gjatë monitorimit të Ligjit për mbrojtjen e dhunës në familje. Aty janë paraparë disa rekomandime, të cilat janë votuar në këtë Kuvend. Disa nga këto rekomandime veç janë në zbatim e sipër, por disa ende mbeten pa u zbatuar.

Kështu që nga fjalimi im sigurisht që vërehet gatishmëria e Qeverisë dhe Kuvendit që të gjitha këto pika, të cilat janë paraqitura në formë të rezolutës, për të cilat po diskutojmë sot, që është një gatishmëri e përbashkët. Prandaj, edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës beson se kjo punë e përbashkët do ta shoqërojë edhe zbatimin e strategjisë së planit të saj të veprimit për periudhën e viteve 2016-2020, dhe në fund të fjalimit tim i ftoj të gjithë që të punojmë së bashku për t'i thënë ndal dhunës në familje në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

E nderuar ministre,

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege deputete, urime 8 marsi!

Urime të gjitha grave!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dhuna ndaj gruas është njëra prej shkeljeve më të rënda të të drejtave të njeriut dhe mbetet pengesë e madhe në realizimin e barazisë, prosperitetit dhe paqes në shoqëri. Dhuna në familje, me theks të veçantë dhuna ndaj grave, vazhdon të jetë problem evident në shoqërinë tonë.

Vetëm një numër i vogël i rasteve të dhunës në familje raportohen tek autoritetet kompetente për trajtimin e kësaj çështjeje, por ekziston perceptimi që në realitet ky numër është shumë më i madh, posaçërisht në zonat rurale, pozita sociale e femrës është qartë e nënshtruar ndaj asaj të mashkullit dhe shoqëria është shumë pak e vetëdijshme për konceptin e barazisë gjinore. Në shumicën e rasteve, viktimat më të shpeshta të dhunës në familje janë fëmijët, gratë dhe pleqtë. Reagimi me kohë, në mënyrë të përshtatshme nga autoritetet kompetente, veçanërisht në rastet kur dhuna në familje lajmërohet, është një domosdoshmëri. Është i pajustificueshëm mosveprimi apo dështimi i institucioneve përgjegjëse për t'i mbrojtur viktimat. Ka disa raste të bëra publike, përfshirë edhe rastet që janë shënuar tashmë, që i dimë, kur si pasojë e dhunës në familje dhe si rezultat i mosveprimeve të autoriteteve kompetente, kemi pasur edhe humbje jete, të cilat vërtetë kanë qenë shqetësim i gjithë shoqërisë.

Humbja e jetëve duhet të jetë një alarm për të gjithë ne. Posaçërisht për institucionet shoqërore, në rastet e dhunës në familje, mekanizmat shtetëror duhet të garantojnë mbrojtjen sociale, ekonomike, shëndetësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje. Ne vërtet kemi ligje, ligje për mbrojtjen nga dhuna në familje, por zbatimi i tyre nuk ka qenë i kënaqshëm. Mbi të gjitha, është nevojë e plotësim-ndryshimit të këtyre ligjeve dhe unë sot i ftoj të gjithë, së pari koleget e mia deputete, por edhe deputetët, dhe ju garantoj që në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës do ta keni mbështetjen dhe do t'i japim maksimumin që këto ligje t'i ndryshojmë ne.

Nëse vonohet Qeveria, atëherë të mos vonohemi ne. E kemi të drejtë, e kemi obligim dhe mbi të gjitha mund ta bëjmë pa e pritur edhe Qeverinë, në qoftë se ajo vërtet vonohet.

Pra, le të punojmë, të marrim hapa konkretë, e shumë herë të mos themi se mbetet një debat për një kohë dhe harrohet çdo gjë.

Unë e përgëzoj Avokatin e Popullit, i cili vazhdimisht e ka ngrehur shqetësimin për çdo gjë, por në veçanti për dhunën ndaj gruas, rekomandime të cilat kanë mbet shumë herë të pazbatueshme nga institucionet. Avokati i Popullit, megjithatë, e konsideron që është e nevojshme që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të përfshihet edhe Konventa e Këshillit të Evropës për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2014. E një thirrje e tillë bëhet edhe në Strategjinë për Zhvillim të Komisionit Evropian.

Bashkëpunimi më i ngushtë ndërmjet institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe shoqërisë në tërësi për parandalimin e dhunës ndaj gruas është i domosdoshëm me qëllim të parandalimit të dhunës ndaj grave dhe për ta formësuar një ambient të përgjithshëm, meqë dhuna ndaj grave është e papranueshme dhe e patolerueshme. Bazuar në statistikat për dhunën në familje, abuzuesit, si dhe viktimat vijnë nga të gjitha kategoritë sociale, arsimore, ekonomike, andaj këto variable nuk determinojnë nëse dikush mund të jetë viktimë, abuzues i dhunës në familje, janë indikatorë, por jo determinues.

Edhe pse në Kosovë ekziston një numër i madh rastesh në familje, me të cilat ushtrohet dhunë, në një mënyrë ose në mënyrën tjetër ato raportohen, por këto raportime janë në masë shumë të vogël. Me këtë rast, më lejoni që ta falënderoj Qeverinë e Republikës së Kosovës, e cila në ditët e para mori vendim që kategoria, pra gratë e dhunuara në luftë të trajtohen dhe të veprohet konkretisht, duke marrë hapin e duhur që si Kuvend të kemi rekomandime, por në fakt kjo Qeveri filloi edhe zbatimin për kompensimin, sado që është shumë minimal.

Dhe, në fund të fundit, të nderuar kolegë, meqë jemi në Parlament, më lejoni që t'i uroj dy kolegët tanë deputetë, të cilët sot e kanë ditëlindjen, Rasim Selmanaj dhe Xhavit Haliti. Urime!

KRYESUESI: Faleminderit! Faleminderit edhe për urimin! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Po fillojmë pra prej këtu që t’i thyejmë stereotipat..., të mos flasë Albulena, por të flas unë për shkeljen e të drejtave të gruas, sepse këtu, edhe pse tema është dhuna në familje, më shumë u fol për dhunën ndaj gruas, e cila vërtet është një nga elementet që e karakterizon dhunën në familje, por edhe fëmijët janë ata që pësojnë jashtëzakonisht shumë nga dhuna në familje.

Nuk po flas për dhunën ndaj meshkujve, sepse ajo, edhe pse është e pranishme, nuk është në nivelin në të cilën do të mund të konsiderohej problem social, problem shoqëror. Albulena insistoi që të dal unë të flas, e jo ajo, që t’i thyejmë pikërisht këta stereotipa, sepse bile tha që “ju jeni ata që po e shkaktoni dhunën në familje”, tash dil edhe fol atje në foltore. Kështu që pranova. Pranova të dal të flas, edhe pse isha i papërgatitur, se edhe unë i ngarkuar me këta stereotipa kisha menduar që do të flasë Albulena dhe s’kam nevojë as të mendoj për këtë çështje.

Kur të flasim për fenomenin e dhunës në familje, pashmangshëm duhet të mendojmë dhe të flasim nga dy aspekte, apo ta trajtojmë këtë fenomen shoqëror nga dy aspekte. Njëri aspekt është detyrimi i shtetit, detyrimi i institucioneve përgjegjëse për t’i marrë në mbrojtje ato të cilat janë objekt i dhunës, i nënshtrohen dhunës çdo ditë, qoftë asaj psikologjike, qoftë asaj fizike, dhe aspekti tjetër është masa preventive që gruan apo femrën ta mbrojmë, apo fëmijën që do të lindë pas 10, 15 apo 20 vjetësh. Pra, preventiva, marrja e masave ndëshkuese ndaj atyre që sot e ushtrojnë atë, dhe preventiva që ta ndërtojmë një shoqëri dhe një familje, e cila do ta edukojë ndryshe fëmijën tonë.

Meqë jemi te stereotipat, stereotipat nuk janë shkaktarë të problemeve. Stereotipat na e tregojnë arsyen dhe mënyrën se pse e kemi dhunën në familje. Ata thjesht e shpërfaqin arsyen dhe nuk janë shkaktarë dhe ne nuk duhet t’i luftojmë stereotipat, por në fakt stereotipat t’i shfrytëzojmë për të hyrë në thellësinë e problemit dhe të përpiqemi që t’i shërojmë. Pra, duke filluar nga familja, nga çerdhja, nga shkolla fillore e më tej. Shpeshherë nënat, gratë, koleget mund të mos pajtohen, por nënat janë ato që shpeshherë në shumicën e rasteve e përgatisin dhunuesin e ardhshëm ndaj një gruaje tjetër, duke e bërë dallimin ndaj vajzës dhe djalit në familje, vetë nëna. Edhe kundër këtij stereotipi, edhe kundër këtij fenomeni, ne duhet të luftojmë. Ne mund ta mohojmë këtë, por fatkeqësisht kjo është e vërtetë. Në shumicën e familjeve, kur një nënë e ka një djalë dhe një vajzë, apo ka dy vajza dhe një djalë, apo anasjelltas, për shkak të problemeve sociale dhe kulturore, e favorizon djalin për shkak të mënyrës sesi është edukuar edhe ajo, në shumicën e rasteve është më tolerant ndaj tij. Dhe, kur sot jemi ne tolerant ndaj djalit, sepse ai është imi, nesër ai më nuk do të jetë vetëm imi, nuk do të jetë vetëm i asaj nëne, do të jetë bashkëshort i një gruaje tjetër dhe nuk do ta ketë ndjeshmërinë ndaj gruas siç e ka ndaj nënës,

sepse edukimin që në familje, që në shkollë, e ka marrë të atillë që të mos e ketë ndjeshmërinë e duhur.

Pastaj fëmija është imituesi më i mirë i mundshëm. Nuk ka imitues më të mirë se fëmija. Ne mund t'u themi fëmijëve tanë tërë ditën “mos e bëj një gjë të tillë, mos e bëjë këtë, mos e bëjë atë”, por nëse e bëjmë vetë, kot i themi atij mos e bëj. Ai do ta imitojë, në momentin që të vijë në moshën, në të cilën pavarësohet, ai do ta bëjë atë që ka bërë baba, ai nuk do të sillet në bazë të asaj çka i ka thënë baba, apo çka i ka thënë nëna, por ashtu çfarë ka parë. Kot i thua fëmijës “mos e pi duhanin”, nëse vetë e pi në praninë të tij. Veç një shembull.

Kot i thua që gruan duhet ta trajtosh mirë, nëse vetë në familje nuk e trajton gruan me dinjitet dhe nuk ia jep vendin e merituar dhe respektin e duhur. Pra, le të përpiqemi që krahas masave për t'i ndëshkuar ata që sot ushtrojnë dhunë, t'i ndëshkojmë ata dhe viktimat t'i marrë në mbrojtje shteti, institucionet, drejtësia, ligji. Njëkohësisht të punojmë dhe t'i largojmë dallimet që në familje ndërmjet djemve dhe vajzave.

Ndoshta unë nuk jam ai që duhet të mbaj ligjërata në këtë drejtim, sepse i kam veç dy djem, nuk kam vajzë, dhe ndoshta nuk jam më i miri për të dhënë ligjërata në këtë drejtim, por ata që kanë të mos e marrin personale, nuk thashë që të gjithë bëjnë ashtu, por në shumicën e rasteve. Fakti që dhuna është kaq masive në familje është edhe për shkaqe kulturore e sociale, por njëkohësisht e ka një rol të madh edhe gjendja e rëndë ekonomike, e ka një rol të madh edhe papunësia, e ka një rol të madh në këtë drejtim, e luan një rol të madh edhe mungesa e pavarësisë ekonomike e femrave, e grave.

Shihini vendet ku pavarësia ekonomike është më e madhe, mundësitë ekonomike janë më të mëdha, edhe dhuna në familje është më e vogël, sepse shpeshherë kur nuk kemi çfarë të bëjmë, kur nuk kemi ku ta harxhojmë kohën, e harxhojmë duke luftuar, duke e zbratur tërë atë mllef në familje, aty ku jemi shumicën e kohës.

Pra, le të fillojmë një varg masash, përpos atyre institucionale, të ndërhyjmë edhe në këto kulturore, duke filluar në familje. T'i flakim të gjitha ato mënyrat se si i edukojmë, se si e bëjmë dallimin në familje. E dimë që edhe kjo i ka arsyet kulturore, sepse burri, mashkulli, dikur është parë si burim ekzistence, si burim i sigurisë financiare, por tash po shkojmë drejt një shoqërie, ku edhe femra ka mundësi për të ekzistuar si e pavarur, për ta pasur një pavarësi financiare dhe në këtë kohë të tranzicionit, nga një shoqëri patriarkale në një shoqëri moderne, e para që e pëson është femra dhe fëmijët, të cilët rriten në një ambient ku ushtrohet dhunë. Nuk mund të presim që në familje, ku dhuna e karakterizon jetën e përditshme të rriten fëmijë, të cilët nuk do ta imitojnë sjelljen e prindit, të prindërve në momentin kur ata do të jenë prindër.

Prandaj, thirrja ime ka të bëjë jo vetëm me masat për të cilat u fol këtu dhe besoj edhe në përfundimet e përbashkëta, të cilat në fund do t'i votojmë, por edhe një gamë, një vistër masash në sistemin tonë të përgjithshëm të arsimimit, duke filluar nga çerdhja, paraprakisht nga familja, çerdhja dhe shkolla. Kur t'i kemi ndërmarrë këto masa në përgjithësi, besoj që dhuna në familje në dhjetëvjetëshin e ardhshëm, apo 20-vjetëshin e ardhshëm do të jetë shumë më e vogël, sepse të presim që vetëm se i kaluam disa ligje do të ndalet apo do të zvogëlohet në mënyrë masive dhuna në familje është pak iluzion.

Pra, nga fëmijët e sotëm nesër do t'i kemi gjyqtarët e ardhshëm, do t'i kemi prokurorët e ardhshëm dhe ata varen na edukata që ata do të marrin në familje, në shkollë dhe në universitet dhe të gjitha tjerat, sesi ata do ta shohin, do ta perceptojnë dhunën në familje dhe çfarë ndjeshmërie do të kenë për ta luftuar atë dhunë.

Duke dashur që ditën e sotme ta shfrytëzojmë për unitet rreth një fenomeni, i cili besoj që të gjithë i godet, pa marrë parasysh a janë objekt apo nuk janë objekt i kësaj dhune, besoj që të gjithë bashkëndiejmë. Le të bëhemi bashkë që të punojmë, që në të ardhmen ky fenomen të shkojë gjithnjë e më shumë duke u zvogëluar. Përndryshe, gjithashtu ju uroj Tetë Marsin të gjitha nënave, grave dhe motrave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Zhivkoviç.

JASMINA ŽIVKOVIČ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Poštovani kolege,

Današnja tema je nasilje u porodici, i žalosno je činjenica da mi i sada imamo potrebu da stalno raspravljamo o ovim temama, koje su vrlo teške, vrlo tužne, i vrlo obimne.

Nasilje u porodici ne podrazumeva samo nasilje nad ženama, naravno da tu spadaju i žene, i deca, i starci, što znaci da su žrtve oni koji su slabiji, i što znači da ako slabiji nemaju zaštitu od onoga koji njima najbliži, da moraju tu zaštitu naći u samim institucijama, i da je to neophodno. Nemam statističke podatke, i ne želim da to sedim na neke brojke, jer je i jedan slučaj previše za bilo koje društvo, i za bilo koji sistem, i za bilo koju instituciju.

U XXI veku, u vremenu i u veku razvoja i napretka, prosto je nedopustivo, i nema opravdanja da je nasilju u porodici tako izraženo, i borba protiv nasilja ne sme da ima alternativu, bilo u kom pogledu.

Stalno spominjemo niz nekih mera, i niz nekih sistema, i niz nekih procesa, što ljude van ove institucije dovodi možda do zabune da je borba protiv nasilja u porodici nemoguća. Da ćemo se zaplesti u tom nizu mera i procedura. Zapravo možda potrebna vrla jednostavna stvar, da ono što

mi kao poslanici ove Skupštine, i ono što je na međunarodnom nivou puno puta i već mnogo godina unazad raspravljano i donošeno, i ono što je stavljeno na papir da dođe do sprovođenja.

Ono što jeste činjenica, jeste da naše društvo jeste puno predrasuda, prema tome na šta žena ima pravo, a na šta nema, hajde onda da naše institucije nema predrasuda i ako žena i žrtva nasilja nema podršku od onih najbližih da zna da je blizu institucija, i da institucije je lice bez predrasuda.

Naravno da je ova Rezolucija neophodna, da sve nas podseti da sutra dan posle donošenja ove rezolucije i zajednički zaključaka danas, odmah, bez opravdanja, krenemo sa formiranjem institucije, kancelarije, ili kako god budemo to nazvali koje će 24 časa biti dostupna žrtvama nasilja.

I da već na nekoj narednoj debati pričamo o rezultatima ove Rezolucije, i o uspešnosti borbe protiv nasilja u porodici. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Damka, në emër të “6+”

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Veç për hir të opinionit, desha të them që ne nuk i kemi veshëmbajtëset, sepse gjuha e grave të komuniteteve tjera nuk është respektuar as në këtë çështje. Besoj se këto do të korrigjohen edhe më vonë, por ne e dimë që nuk ka barazi ndërmjet burrave dhe grave, por po shoh që në shoqërinë tonë nuk ka barazi as brenda grave e komuniteteve.

8 Mart Dünya Emekçi Kadınlar Gününün içi boşaltılmış, gerçek anlam ve öneminden çok uzak bir şekilde bajram havasında kutlanmaktan bir an önce vaz geçmeliyiz. Kadınların siyasi ve sosyal bilincinin geliştirilmesini ekonomik, siyasi ve sosyal başarılarını temsil eden 8 Martın restoranlarda veya kamusal alanlarda konserlerle kutlanmasından ziyade, kadın politikalarının yeterliliği ve uygulanabilirliği kadının günümüzdeki toplumsal konumu hakkında Meclis salonlarında, hükümet binalarında, konferans salonlarında yapılacak kişisel ve kurumsal özelleştirelere sahne olacak bir gün olarak kaydedilmesi ihtiyacı karşımızda durmaktadır. Kadının toplumsal konumunun halen arzulanan seviyede olmaması, kadına karşı şiddetin dünya genelinde en büyük toplumsal sorunlarından biri olmaya devam etmesi, bu ihtiyacı gün ışığına çıkarmaktadır. Günlük yaşamın her alanında günden güne kendine daha fazla yer bulmaya devam eden kadın, sanki bu başarının bedelin ödemenmezmişine, şidete maruz kalmaya devam ediyor.

Dünya genelinde en önemli toplumsal sorunlardan biri olmaya devam eden kadına yönelik şiddet vakaları ne yazık ki ülkemizde de azımsanmayacak düzeylerde seyretmekte. İster kamusal alanda ister evinde, isterse de işyerinde kadına karşı yönelik sözlü, fiziksel ve psikolojik şiddet kadının

toplumdaki konumunu tehdit etmektedir. Ancak bu noktada akdına karşı şiddet eylemlerinin toplumsal algı ve vicdanlarda sıradanlaşmaya ve kabul görmeye başlaması bizleri kadına karşı şiddet olaylarında gelinen seviyeden daha çok endişeye sevk etmektedir.

2015 yılında Kosova İstatistik Ajansı ve AGİT tarafından ortaklaşa hazırlanan bir raporda ankete katılanların yüzde 42'si aile içi şiddet olaylarını kabul edilebilir olduğu yönünde görüş bildirmişler. Yani yaklaşık iki kadından biri aile içi yaşanan şiddet olaylarını makut olarak görmektedir. İşte bizi bekleyen en büyük tehlike de bu. Durumun sıradanlaşması ve kabul görmeye başlaması. Kadına karşı şiddeti önleme ve şiddet eylemlerine mücadele için bu algının değiştirilmesi ile başlanılmalı.

Polis raporlarına göre ülke genelinde her yıl kaydedilen 1000'in üzerinde şiddet vakaları ile bölge ülkeleri arasında en kötü durumda olan ülkeyiz. Aile içi şiddete maruz kalan kadınların yıllar itibarıyla özellikle 2013'te 861 aile kadın, 2014'te 894 kadın, 2015 yılında 785 kadın. Bunlar sadece polis ve savcılık vakalarına intikal etmiş olan sayıdır. Bunun dışında intikal etmemiş sayıları daha katarak, bu sayının çok daha yüksek bir düzeyde olduğunu görmek mümkündür. Bunun önüne geçilmesi için de merkezi ve yerel karar alma ve yürütme mekanizmalarının kadına karşı şiddeti önlemeye yönelik eylem planları üstüne daha fazla durması, eğitim politikalarında mevcut toplumsal algının kırılmasına yönelik düzenlemeler yapılıp, kadın ve erkek arasında var olan fizyolojik farklılığın, sosyal haklar ve toplumsal konumlanma açısından herhangi bir eşitsizlik sağlamaması gerektiği bilinci aşılanmalı. Kadına karşı şiddet eylemlerine verilen cezalar caydırıcı seviyeye getirilmelidir.

Sosyal politikalar ile herhangi bir şiddete maruz kalmış kadınlar topluma yeniden kazandırılmalı ve konumunu güçlendirilmelidir. Toplumun her alanında cinsiyet eşitliğinin sağlandığı, kadının hak ettiği önemin verildiği ve maalesef devam etmekte olan şiddetin sona erdiği bir gelecek ümidiyle bu maçı uğruna çaba gösteren tüm feminist teorisyen ve aktivistlere başarılar dilerken, feminist teorisinin kurucusu Mery Wostanklaftı saygıyla anıyorum.

8 Mart Dünya Kadınlar Günü kutlu olsun.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zonja Kollçaku për të sqaruar edhe diçka. Zonja Kollçaku, e keni fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse sot me moton "Marshojmë, s'festojmë", shoqëria civile ka organizuar një marsh protestues, ju kisha lutur që të na mundësoni që kohën e pauzës ta shfrytëzojmë prej orës 12:00 deri në orën 13:00, për të na mundësuar që të bashkëngjitemi, nëse ka disponim i kisha ftuar edhe deputetët tjerë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e ke fjalën dhe pastaj po bëjmë pauzë.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Fillimisht më lejoni të ju uroj 8 Marsin të gjitha grave, Ditën e Gruas.

Sot në këtë ditë të shënuar e kam një urim të veçantë për sakrificën e grave për kombin, familjen, arsimin e shoqërinë. Përkulje e përjetshme për gratë, nënat që i edukuan dhe i falën atdheut pjesën më të shenjtë të tyre fëmijët.

Politikat për përmirësimin e pozitës sociale dhe ekonomike të gruas dhe rishikimi i politikave aktuale rreth punësimit të tyre janë objektivi im dhe i dikasterit që unë drejtoj.

Gratë janë vendimmarrëse të dëshmuara dhe meritojnë të jenë pjesë e hallkave më të rëndësishme të shtetit dhe shoqërisë. Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë sjellje jonormale dhe të patolerueshme. Ato renditen ndër shkaqet kryesore të dëmtimit të jetëve njerëzore dhe klasifikohen si cenim i integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik.

Dhuna në familje dhe ndaj grave diskutohet si problem mbarë botëror dhe kërkohet një serë veprimesh për adresimin e tyre. Për këtë arsye shtetet dhe shoqëritë e sotme inkurajohen vazhdimisht që të ndër marrin masa të nevojshme për njohjen, trajtimin dhe menaxhimin me efektivitet të të gjitha rasteve që raportojnë incidente të dhunës në familje, duke ofruar siguri të menjëhershme, mbrojtje, shërbime të standardizuara cilësore për shpëtimin, rehabilitimin dhe reintegrimin e të gjitha personave që pësojnë dhunë në familje, pavarësisht moshës, gjinisë, aftësive apo çdo tipari tjetër individual.

Dhuna në familje është dukuri që ka prekur dhe vazhdon dhimbshëm të prek edhe shoqërinë kosovare, ku përpos grave përjashtim nga kjo dukuri nuk bëjnë as fëmijët e as të moshuarit. Meqenëse, viktimat e dhunës në familje janë kategori që përfshihen në kuadër të mbrojtjes sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe siguron që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale e familjare, pa asnjë dallim race, përkatësie etnike apo gjuhe, religjioni, nacionaliteti, bindje politike apo orientimi seksual.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas mandatit ka mbrojtjen e personave në nevojë sociale, mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të dhunës, mbrojtjen e fëmijëve, gjithashtu në programet e saj ka mbrojtjen direkte dhe riintegrimin afatgjatë të tyre. Me qëllim të mbrojtjes direkte të këtyre personave në nevojë, ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale ofrojmë një serë masash mbrojtëse si: strehimin, rehabilitimin, punën me familjen, bashkimin familjar,

riintegrimin afatgjatë të tyre. Në bazë të të dhënave të cilat Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale posedon dhe në bazë të monitorimit të shërbimeve sociale dhe familjare, strehimoret që ofrojnë shërbime sociale vitin e kaluar kanë ofruar trajtim dhe strehim për 383 raste, prej të cilave 213 kanë qenë gra viktime të dhunës në familje dhe 170 fëmijë. Të gjithë këtyre personave u është siguruar ushqimi, mjetet higjienike, medikamentet, u është siguruar këshillimi dhe gjithashtu janë ndarë mjete për material shpenzues, ku viktimat kanë kaluar kohën e tyre të lirë.

Ne jemi të vetëdijshëm, se viktimat e dhunës në familje kërkojnë një trajtim më të mirë nga institucionet e shtetit dhe për të qenë afër këtyre kategorive është bërë decentralizimi i qendrave për punë sociale, të cilat kanë kaluar në mandat të komunave. Por, këtyre qendrave të cilat kanë staf të trajnuar dhe të specializuar duhet t'u jepet mbështetje në aspektin teknik, por edhe në atë financiar. Përpos qendrave për punë sociale si organe shtetërore për ofrimin e shërbimeve sociale Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka licencuar një seri organizatash joqeveritare, të cilat në programin e tyre përfshijnë strehimin, trajtimin dhe përkrahjen e viktimave të dhunës në familje. Këto OJQ realizojnë një punë të mirë, andaj edhe ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale kemi përkrahur vazhdimisht, si në mënyrë financiare, po gjithashtu edhe në aspektin teknik dhe profesional, duke licencuar ato dhe personelin i cili është i angazhuar në to.

Në fillim të vitit 2018 me vendim të Qeverisë kemi ndarë një shumë të mjeteve prej 65 000 euro për të mbështetur strehimoret për viktimat e dhunës në familje dhe vazhdojmë përkrahjen financiare për këto OJQ në bazë të Rregullores nga Ministria e Financave për financimin e aktiviteteve të organizatave joqeveritare dhe tashmë jemi në proces të thirrjes për aplikimin e grandeve dhe shpresojmë që këto procedura shpejt do të përmbyllen.

Përpos masave që jemi duke ndërmarrë për trajtimin dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje, qoftë në aspektin legjislativ dhe financiar, ne jemi duke u fokusuar edhe në fushata vetëdijesuese për shoqërinë tonë me qëllim të trajtimit më të mirë të grave dhe fëmijëve. Ne sot së bashku duhet të bëhemi gardianë të grave dhe fëmijëve, që kjo pjesë e shoqërisë të mos nëpërkëmbet nga të ligjtë, por të trajtohen me dinjitet njerëzor dhe respekt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani edhe zonja ministre i ka dy-tre minuta që të flasë dhe po shkojmë në pauzë, sipas kërkesës së zonjës Kollçaku.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Të nderuara deputete,
Të nderuara nëna, motra, bija,
Të nderuara heroina të kombit tonë,
I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,

Më lejoni fillimisht, që të gjitha grave shqiptare, më shumë se gjysmës së shoqërisë, t'ua uroj 8 Marsin. Të paktën në këtë ditë po diskutohet konkretisht për këtë çështje kaq thelbësore për zhvillim normal të një shoqërie. Më lejoni, të gjithë shoqërisë kosovare t'i uroj 8 Marsin.

Është shqetësues fakti që edhe sot, në kohën e demokracisë liberale, kemi dhunë ndaj grave, mohim të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, ligj e konventa ndërkombëtare. Jemi vetëm dy gra në Qeveri, nuk kemi asnjë grua kryetare komune. Kjo tregon më së miri që kemi ende punë në fuqizimin e rolit të grave në vendimmarrje dhe politikëbërje. Duke përkrahur gratë që të përfshihen në institucione e parti politike të marrim përgjegjësi e të kontribuojmë në shtetndërtimi e zhvillim të vendit. Ne i hapim dyert zhvillimit të mirëfilltë vendit tonë.

Dhuna në familje shkatërron familjen, qelizën bazë të shoqërisë, ajo mjafton mjaft keq në edukimin e fëmijëve, pra predispozitat janë shumë të mëdha që këta fëmijë të shpërfaqin sjellje të dhunës gjatë zhvillimit të tyre. Dhuna prodhon dhunën, viktima viktimën, dhe gjithçka shndërrohet në një rreth të mbyllur vicioz. Është urgjente që rastet e tilla të dhunës ndaj grave të trajtohen seriozisht nga institucionet tona. Viktimat e dhunës në familje të jenë kujdesi dhe përkrahja institucionale e shoqërisë.

Është i mirëseardhur një krijim i një task-force të përbërë nga anëtarë të Qeverisë, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, anëtarë të Shoqërisë Civile, për të monitoruar zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, strategjive e politikave kundër dhunës në familje. Ministria të cilën unë drejtoj me përkrahjen e Agjencisë Suedeze për Zhvillimin Ndërkombëtar SIDA ka realizuar analizën gjinore institucionale. Krijimi i mundësive të barabarta në këtë ministri, e para që po bëhet në një institucione shtetëror të Kosovës, mosintegrimi në mënyrë të kënaqshme i perspektivës gjinore në kornizë ligjore, strategjia e raporteve të ministrisë, orari jofleksibël, stereotipat gjinore, dallimi në paga dhe mëditje, mungesa e politikave dhe trajnimeve kundër ngacmimit seksual janë disa nga problemet më të mëdha, që identifikon ky hulumtim i përfunduar muajin e kaluar.

Ne si ministri jemi në proces të hartimit dhe miratimit të Rregullores së re për sistematizimin e vendeve të punës dhe konform dispozitave ligjore do të punojmë në ngritjen e nivelit të barazisë gjinore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Propozoj që secili institucione të realizojë një hulumtim të tillë, siç ne e kemi realizuar, për të parë saktë gjendjen e grave në institucione, problemet dhe sfidat e tyre dhe në bazë të rezultateve të ndërmarrim hapa konkretë për përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Të nderuar,

E kaluara dhe e sotmja na ka dhënë dhe po na jep mjaftë fakte për të mos gabuar dhe për të mos u përsëritur, për të mos vazhduar të ballafaqohemi vetëm me pasojat. Andaj, vetëm së bashku

mund të arrijmë të krijojmë një shoqëri tolerante larg çdo forme diskriminimi, dhune e keqtrajtimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Time, merre edhe ti tash fjalën dhe po e përfundojmë.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Problemi më i madh për studimin e këtij fenomeni, qëndron sepse shoqëria kosovare ende është duke vepruar në bazë të normave morale dhe shumica e rasteve të cilat ndodhin në shoqërinë tonë e që nuk janë të pakta, mbesin të mbyllura nga vetë grupi shoqëror.

Dhuna në familje është e theksuar më tepër ndaj gruas, përkatësisht burrit ndaj gruas. Është një problem social, i cili ka përcjellë shoqërinë kosovare me shekuj, sepse shoqëria jonë ka qenë një shoqëri patriarkale. Prandaj, duke pasur parasysh këto fakte që u cekën më lartë, ne mund të themi se ky problem është mjaft i pranishëm në shoqërinë tonë dhe nuk është studiuar mirë nga institucionet përkatëse. Vlerën më të madhe, të cilën e ne e kemi pasur dhe e kemi në shoqërinë tonë, është pikërisht familja. Prandaj, mu për këtë nevojitet një përkujdesje më e madhe institucionale që deri më tani ka munguar.

Por, këto vende nuk mund të përparojnë, nëse gjysma e popullsisë së tyre është e marginalizuar, e keqtrajtuar apo subjekt i diskriminimit. Kemi statistika dhe veç në vitin e fundit ne kemi raste vrasjeje, kemi raste të keqtrajtimit, por këto janë vetëm raporte të raportuara në polici. Veprimtarët humanitarë shprehen të shqetësuar, se numri i atyre që nuk raportohen kurrë mund të jetë shumë i lartë. Prandaj, duke pasur parasysh këtë fakt shoqëria kosovare tani duhet të bëjë më tepër për të krijuar preventiva për parandalimin e këtij fenomeni jo dhe aq i ri në shoqërinë tonë.

Studimet në lidhje me dhunën në familje janë të pakta në Kosovë. Ky problem në Kosovë vazhdon të trajtohet si problem privat, që u përket vetëm familjeve që i kanë këto probleme e jo të gjithë shoqërisë. Edhe pse, pas luftës në Kosovë të drejtat e grave u riformatuan nën koncepte demokratike vërehet një mangësi e madhe në respektimin praktik të tyre. Kosova e ka Ligjin për barazi gjinore, Ligjin kundër diskriminimit, Udhëzimin Administrativ për mundësi të barabarta dhe rregullore të tjera, por megjithatë ekzistencën e një kuadri të mirë ligjor, vështirësitë në zbatimin e ligjeve, mungesat në strukturat zbatuese dhe fondet e pamjaftueshme pamundësojnë jetesën në një barazi të plotë gjinore në Kosovë.

Barazia gjinore është kusht për një jetë normale në çdo vend të botës. Është sfida më e madhe me të cilën është përballur në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Është problematike fakti që gratë në Kosovë nuk kanë qasje praktike në trashëgiminë e tyre dhe të drejtat mbi pronën. Është përgjegjësi e atyre që duhet ta implementojnë ligjin, duhet të insistohet që ligji të implementohet dhe Qeveria duhet të ketë politika të forta në këtë drejtim. Për ta zvogëluar numrin e rasteve të

dhunës ndaj femrave duhet edukim dhe që Qeveria të ketë mesazhe të forta për këto raste, ligje të forta, ndëshkime dhe politika të mira. Ne kemi ligje, kemi bazë ligjore, por duhet vetëm që këto të implementohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani unë kam një çështje që dua ta diskutojmë bashkë. Ata kërkuan pauzë. Realisht, edhe Kryesia ka mbledhje me kryetarët e grupeve parlamentare. Gratë Deputete po kërkojnë ta vazhdojmë seancën. Qysh të doni. Më thoni, unë jam i gatshëm të rri edhe në seancë edhe të shkoj në mbledhje... Kush dëshiron të dalë, le të dalë, kush dëshiron të rrijë, le të rrijë. Qysh po doni?

Muharrem, çka po thua ti? Ti e di punën e protes... Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Kryetar,

Besoj që nuk ka asnjë kuptim dhe është pak a shumë qesharake që Kuvendi i Kosovës të debatojë për një temë që është e ndjeshme e serioze me një numër kaq të vogël të deputetëve. Shumica e tyre kanë dalë jashtë, një numër po pinë kafe e cigare mbrapa, kështu që ju lutem, nuk jemi badihavxhinj që me çdo kusht të mbetemi në sallë.

Ose do ta vazhdojmë seancën siç ka hije, ose ta lëmë mbas... ku di unë... pas pauzës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, e marrim pauzën edhe ecim. Po, merre fjalën. Zonja Gaxherri, nëse dëshiron të flasësh fol, unë s'kam nevojë... Jepja fjalën zonjës Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Zoti kryesues,

Deputetët veç dolën, se unë nuk pajtohesha që të shkojmë në pauzë dhe më vjen shumë keq prej subjektit politik, i cili ka kërkuar këtë debat, që nuk është asnjë deputet këtu sot. Edhe ne të tjerët, ata që vërtet janë përgatitur të diskutojnë sot janë në sallë dhe ishte dashur të jenë në sallë dhe pastaj do të mblidheshim pas dy-tri orësh dhe do të votonim ato rekomandime, sepse përndryshe është seanca e katërt që do të mbete e papërfunduar. Kjo për mua është e pakuptimtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Fillimisht më lejoni që të gjitha nënave, grave, vajzave, t'ua uroj 8 Marsin, edhe pse thirrja e kësaj seance pikërisht në këtë ditë të shënuar ngjall një konfuzion. Që nga titulli i thirrjes së këtij debati ka gjithçka që lë shumë për të dëshiruar, por sinqerisht dola për një arsye shumë të veçantë këtu në foltore.

Është mjerim për këtë Parlament, është mjerim për ata deputetë që për politika ditore i qesin 600 nënshkrime në letër për të thirrur seanca dhe thjesht, nuk mbajnë përgjegjësi për nënshkrimet e tyre. Unë po u them qytetarëve të Republikës së Kosovës në përgjithësi, meqë sot po diskutohet ndaj dhunës në familje dhe sot u fol këtu veç për gratë, mos u befasoni, sepse ja siç është ky Parlament, si sillen iniciuesit e kësaj seance ashtu është edhe gjendja e dhunës në familje, ashtu e kemi edhe gjendjen e dhunës ndaj grave.

Unë sinqerisht po them, jam shumë e befasuar nga iniciatorët e kësaj seance, pikërisht nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e cila rrufeshëm i shfrytëzoi minutat e tyre për të dalë e për të akuzuar kryetarin e Kuvendit dhe gjithë të tjerët, të cilët mundohen që të bëjnë diçka për këtë vend, ndërsa vetë neglizhojnë, vetë braktisin, vetë sabotojnë, vetë ofendojnë. Thjesht, një mesazh e kam sot për Lëvizjen “Vetëvendosje” - dallojeni erën e luleve nga era e atij që ju e dini, po them kështu në mënyrë simbolike “nga era e Albinit”.

KRYESUESI: Faleminderit! Tash unë në njëfarë forme, edhe e kam lejuar pauzën si kryesues. Nuk kemi askënd të Kryesisë këtu që mund ta vazhdojë, ne kemi mbledhje të Kryesisë. Ju kisha lutur që deri në orën 14:00 të kemi pauzë. Daut, edhe ti? Hajde, zoti Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Veç po kam dëshirë të ta uroj ditëlindjen, se mora vesh që e ke sot.

KRYESUESI: Atëherë, deri në orën 14:00 kemi pauzë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë, ne e patëm një pauzë deri në orën 14:00. Tani është ora 14:15 minuta. Fjalën e ka zonja Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë,

Medie,

Është hera e parë që Lëvizja “Vetëvendosje” ka marrë një iniciativë për këtë seancë të jashtëzakonshme, pikërisht më datën 8 Mars.

Të gjitha gratë në vendet e ndryshme të Botës kanë organizuar protesta dhe kanë shprehur pakënaqësitë e tyre, sa i përket orarit të gjatë të punës, të drejtën për të votuar dhe shumë të drejta, të cilat jo se nuk i kanë merituar, por që ua kishin mohuar.

Jemi tani në vitin 2018 dhe pakënaqësitë e grave jo që u zvogëluan, por ato u thelluan edhe më shumë. Diskriminimi i tyre sa vjen bëhet edhe më i dukshëm duke filluar nga thelbi. Vajzat diskriminohen që nga familja e deri tek shoqëria. Ajo nuk trajtohet e barabartë sidomos me ndarjen e trashëgimisë. Në vendin tonë vetëm 8% e grave kanë prona në emër të tyre dhe nga këtu fillon diskriminimi. Në punësim, përpos atyre që përmes politikës kanë pasur mundësi të punësohen, gratë tjera janë të papërfshira në institucione publike e ato gra që punojnë në kompani private janë të diskriminuara me orare të stërzgjatura dhe të pakompensuara as me pushim e as me benifite tjera shtesë. Nuk respektohet Ligji i punës për kompanitë private, nuk respektohet, as pushimi i lehonisë e as pushimi vjetor.

Dhuna në familje është një fenomen tjetër që është në rritje nga viti në vit. Sipas statistikave që posedojmë nga terreni, dhuna në vend se të zvogëlohet, ajo është rritur dukshëm. Për shembull, në vitin 2016 viktimat të dhunës kishim 988 raste, ndërsa në vitin 2017 dhuna u rrit në 1196 raste dhe nga këto raste 1138 raste ishin dërguar në Prokurori ku pesë raste prej tyre kanë përfunduar me vdekje si rezultat i dhunës.

Nuk duhet anashkaluar apo harruar edhe rastet e ndjeshme, të cilat u përfolën shumë, por ende nuk u kompensuan, gratë e dhunuara në luftë. Ky Kuvend hartoi Ligjin për gratë e dhunuara të luftës, por për t’u implementuar përsëri po mbetet në vullnetin e burrave që ta bëjnë. Deri më tani zoti Haradinaj si Qeveri, sipas tij ka marrë vendime të mëdha, por edhe ato vendime që ka marrë ishin jashtëzakonisht të dëmshme. Por, asnjëherë nuk u kujtua për këtë kategori. Pse këto gra nuk u kompensuan? Çka ngeci dhe pse kjo kategori dhe kur do të fillojë të trajtohet kjo kategori e grave me dinjitet?

Ne e dimë që kemi shumë punë për të bërë në këtë shoqëri, sepse gruan ende e konsiderojnë si kuotë. E vetmja e drejtë të cilën nuk diskriminohejmë është e drejta e votës, sepse aty i nevojitemi kësaj shoqërie dhe i konsiderojnë në shumicën e rasteve si “makineri votash”. Pra, po ta shohim edhe qeverisjen Haradinaj shohim se sa e ka respektuar gruan në vendimmarrje. Nga 21 ministri vetëm dy ministre janë gra dhe mbi 70 zëvendësministra vetëm pesë janë gra. Nga këtu vërejmë se çfarë është ky lloj diskriminimi.

Fjalimin tim do ta përmbyll me një thënie të një gruaje të fuqishme të politikës, Margaret Theçer, e cila thotë: “Nëse kërkon vetëm fjalë, pyete një burrë, nëse kërkon vepra, pyete një grua.”

Andaj, nga përvoja ime dua t’i këshilloj të gjitha gratë që të luftojnë vetë për të drejtat e tyre, mos të presim të drejtat tona të na i japin burrat, sepse shtylla e familjes dhe e shtetit është vetë gruaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës unë edhe një herë dëshiroj t’i uroj gratë për ditën e 8 Marsit. Çdo shoqëri do të jetë më paqësore dhe më prosperuese me respektimin dhe fuqizimin e femrave në shoqëri dhe në ekonomi, në përgjithësi.

Promovimi i barazisë gjinore në Kosovë duhet të merret me shumë më tepër seriozitet. Vetëm 12% e femrave në moshë pune janë të punësuar, krahasuar me mbi 30% të burrave. Ato femra që punojnë janë kryesisht të angazhuara në arsim e në shëndetësi, shumë pak në biznese të vogla, kryesisht për prodhimin e ushqimit, shërbimeve dhe industrisë së tekstilit.

Duhet më shumë përkrahje, që punësimi i femrave të kalojë nga sektorët tradicionalë, sektorët që janë jotradicionalë, ku të ardhurat për zhvillim janë më të mëdha. Shumicën e rasteve veprimtaritë biznesore të femrave ato i kanë filluar, më shumë të detyruara nga kushtet e vështira ekonomike apo lufta për ekzistencë e jo shumë të motivuara nga maksimizimi i të ardhurave. Një raport studimor nga USAID-i tregon se numri i femrave ndërmarrëse në Kosovë është në fakt më i vogli në rajon. Biznese që janë pronë e grave, gjithashtu janë biznese mikro, me margjina të vogla të profitit dhe nivel të ulët të kapitalizmit, në krahasim me biznese që janë prona të burrave.

Femrat ndërmarrëse në Kosovë përballen me barriera shumë të mëdha për qasje në kredi, pasi që nuk posedojnë kolateralin e nevojshëm. Në vitet e fundit të Qeverisë Mustafa është vërejtur një trend përmirësimi, por duhet shumë më tepër për të arritur barazinë gjinore. Është miratuar

atëherë korniza ligjore, që dy bashkëshortët të kenë të drejta të barabarta në pasurinë e tyre dhe me këtë ndryshim ligjor femrat e kanë fjalën e tyre, në fakt e kanë veton e tyre, në tjetërsimin apo në shtimin e pasurisë familjare. E patëm filluar atëherë buxhetimin nëpër ministri mbi baza gjinore, gjithashtu të dhënat tregojnë se ka një trend të rritjes sa i përket pjesëmarrjes së femrave si pronare të bizneseve individuale, nga 25-28 % në vitin 2017.

Të nderuar deputetë,

Unë dua të konfirmoj angazhimin tonë si parti politike e qendrës së djathtë, që respekton dhe promovon drejtësinë dhe liritë individuale dhe kolektive. Si parti që besojmë se familja luan rol kyç në ndërtimin e një shoqërie demokratike, ne angazhohemi për fuqizimin e këtij institucioni. Brenda familjes mësohen virtytet sociale, mësohen virtytet sociale, obligimet reciproke familjare, besimi dhe përgjegjësia. Për ne, vlerat familjare janë themelore për zhvillimin e individit dhe për kohezionin social të Kosovës.

Në qendër të kësaj filozofie të veprimit politik të Lidhjes Demokratike është femra. Prandaj, ne angazhohemi për barazi të plotë gjinore.

Ne mbështetim veprimet afirmative për ta rritur barazinë gjinore për aq kohë sa kjo është e nevojshme.

Më konkretisht, ne i mbështetim politikat afirmative ndaj femrave që rrisin qasjen e tyre në punësim, barazinë në paga në mes të gjinive, mbështetje në ndërmarrësi, të drejtat e lehonisë, fuqizimin e Ligjit mbi trashëgiminë pronësore dhe promovimin e përgjithshëm të femrave për aq kohë sa në shoqërinë tonë ka diferenca gjinore.

Por, të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë kemi një rol për të luajtur në fuqizimin e femrës, në rolet tona si familjarë, si përgjegjës brenda institucioneve, në shoqëri dhe më gjerë.

Nëse të gjithë ne bëjmë detyrën tonë me përkushtim, kudo që jemi, shoqëria kosovare do të jetë më tolerante, më humane dhe më e drejtë.

Pa krijuar mundësi të barabartë për femrat, ne jemi duke humbur 50% të potencialit prodhues që ka ekonomia jonë, sepse 80% e femrave nuk janë aktive në tregun e punës, krahasuar me 30% të burrave.

Unë do të jem një avokat dhe aktivist për të krijuar kushte që çdo femër të jetë përcaktuese e fatit të vet, duke mundësuar qasje të plotë në arsim, punësim, ekonomi dhe në aktivitete që transformojnë shoqërinë tonë drejt një shoqërie civilizuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka zonja Ganimete Musliu, në radhë është zonja Sala Berisha. Nëse nuk e përgatitni listën si grup parlamentar, unë ashtu si jeni të shënuar, përjashtuar kryetarët e grupeve parlamentare, jua jap fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar Haliti!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Media,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, më 8 mars, jemi mbledhur këtu në një seancë të veçantë, me një temë të veçantë.

Konsideroj që tema për të cilën sot po diskutojmë duhet të jetë angazhimi ynë i përditshëm, jo vetëm në një datë kalendarike të një viti, një datë që është domethënëse për të gjitha nënat, gratë dhe motrat.

Shfrytëzoi rastin t'i uroj të gjitha gratë anekënd botës, sidomos grave shqiptare me rastin e 8 Marsit.

Më lejoni të falënderoj edhe kolegun tim, Andin Hoti, i cili ka treguar vëmendje për neve koleget deputete sot, më 8 Mars, duke na dhuruar nga një lule të bukur. Faleminderit, Andin, për vëmendjen që e ka domethënien shumë të madhe.

Unë sot do të zberthej tema për të drejtat e gruas për dhunën në familje apo diku tjetër. Unë do t'i drejtohem kësaj seance me disa vargje të shkëputura kushtuar gruas.

“Mos harro se lëkura rrudhet e flokët mbulohen me borë, ditët bëhen vite, por më e rëndësishmja nuk ndryshon kurrë. Forca jote, bindja jote s'njohin moshë, shpirti yt e shtrin pëlhurën e merimangës që mosha të endë mbi fytyrë pas çdo pikarritjeje, ka një pikënisje. Pas çdo suksesi, një zhgënjim. Përderisa je gjallë, gjallëro, në qoftë se të mungon çka bëje më parë, bëje përsëri. Mos rri duke parë fotografi të zverdhura nga koha, mos e le të ndryshket hekuri që ke brenda vetes, sillu në mënyrë që në vend të mëshirës, të gëzosh respekt. Kur të rëndojnë vitet e s'mund më të vraposh, ec shpejt, kur s'do mund as të ecësh shpejt, ec, e kur as të ecësh s'do mundesh, përdore shkopin e shko, veç për t'u ndal, t'i kurrë mos ndalo”.

Është kjo një poezi e një gruaje të madhe me famë botërore kushtuar gruas, është poezi e Nën Terezës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Halimaj e ka fjalën.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Fëmija e pyeti prindin e vet: Çfarë do të thotë fjala burrë? Prindi iu përgjigj: Ai është i fortë, përgjegjës për fëmijët e vet, përkujdeset për çështje të tyre dhe rri pa gjumë për rahatën e tyre. Fëmija tha: Shpresoj që të bëhem burrë sikurse nëna ime.

Të dashura nëna, urime 8 Marsin. Ju jeni të shtrenjta për ne, mundi dhe sakrifica juaj na bënë t'u jemi borxh gjatë gjithë jetës.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, desha të distancohem nga kjo temë në fillim, sepse mendoja se në këtë ditë ne do të duhej të flisnim se çka ne duhet të bëjmë për të ndihmuar avancimin dhe emancipimin e grave, e jo të flasim për dhunën në familje, sepse ne e dimë se kjo ekziston, por ne duhet të mendojmë se si ta reduktojmë apo ta eliminojmë këtë dukuri në shoqërinë tonë.

Nënat, zakonisht shihen si shtylla të edukimit të fëmijëve, ndërsa baballarët shihen si mbajtës të familjes, në mentalitetin tonë. Pra, ne gratë edukojmë fëmijët tanë në kohën më të madhe, si vajzat, ashtu edhe djemtë.

Për të kritikuar ne burrat, fillimisht duhet të jemi vetëkritike, sepse ne i edukojmë ata. Nëse vërtet duhet ta themi të vërtetën, atëherë kjo është e vërteta. Për shembull, i themi vajzës sonë: bëja rrobat gati vëllait se po hy të pastrohet ose mos ia kthe fjalën vëllait! Këto pothuajse në çdo shtëpi ndodhin, e të tjera si këto u thonë nënat vajzave, duke i bërë ato që me këto detyrime të ndihen inferiore ndaj meshkujve.

Pra, vetë gruaja edukon një grua të ardhshme, vetë gruaja edukon ose i paraprin një sjelljeje të ardhshme të burrit të ardhshëm.

Se imagjinojeni, kur bëhet fjalë për pasurinë që duhet të ndahet mes vajzës dhe djalit, duke i thënë nëna vajzës se vet: mos kërko pasuri, se më nuk do të të pranojë vëllai në shtëpi! Gjenerata jonë kurrë nuk do të duhej ta mbështeste këtë qasje.

Prindër, ju lutem, kurrë mos i ndani fëmijët tuaj në vajza dhe djem, sepse ata janë fëmijët tuaj, qofshin vajza apo djem. Do të duhej të ishin njëjtë për ju.

Të nderuar prindër,

Ju jepni vajzave po aq sa edhe djemve, kur investoni në vajza, investoni në dije, investoni në edukim.

Fjala ime këtu, e kështu edhe mund të jetë skandaloze, po të mos ishte e vërtetë, por kjo është e vërtetë dhe nëse ne nuk i diskutojmë këto, atëherë nuk mund të presim një situatë më të mirë.

Dhe, ju lutem, këto që po i them, nuk janë për të gjitha gratë, por për një pjesë të tyre.

Unë nuk mund të imagjinoj që nesër të mos u lë pasuri vajzave të mia, unë nuk mund të imagjinoj që nesër t'u them vajzave të mia: ani, burrë është, ta japë një shuplakë edhe çka!

Kështu që shumë të dashura nëna, mos i trajtoni vajzat tuaja sikur ato kanë lindur si të huaja, me idenë që “vajza lind në shtëpi të huaj, për të shkuar në shtëpi të vet”, kjo ide është e tmerrshme.

Ne, gjeneratat tona, duhet të jemi shumë të kujdesshme në edukimin e fëmijëve, e sidomos të vajzave.

Të dashura gra,

Gabimi ynë është në keqkuptimin e mirëkuptimit mes burrit e gruas, pra keqkuptohet mirëkuptimi me dëgjimin ose bindjen ndaj tij, të mirëkuptohet një çift mes vete nuk do të thotë se ne gratë duhet t'i pyesim burrat, të kërkosh nga burri mendimin mbi diçka mund të jetë në rregull, por të kërkosh të të lejojë ty burri për diçka, atëherë kjo nuk është në rregull.

Pse ne jemi ato që do të duhej të pyeteshim për burrat, ideja e të pyeturit burrin i bënë gratë të nënshtruara. Prandaj, gra të dashura, ju mund t'i tregoni burrit se ku po shkoni, sepse është edukatë, por jo t'i pyesni ata nëse do të duhej të shkoni ju diku.

Mendojeni, vite më parë, kur burrat nuk i lejonin gratë të shkolloheshin, me idenë se vajzat, pra gratë, janë për shtëpi.

Asaj grua që iu mohua e drejta e shkollimit, i edukoi fëmijët e saj ashtu siç mundi, por jo me gjithë kapacitetin që do të mund të kishte sikurse të ishte e shkolluar, e arsimuar.

Po ju lus, prapë prindër të nderuar, investoni në vajza tuaja, sa i hapni një biznes djalit tuaj, kontribuoni edhe për vajzat tuaja. Mos i shihni vajzat sikur ato do të mund të udhëheqin vetëm sallone bukurie, por u hapni atyre biznese sikurse u jepni djemve dhe shikojeni se sa të suksesshme do të jenë ato.

Pse gratë të kërkojnë pavarësinë nga burrat? Pse gratë nuk i bëjnë burrat të kërkojnë pavarësinë nga ne, pse gratë të kërkojnë barazi, pse burrat të mos i bëjnë të kërkojnë barazi nga ne? Burri nuk ka asgjë më shumë se sa një grua, veç forcës. Ne edhe mund të na mbysni, por t'u nënshtrohemi, në asnjë mënyrë.

Prandaj, ju burra, mos na vini në pozitë t'u krahasojmë me qeniet të cilat kanë forcën tuaj, veç njeriut.

Dhe, për fund, uroj që fjala ime të mos keqkuptohet, sepse unë nuk e fal asnjë dhunë, qoftë ajo edhe verbale, prandaj që të gjithë ata që ushtrojnë dhunë ndaj grave duhet të dënohen.

Unë pres nga gratë, të cilat kanë dhunë të tillë, të denoncojnë e të mos i fshehin ato raste. Pastaj institucionet përgjegjëse të merren me këto çështje dhe t'u ndihmojnë grave në marrjen e vendimeve të duhura.

Ne, në fakt, i duam lulet, por më shumë e duam lirinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedavajući!

U moje lične ime u ime Nove demokratske stranke želim da svim našim majke ženama čestitam međunarodni praznik, dan žena.

Koliko je važno da na današnji dan posetimo našu širu javnost da su žene važan faktor porodici i u društvu u celini.

Koliko je važno da je i dalje u XXI veku se mi same borimo sa svoja prava, za ravnopravnost polova, za emancipaciju, edukaciju, za podjednaku deo roditeljskog nasledstva, ekonomsko nezavisnost, za samostalnost bes polne diskriminacije, za ravnopravno učešće u javnom životu, za naše univerzalne vrednosti, ljudske vrednosti.

Naša država, odnosno vaša Vlada ne daje pozitivan primer, pogledajte koliko je mali broj žena ministre, imamo samo dve, koliko je mali broj ili nijedno predsednicu opštine.

Drage moje koleginice,

U ovom parlamentu ovo je polna diskriminacija i pozivam vas da se i dalje borimo i ne smemo ni po koju cenu odustajati o te naše borbe da promenimo svest naših građana patrihalna vaspitanje i razne predrasude i stereotipe u društvu.

Zapitajmo se svi zašto su žene uspešne samo ako su vaspitačice, učiteljice, profesorice ili medicinske sestre, koji je razlog što one ne mogu obavljati veće funkcije na rukovodeći mestima. A svi znamo da su daleko manje koruptirane od muškaraca i da hrabro jako odgovorno obavljaju svoj posao na profesionalno način.

Da li ćemo svi zajedno gospodo prećutno odobravati seksualno zlostavljanje mladih devojaka prilikom polaganja ispita na fakultetima ili seksualno zloupotrebu devojaka prilikom konkurisanja za bilo koju vrstu posla, da li će i dalje biti tabu tema naše društva.

Današnja tema sednice posjećena je nasilju porodici, nasilje na decom, starim ljudima, ženama.

Nasilju porodici je akt koji krši ljudska prava, a država je odgovorna o svim postupcima svojih građana. Uključujući akte nasilja u porodici, što je i utvrđeno u opštim načelima konvencije za eliminisanje svih vidova diskriminacije prema ženi, deci, porodici.

Statistički podaci u našoj državi o nasilju porodici su jako zabrinjavajući. Samo za prošlu godinu evidentni su hiljadu sto devedeset i šest slučajeva nasilja u porodici, među njima pet smrtna slučaja, kao posledica nasilja u porodici.

Većina slučajeva je u procesu sudske istrage, to se mora intenzivirati, Zakon se mora poštovati a izvršiooci se moraju oštrije kazniti.

Pre svega treba izmeniti Zakon o zaštiti od nasilja u porodici sa ciljem da se uključi uloga i odgovornosti svake agencije koja se odnosi sa merama za rehabilitaciju i reintegraciju, kao i da se utvrde jasne procedure koje nisu dovoljne jasne u Zakonu a posebno o cilju tog Zakona i drugim pod zakonskim aktima, da bi osigurale pravilno istragu, krivično gonjenje i efikasno nadoknadu žrtve porodice naselja.

Takođe, izmeniti Zakon sa ciljem da počinioci pozivaju kao sumnjivi počinioci, izmeniti Zakon o zaštiti o nasilja u porodici, Zakon o porodici, krivični kod za ciljem da se zabrane alternativna rešenja raznih vrsta sporova u slučajevima nasilja u porodici, u skladu sa članom 48 Konvencije Savete Evrope.

Početi sa izradom i amendamentiranjem krivičnog koda, gde nasilju porodicu treba utvrditi kao krivično delo na osnovnu preporuka Konvencije Saveta Evrope da sprečavanje i suzbijanje protiv žena nasilja u porodici.

Ova konvencija zahteva od države da pruža potrebnu pažnju i da preduzima potrebne zakonske mere, kako bi osigurao istragu i efikasnu krivično gonjenje nije za krivična teška dela.

Ja podržavam ovu inicijativu i rezoluciju o nasilju porodice i od strane moje koleginice iz "Vetëvendosje" smatrajući je univerzalnom, a ne partijskom ili nacionalnom. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arbër Rexha.

ARBËR REXHA: Faleminderit, kryesues!

Urime 8 Marsin, edhe kjo ditë do të duhej të shënonte protestë e revoltë dhe jo festë.

Sidoqoftë, vajzat dhe gratë shqiptare në Kosovë kanë qenë të shtypura gati në të gjitha aspektet e jetës.

Ne e kemi një histori që na dëfton për shkelje në liritë elementare të shkollimit, të menduarit e vepruarit lirshëm të të drejtës në pasuri, e më shumë të të drejtës të punësimit.

Ato janë përballur e vijojnë të përballen me seksizma të përditshme, në shkollë, në vendin e punës, në shtëpi, në rrugë, kudo ku gjenden në sferën private e publike.

Një eksperiment që pati bërë një televizion i Kosovës me një vajzë, sipas stereotipave në shoqërinë tonë quhet e bukur, e cila për një orë ec rrugëve të Prishtinës merr mbi 100 etiketime me motive seksuale, nënçmime dhe ofendime.

Shoqëria jonë, me tone shumë mashkullore ende nuk po mbërrin te vetëdija se vajzat dhe gratë tona nuk janë objekt seksual të prodhimit dhe riprodhimit të punës sistematike në shtëpi, të dhunimit psikologjik në baza ditore, por pa to nuk ka as kombe, as shtet, as institucione, as arsim, as shkencë, as dituri.

Vajzat dhe gratë janë themeli i shoqërisë, edhe i shoqërisë sonë.

Përmes kulturës, vetëdijes e pabarazisë gjinore të një populli mund të kuptohet se emancipimi i saj është një proces i domosdoshëm në të mirën e saj dhe të tërë shoqërisë.

Nëse emancipimi i grave dhe i burrave të një vendit për t'ua njohur të drejtat e për t'i respektuar njësoj, burrat e gratë, përbën vlerën më sipërore të shoqërisë, reagimi i institucioneve të shoqërisë prej shkollës te ligji është mjeti nëpër të cilën shkohet drejtë këtij emancipimi.

Nëse zotohemi për ndërtimin e një shoqërie të drejtë, atëherë ajo nënkupton një shoqëri që e parandalon dhunën pikërisht brenda familjes.

Nuk ka kuptim të flasim për gratë në vendimmarrje, e ato që udhëheqin kur kemi ende zyrtarë të lartë, të cilët janë përgjegjës direkt të neglizhencës që ka dërguar te vrasja e një gruaje nga burri i saj.

Të qenit grua në Kosovë është pa dyshim një barrë e rëndë, po të qenit grua e varfër në Kosovë është rraskapitëse edhe më shumë se sa varfëria.

Ato nuk i lënë të jenë pjesëmarrëse në pronën e përbashkët, edhe kur punojnë, paratë e tyre i mbajnë burrat.

Po edhe nëse janë të shkolluara apo e zotërojnë ndonjë zanat, burrat preferojnë më shumë t'i lënë te shtëpia.

Tradita në mëson pafundësisht qëndrime të çmuara, por rezistenca ndaj traditës na mëson edhe më shumë.

Prej Rilindjes e deri te motrat Qiriazi, ne e kemi dëshminë e përpjekjes për shkollim e angazhim të grave dhe vajzave.

Unë jam për vlerat që na vijjnë prej tyre. Unë angazhohem bashkë me kolegët në Grupit tonë Parlamentar që të mbajmë si prioritet përpjekjet për veprim e reagim në parandalimin e dhunës në familje, e dhunës strukturore që pësojnë gratë dhe vajzat në shoqërinë tonë.

Urime 8 Marsi!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Abelard Tahiri e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Të nderuara deputete, urime 8 Marsi!

Duke marrë shkas nga Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 Marsi, unë sot do të flas në veçanti për dhunën ndaj grave dhe çka është duke bërë Ministria e Drejtësisë aktualisht që të adresoj disa aspekte që mendoj se janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me këtë fenomen.

Ministria e Drejtësisë në qëllimet e saja për të fuqizuar pozitën e gruas është duke punuar paralelisht në disa drejtime.

Në kontekst të implementimit të strategjisë kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë, unë i kam dhënë prioritet pakos së ligjeve, e cila rregullon trashëgiminë, ku bën pjesë Projektligji për noterinë, Projektligji për procedurën jokontestimore dhe Projektligji për trashëgiminë.

Të drejtat pronësore janë kategori kushtetuese dhe bëjnë pjesë në të drejtat themelore të njeriut. Këto të drejta garantohen edhe me konventa ndërkombëtare, të cilat në bazë të Kushtetutës tonë janë drejtpërdrejt të aplikueshme në republikën e Kosovës.

Legjislacioni i Republikës së Kosovës ka qenë mjaftë i avancuar në këtë fushë, ndërsa ne tashmë po i eliminojmë edhe disa probleme që kanë të bëjnë me harmonizimin më të mirë të legjislacionit dhe të mekanizmave për realizimin më efektiv të të drejtave pronësore të grave.

Këto ligje tashmë janë në shqyrtim parlamentar, të cilat qëllim kanë forcimin e pozitës së gruas në raportet familjare, duke përfshirë rolin e saj në trashëgimi dhe realizimin më të lehtë të të drejtave pronësore në familje.

I ftoj deputetët t'i kushtojnë vëmendje dhe t'i mbështetin këto iniciativa që sa më shpejt këto ndryshime t'i vendosim në zbatim.

Përmes këtyre ndryshimeve ligjore gruas në Kosovë do t'i sigurojmë status më të lartë në familje dhe komunitet, më shumë kontroll mbi të hyrat nga pronësia si parakusht për të siguruar rol më të madh të saj në vendimmarrje për të mirën e familjes dhe shoqërisë në përgjithësi.

Unë besoj fuqishëm se fenomeni i dhunës ndaj gruas është drejtpërdrejt i ndërlidhur me pozitën e saj të disfavorshme materiale në familjet tona.

Të nderuar deputetë,

Statistikat tregojnë se deri në vitin 2015 vetëm 18% e grave kanë regjistruar pronë në emër të tyre në Republikën e Kosovës, pra në në kuadër të këtij 18% janë vetëm 3.8% e tyre që kanë trashëguar pronë nga familja.

Nga viti 2015 deri në vitin 2017 kemi një trend të rritjes së ndjeshme, ku kjo përqindje shkon në 20% që kanë regjistruar pronë në emër të tyre, ndërsa 7.8% e pronës vjen nga pronësia e trashëguar nga familja.

Përkundër trendit pozitiv, unë si ministër i Drejtësisë nuk jam aspak i kënaqur dhe jam thellësisht i përkushtuar për ta ndryshuar këtë gjendje.

Të nderuar deputetë,

Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje përcakton masa specifike dhe adreson përgjegjësi konkrete për Policinë dhe gjykatat, në rast të dhunës në familje.

Këto mekanizma i ndërlidh edhe me shërbimet që ofron nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe ajo e Shëndetësisë.

U bëj thirrje të gjitha grave dhe pjesëtarëve të familjes që t'i shfrytëzojnë këta mekanizma dhe t'i raportojnë ato të cilat nuk ofrojnë mbrojtjen ligjore, të cilën ua garanton ligji në Republikën e Kosovës.

Ministria e Drejtësisë me rastin e hartimit të Kodit Penal ka paraparë një nen të veçantë për sanksionim të dhunës në familje.

Në draftin në të cilin këto ditë do të vijë në Kuvend, është propozuar neni 255, meqenëse është ende në fazën e konsultimeve dhe unë besoj që ju do ta përkrahni.

Në këtë mënyrë kemi propozuar që kushdo që kryen dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të presonit tjetër brenda marrëdhënieve familjare të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Gjithashtu kemi përcaktuar që kurdo dhe çfarëdo vepre penale kryhet brenda marrëdhënieve familjare, të konsiderohet si rrethanë rënduese.

Të nderuar deputetë,

Dhe, e fundit për sot, sot kisha një vizitë në Qendrën Korrektuese të Grave në Lipjan dhe atyre u kam premtuar që do t'ua kthejmë ditët e vikendit ashtu siç i kanë pasur me ligjin e kaluar dhe unë shpresoj që këtë do ta përkrahni në një të ardhme të afërt, kur ky ligj për ekzekutimin e sanksioneve penale do të vijë para jush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Të nderuara deputete të Kuvendit të Kosovës,

Deputetë,

Kabinet qeveritar,

Sot është 8 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Gruas. Përshëndetjet dhe urimet nuk mund ta mbulojnë problemin e madh që kemi në këtë vend, problemin e diskriminimit të grave. Gratë janë shumë më të papuna, shumë më të varfra, më shpesh viktimë e dhunës fizike a verbale, në familje a në rrugë. Jo rrallë gratë objektifikohen në reklama e videoklipe, në tekste shkollore e në media, e shumë shpesh dhe në fjalët e një pjese të deputetëve të këtij Kuvendi.

Ato, të cilat sipas statistikave janë të nënshtruarat e shoqërisë sonë, jo rrallë quhen “qenie fisnike”, me eufemizmat e politikanëve sharlatanë. Besimi se gruaja është "qenie fisnike" nuk është i vërtetë, pasi po të besonin ashtu, këta politikanë do të kishin ndërmarrë reforma të thella që hapin tregun e punës për gratë, e do të kishin ndërhyrë për të ndalur stereotipat diskriminuese në media, shkollë e tregje. Por edhe po të ishte i vërtetë, besimi se gruaja është “qenie fisnike” është në vetvete një stereotipizim, refleks i një konservatorizmi patriarkal, si i tillë një nga pengesat serioze në luftën kundër pabarazisë. Njësoj edhe besimi se është qenie e mirë, e brishtë etj. Kohë më parë kur isha në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës më pati bërë përshtypjes se si një pacient teknikun medicinal burrë e quante doktor, ndërkaq gruan doktoreshë e quante motër. Ky pacient, pra, kishte një sëmundje shtesë që e ndante me shumicën e burrave jashtë spitalit.

Kjo hartë mendore gjinore besoj se vjen nga paaftësia për të dalluar barazinë nga identiteti. Paaftësia e këtillë shprehet në bindjen se vetëm entitetet identike janë të barabarta dhe pastaj gjërat e ndryshme janë në mënyrë inherente të pabarabarta. Mirëpo, pabarazia nuk është pabarazi gjeometrike. Sepse barazia nuk është kongruencë e as identitetet sasie. Barazia është barazi

pikërisht mes të ndryshmëve. Meqenëse gratë dhe burrat janë të ndryshëm, pikërisht për këtë arsye ata mund të jenë e duhet të jenë të barabartë. Nuk janë të barabarta vetëm gjërat identike dhe është gabim të mendohet që gjërat meqenëse janë të ndryshme, nuk mund të jenë të barabarta. Dita e Gruas, edhe sot si para një shekulli do të duhej të hapte temën e domosdoshmërisë së punësimit të gruas e të burrit. Lajlululet e të drejtave, e kuotave, e barazisë që predikohet nga lart, s'i bëjnë kurrë njerëz (të barabartë) ata që mjerimi e papunësia i redukton, ku më pak e ku më shumë, në nocione biologjike, meshkuj e femra. Për mua, premisa e emancipimit është punësimi i masave, qoftë për kolektivin që prodhon, qoftë për pavarësinë.

Ndihma ndaj gruas nuk arrihet duke e “shenjtëruar” apo duke e “paternalizuar”, apo duke e bërë “të pakritikueshme” gruan në rastin kur mban një pozicion publik. Ndihma ndaj gruas është çështje e drejtësisë sociale, është hapje e shoqërisë ndaj të vërtetës së barazisë, e jo lëvdata kujdestare e formale. Në anën tjetër, feministët liberalë nuk mjaftojnë, sepse ata përfundojnë në kapërcimin prej një patriarkalizmi tradicional te një patriarkalizëm modern. Ata thonë se po të ketë gra atje lart, do të jetë më mirë edhe për gratë poshtë. Por, një gjë e tillë nuk rezulton e vërtetë. E shohim edhe nëpër botë, se si ka raste të grave të fuqishme që ndjekin politika ultra konservatore. Në jetën institucionale dhe politike, përgjithësisht, gratë në Kosovë nuk marrin pjesë. Kemi dëgjuar teksa insistohet në vendimmarrje të gruas, duke konsideruar që ajo tashmë e ka pjesëmarrjen. Nuk është ashtu.

Gratë në Kosovë përfshihen, ato nuk marrin pjesë. E, gratë duhet të marrin pjesë, të marrin pjesë masivisht, të marrin pjesë të madhe, së paku gjysmën. Pra, ka një kundërthënie mes përfshirjes dhe pjesëmarrjes. Në Kosovë kemi përfshirje të grave, pa pjesëmarrje të tyre. E, përfundi kundërthënies mes përfshirjes dhe pjesëmarrjes ndodhet një tjetër kundërthënie më e thellë, ajo midis integritit dhe çlirimit. Kur ftohesh për t'u integruar, në fakt, ftohesh për t'u përfshirë. Integrimi nuk është integrim në hapësirë të sheshtë, por është integrim në strukturë me hierarki, që do të thotë se është integrim prej lart, por nuk është integrim nga lart, është integrim prej lart por që ndodh poshtë. Në vend të integritit, nevojitet çlirimi. 8 marsi është kundër stereotipizimit gjinor, kundër reduktimit të gruas në nënë, motër, vajzë, shoqe, kundër imazhit të lules së bukur, por të brishtë që ka nevojë për përkujdesje, kundër seksualizmit të imazhit nëpër reklama dhe pro të shpallurit as më pak e as më shumë se njeri, si çdo njeri tjetër. Kjo e fundit, që në fillim, nënkupton shkëputje dhe largim prej biologjikes, “natyrores” dhe zhytje në shoqëri. Kjo kredhje në shoqëri është angazhim për pjesëmarrje, para se të jetë marrje pjesë në angazhim.

Në tubime e tribuna të të gjitha partive tona politike duhet të flasin shumë më tepër gratë. Patriarkalizmi i ashpër dhe kapitalizmi i egër janë rrethanë sulmuese dhe mendësi rrënuese për aktivizimin socio-politik të grave dhe vajzave. Dobësimi i shtetit e godet më shumë gruan se burrin në familje dhe jashtë saj. Prandaj, neoliberalizmi i kontribuon patriarkalizmit dhe e rrit varësinë e gruas nga burri. Është qëllim i “Vetëvendosjes” si subjekt politik ta bëjë gruan të barabartë në angazhim e organizim, e kur të vijë në pushtet, të ndryshojë rrënjësisht strukturën e

tregut të punës, kulturën në institucione publike e në arsim, për t'ia hapur rrugën barazisë. Po ashtu, mbetemi të përkushtuar për ta denoncuar padrejtësinë dhe abuzimin, qoftë kur ai është shoqëror apo sistemik, qoftë kur është individual. E kemi denoncuar abuzimin kur ka ndodhur brenda strukturave tona, pa u trembur prej dorëheqjeve, do ta denoncojmë edhe jashtë, kudo ku ndodhet.

Abuzuesit e diskriminuesit e grave, sado të paguajnë para për marketing e për t'u dukur liberalë, nuk duhet të kenë vend në politikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Korab Sejdiu, nuk qenka këtu. Mirjeta Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot është 8 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Gruas dhe pikërisht sot po zhvillojmë debat parlamentar, ku po diskutojmë për dhunën në familje dhe adresimin institucional, duke shprehur të mos mbetet vetëm debat.

Dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore është e pranishme pothuajse në të gjitha vendet e botës, po ashtu edhe në shoqërinë tonë. Prandaj, kemi sfida dhe obligime institucionale shtetërore që të ndërtojmë një shoqëri ku gratë dhe vajzat mund t'i realizojnë të gjitha të drejtat e tyre sociale, ekonomike dhe kulturore. Në shumicën e rasteve dhuna në familje brenda vetë shoqërisë trajtohet si një problem i brendshëm i familjes dhe për të cilin nuk duhet të flitet jashtë shtëpisë, janë fëmijët, të moshuarit e në shumicën e rasteve

janë gratë viktimat më të shpeshta të dhunës në familje. Në bazë të statistikave të Policisë së Kosovës, nga janari deri në fillim të dhjetorit të vitit 2016 janë evidentuar rreth 1196 raste. Pra, më 2017 janë evidentuar më shumë raste të dhunës në familje në periudhën e njëjtë se të vitit 2016, mirëpo sipas këtyre raportimeve, nuk tregojnë statistikën e sakta, pra nuk tregojnë tërësisht realitetin. Numri i rasteve të raportuara është shumë i vogël kur bëhet fjalë për rastet e dhunës në familje.

Përpjekjet për të parandaluar dhunën në familje janë përcjellë me veprime konkrete edhe në Kosovë, si nga institucionet tona, ashtu edhe nga organizatat si ndërkombëtare dhe vendore, mirëpo akoma duhet bërë shumë në luftimin kundër dhunës në familje. Ne duhet ta forcojmë sistemin tonë të drejtësisë dhe duhet të sigurohemi që bartësve të dhunës t'u jepet dënimi adekuat, sepse Kosova nuk duhet të tolerojë akte të tilla të dhunës. Të drejtat e njeriut janë të drejta themelore, të cilat duhet t'i gëzojë çdo qenie njerëzore. Në Kosovë dhuna në familje përkufizohet si çdo veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton në keqtrajtim e që kryhet

nga një person, i cili është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën, duke përfshirë këtu keqtrajtimin fizik, keqtrajtimin psikik, keqtrajtimin seksual, si dhe keqtrajtimet ekonomike. Sipas dispozitave ligjore, institucionet e kanë për obligim të parandalojnë dhunën në familje, të mbrojnë dhe të sigurojnë viktimat, të ndjekin kryerësit, si dhe të ofrojnë përkrahje, trajtim dhe riintegrim për viktimat e dhunës në familje. Mirëpo, fatkeqësisht nuk është duke u bërë mjaft. E drejta për jetë me dinjitet dhe pa dhunë garantohet me Kushtetutën e Kosovës dhe me ligjet, duke u bazuar në këto garanci, institucionet e Kosovës duhet të marrin veprime konkrete dhe të vazhdueshme në parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje.

Institucionet, po ashtu, e gjithë shoqëria duhet të punojnë më shumë bashkarish që t'i adresojnë dukuritë që e kërcënojnë jetën dhe mirëqenien e qytetarit, duhet të punojnë më shumë në krijimin e një ambienti, në të cilën fëmijët tanë rriten me kujdes, dashuri dhe qasje në shkollim, në frymën e edukatës së lirë nga dhuna dhe stereotipat gjinorë. Dhuna në familje është shkelje e të drejtave të njeriut, prandaj institucionet kanë obligim ndaj qytetarëve që të krijojnë një mjedis në të cilin jetohej pa dhunë. Rastet e dhunës në familje janë reflektim i dobësisë institucionale, andaj të gjithë bashkarish duhet të angazhohemi që të ndërtojmë një shoqëri ku respektohen të drejtat dhe liritë e çdo individi, një shoqëri me vlera, pa dhunë dhe diskriminime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kolege deputete,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pranoni urimet më të mira dhe më të përzemërta për të gjitha femrat me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsin. Liria jonë, demokracia, shtetësia e Kosovës identifikohen thellë me femrën dhe asgjë pa të sot nuk do të kishte vlerën e përcaktuar dhe të merituar që e kemi.

Femra ka qenë dhe është simbol i qëndresës, simbol i sakrificës dhe flijimit gjatë evolucionit shoqëror, ku edhe e ka dëshmuar këtë me përkushtim të madh dhe me punë në tejkalimin e shumë sfidave që i kanë dalë përpara, duke filluar nga krijimi i familjes, përkujdesjes ndaj saj, edukimit dhe rritjes së anëtareve të familjes, gjithashtu duke trasuar frymën kombëtare te gjeneratat dhe njëkohësisht ballafaqese e drejtpërdrejtë aty ku është kërkuar edhe vetëmohimi për të drejtat shoqërore e kombëtare, por asnjëherë nuk është trajtuar mirëfilli dhe, si rrjedhojë e kësaj mungese të emancipimit dhe vetëdijesimit, është diskriminuar dhe keqtrajtuar. Konsideroj se dhuna në familje, si dukuri shumë komplekse e zhvillimit historik e social, lidhet me traditat patriarkale të familjes që rezultojnë me pabarazinë mes burrit dhe gruas, duke dëshmuar diskriminim serioz të gruas në familje dhe përgjithësisht në shoqëri.

Dhuna në familje, nisur nga aspekti socio-psikologjik, ngërthen brenda vetes mungesën e mirëqenies sociale në raport me gjininë femërore, mungesën e mirëbesimit, mungesën e punësimit të grave, mungesën e respektimit të nderit të saj në nivelin e duhur si faktor kyç i njerëzimit, mungesën e vetëdijesimit dhe të gjitha këto mungesa të vetëdijesimit të shoqërisë reflektojnë me tradicionalen e errësuar që na ka përcjellë me shekuj dhe ka reflektuar negativisht ndaj gjinisë femërore, e cila ka duruar dhe ka qenë barrë mbi supe pa vullnetin dhe dëshirën e saj. Ne tradicionalisht jemi të prirë ta konsiderojmë dhunën në familje si një çështje shumë private, familjare dhe si pjesë normale të jetës martesore. Mungesa e vetëdijesimit, emancipimit dhe diskriminimit gjinor po derivojnë dhunën në familje që është një problematikë në vete, për të cilën ne këtu dhe të gjithë qytetarët kanë obligim që me punë dhe përkushtim të evitojmë këtë dukuri për të mirën e shoqërisë dhe për të mirën e vendit tonë.

Realiteti me rastet siç kanë ndodhur në rastin e Diana Kastratit, Zejnepe Bytyqit, Dafinës, Donjetës dhe rasti i fundit i Sevdijes, të cilat pësuan me fatalitet në vendin tonë, më së miri e dëshmon që familja është vendi ku rrezikohet jeta e shumë prej tyre, ku gratë përbuzen, ku gratë fyhen, rrihen, përdhunohen, mandej edhe vriten nga bashkëshortët e tyre, të cilët në vend të mbrojtjes, në vend të sigurisë, në vend të dashurisë, ata përdorin dhunë çnjerëzore ndaj bashkëshorteve të tyre. Kjo situatë bëhet edhe më e rëndë ku reagimi shoqëror është i dobët, i papërfillshëm dhe autoritetet përgjegjëse e shohin si një krim të rëndomtë dhe asgjë më tepër. Studimet e ndryshme kanë vërtetuar se problemi i dhunës ndaj grave është një problem shumë kompleks dhe shumëdimensional. Një ndër problemet e shumta është edhe mungesa e institucioneve, të cilat nuk merren me trajtimin e duhur nga kryerësit e dhunës në familje, të cilët janë të varur nga droga dhe alkooli, aq më tepër ata të moshës së mitur.

Është një shpresë me funksionalizimin e programit, i cili përfshin kompensimin e dhunës në familje, një program që merret me këtë trajtim, po ashtu dhe Ligji për gratë e dhunuara nga lufta dhe kompensimi i tyre. Për dhunën e ushtruar mbi këto gra, për poshtërimet që ju dedikohen për trupin i cili u shfrytëzohet, për inteligjencën që u shkelet këtyre grave, për injorancën që u bëhet, duke filluar nga familja, për lirinë që u mohohet, për gojën që u mbyllet, për krahët që u këputën, për të gjitha këto vështirësi që ato i kalojnë në jetën e tyre, deri tani llogaridhënia ka munguar skajshmërisht. Prandaj, konsideroj me të drejtë se më shumë se progres në këtë drejtim, ne si vend kemi regres.

Ndërmjet fuqizimit të rolit të gjinisë femërore edhe familjet tona si celulë e shoqërisë do të fuqizohen dhe do të reflektojnë mbi proceset demokratike të një shteti, barazia gjinore është një nga parimet themelore të lirive dhe të drejtave të njeriut që e zbaton fuqishëm edhe Bashkimi Evropian dhe bota demokratike. Shfrytëzimi i plotë i potencialeve dhe mundësive të barabarta të gjinive është i garantuar me ligj, arritja e saj është përgjegjësi jona. Ne duhet të vazhdojmë të kërkojmë që të drejtat tona duhet të respektohen, ne duhet të luftojmë për to, ne duhet ta ngremë zërin dhe të mos kënaqemi me premtime të zbrazëta, por të kërkojmë veprime konkrete. Të

luftosh dhe të punosh për t'u dhënë grave dhe vajzave mundësi nuk është luks, kjo është një domosdoshmëri thelbësore për çdo qenie njerëzore në shoqëri.

Unë theksoj me zë të lartë këtu nga kjo foltore nevojën për përfshirjen e grave në procesin e vendimmarrjes, sepse në qoftë se ne dëshmojmë në integrimin e tyre do të jemi të përparuar në ide të reja, në perspektiva të freskëta dhe në talente sipërmarrëse të gjysmës së shoqërisë. Gratë duhet të fuqizohen si një forcë e madhe jetike në jetën sociale, po ashtu edhe politike. Përkushtimi dhe respektimin ndaj femrës në çdo shoqëri, është mënyra më e mirë për të nderuar sakrificën e saj dhe për të ndërtuar një të ardhme të sigurt. Evropa dhe bota nuk mund të na pranojnë me liri dhe të drejta të cenuara njerëzore mes gjinive, integrimi në Evropë dhe në botë nuk mund të shihet i ndarë nga integrimi i gjysmës kryesore të shoqërisë, siç janë gratë dhe vajzat. Avancimi dhe respektimi i të drejtave të barabarta është obligim shoqëror e shtetëror dhe duke i luftuar me çdo mekanizëm dhe me zero tolerancë, në mënyrë që ne të krijojmë vlera të barabarta mes dy gjinive në shoqërinë tonë. Ne jemi pjesë e përbashkët dhe e pandashme e asaj që quhet shoqëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë në radhë të parë i uroj të gjitha nënat në botë për festën e 8 Marsit dhe kam një urim të veçantë për gratë, femrat e burgosura, që të mendojnë që edhe ne kujdesemi si deputetë edhe për atë kategori që ndodhet nëpër burgje, pavarësisht nga veprat që i kanë kryer dhe njëherësh të uroj ty edhe të konsideroj njeriun më me fat që ke lindur në ditën e grave.

Nuk dëshiroj të flas në mënyrë akademike, sepse në qoftë se flasim në mënyrë akademike, veç sa për të folur për veten, po do të koncentrohemi në gjëra shumë prekëse dhe të dukshme që ne i shohim çdo ditë në jetën tonë të përditshme. Në radhë të parë problemi më i madh në shoqërinë tonë për dhunën në familje është mentaliteti ynë i krijuar nga familja, sepse familjet tona gëzohen pothuajse vetëm kur u lind djali. Fakti që ne organizojmë syneti për djalin, 20 mijë euro i shpenzojmë dhe bëjmë festë vetëm për djalin, prapë është diskriminim ndaj vajzës. Te çështja e trashëgimisë, unë mendoj që ajo është një problem që ka ekzistuar dhe ekziston dhe ky problem prapë fillon prej familjes. Zakonisht në filozofinë, në mentalitetin e vendeve perëndimore kur deputetët flasin, ose kur aktorët flasin për dhunën në familje, gjithmonë nisen prej shembullit personal. Për shembull, del një aktore dhe thotë mua më ka rrahur burri, nuk është mirë të rrahët gruaja. Por, del edhe një burrë që thotë edhe mua më ka rrahur gruaja, se ka dhunë të dyanshme, ka dhunë edhe nga ana e femrave, bile unë do të dëshiroja që koleget tona të flasin se qysh na rrahin neve gratë, e na të flasim qysh ato i rrahin burrat, që ta mbrojmë njëri-tjetrin.

Ka dhunë familjare të dyanshme, por prapë po them bazamenti është mentaliteti dhe mosekzistimi i institucioneve. Një qeveri që harxhon miliona e miliona në asfalt dhe nuk

harxhon miliona në ndërtimin e çerdheve, të enteve parashkollore, ku fëmijët tonë do të edukoheshin që të gatuajnë bukë, ajo Qeveri dihet që e diskriminon që në start fëmijën dhe ne, pa i citua filozofët botërorë ose politikanët botëror, e dimë që njeriu që ka luftuar më së shumti për të drejtat e femrave është Sami Frashëri. Ai ka thënë: “Më jep statistikën se sa gra i keni të shkolluara brenda një kombi, unë të tregoj për nivelin kulturor dhe edukativ të atij populli”.

Unë në fund do të flas për diskriminimin më të madh që vetë Kuvendi i Kosovës ua bënë femrave këtu në administratë, sepse Administrata e Kuvendit të Kosovës janë kategoria e femrave më të diskriminuara, qoftë në paga, qoftë në drejtori, ku prej 12 drejtorive në këtë Kuvend, e kemi vetëm një femër drejtoreshë.

Dy, ne që po flasim jemi diskriminues dhe cenuesit më të mëdhenj të të drejtave të njeriut dhe të femrës, sepse ne jemi të zgjedhur këtu që të aprovojmë ligje dhe përmes ligjeve ta luftojmë diskriminimin. Ne në këtë Parlament të Kosovës nuk kemi nxjerrë ligje që përpos nënës, pushimi i lehonisë t’i takojë edhe babës. Ne në këtë Kuvend nuk kemi nxjerrë ligje për sigurimin shëndetësor, për shtesat e fëmijëve, të cilat duhet t’i gëzojë çdo fëmijë i Kosovës deri në moshën 18 vjeç. Ne nuk kemi aprovuar ligje, kur nënës pas lindjes i sigurohet pushimi i lehonisë 12 muaj, minimumi 12 muaj me pagesë, por nënat tona, gratë tona, duhet të vijnë në punë, e prej punës të vrapojnë te shtëpia për ta ushqyer fëmijën mbas katër orëve, prandaj këto janë probleme, këto janë çështje diskriminuese.

Ministri ynë i Shëndetësisë, qoftë i tashmi, qoftë ministrat e kaluar, asnjëherë nuk kanë shkuar në spital ta bëjnë vetëm një pyetje: pse baballarët nuk lejohen të jenë prezentë gjatë momentit kur gratë tona lindin? Edhe ky është një akt tjetër diskriminues, fyes e poshtërues. Prandaj, këto janë gjëra për të cilat ne si deputetë jemi të përzgjedhur.

Po kaloj te çështja punësimet, të mos flas, po por kaloj te konkurset, ne si deputetë duhet ta dimë që këtu hapen konkurse të punësimit duke e përcaktuar moshën që mund të punësohen femrat vetëm nga mosha 20 deri në moshën 26 vjeçe. Këto i lexojmë përditë nëpër gazeta edhe ky është një diskriminim. Unë propozoj që në qoftë se duam ta luftojmë diskriminimin e femrave, edhe dhunën në familje, në prokurori të ketë më shumë femra, gjykatëse të ketë më shumë femra, sepse ai gjykatësi debil që u rrit duke e rrahur nëna hu gardhi, ai në mënyrë automatike ia jep të drejtën burrit, jo gruas dhe dhimbja më e madhe që iu shkaktohet femrave të këtij vendi është momenti i divorcimit. Gjykatat pothuajse gjithmonë të drejtën e përkujdesjes së fëmijëve ia dorëzojnë burrit, dhe a e dini ju çka bën ai burri i kanunit, i merr fëmijët dhe i dërgon që t’ia rrisin gjyshja, nëna apo dajat. Domethënë, kemi plot femra që e kanë të refuzuar nga ana e burrit dhe me mbështetjen e gjykatave të drejtën e takimit të fëmijëve të tyre.

Këto janë probleme që ne mund t’i luftojmë nëpërmjet gjykatave, ligjit. Tjetër, në Policinë e Kosovës, po të isha unë ministër i Brendshëm, minimumi 50% femra të merret me hetimin e

dhunës në familje, jo meshkujt që ecin me duar në xhepa e qesin gjoksin përpara, i thotë femrës “unë të ha ty me dhëmb, kush je ti”. Prandaj, edhe ky është një fenomen, për të cilin ne duhet të mendojmë.

Arsimi, shëndetësia dhe media duhet të dominojnë nga femrat, prandaj, të nderuar deputetë, unë dëshiroj ta mbyll fjalën time me një diçka që dihet shkencërisht që diamanti është rezultat i shtypjes së dyanshme. Gratë tona, motrat tona, femrat tona janë diamant, sepse historikisht kanë qenë të shtypura nga burri, nga familja, rrethi, mëhalla, plus pushteti.

Mbi bazën e kësaj, jam krenar me të gjitha nënat tona, ndërsa sa i përket shembullit personal, meqenëse u fol shumë sot për pronën, unë personalisht i kam pesë motra, jam djalë hasreti dhe shtëpinë, të cilën ma kanë lënë trashëgim prindërit e mi, ia kam fal motrës të tretë, sepse ajo nuk ka pasur shtëpi. Kështu që në qoftë se i keni nga 2 banesa, tri shtëpi, është mirë që t’ua falni motrave, pavarësisht a janë të martuara apo jo dhe të tregoni shembuj konkretë që ne vërtet jemi për mosdiskriminim.

Gjithashtu në fund e thërras ministrin e Drejtësisë që ta fusë si vepër penale rrahjen e fëmijëve. Në çdo vend demokratik evropian, në qoftë se prindërit e rrahin fëmijën, shteti ta merr fëmijën. Kaq, faleminderit, edhe një herë urime të gjitha grave të botës festa e 8 Marsit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Saranda Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Të dashur qytetarë,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Çështja që dua të paraqes këtu sot lidhet me një temë që pothuajse nuk preferohet të trajtohet me seriozitet nga qeveria, me raste edhe nga Kuvendi, po as nga institucionet e tjera në shoqëri.

Edhe pse Lëvizja “Vetëvendosje” ka ngritur disa herë këtë çështje, me amendamente e reagime publike, ende nuk kemi mbërritur që ta vendosim në prioritet, qoftë të qeverive të Kosovës, qoftë të këtij Kuvendi apo nivelit lokal të qeverisjes. Sot gratë kryefamiljare dhe të veja ballafaqohen me shumë probleme të ndryshme, por do të përqendrohemi vetëm në dy çështje. E para, e drejta e pronës dhe, e dyta, e drejta e alimentacionit.

Sot kemi një numër të madh të grave që mbas shumë vjetëve janë ende duke luftuar nëpër gjykata të vendit për të drejtën që u takon me ligjet e Republikës së Kosovës. Diskriminimi që i bëhet gruas qysh nga fëmijëria nga vetë familja, e më vonë nga shoqëria dhe institucionet shtetërore, është i papranueshëm dhe jemi ne ata që jo vetëm se duhet të punojmë që të respektohen ligjet e këtij vendi karshi qytetarëve, por gjithashtu duhet të punohet dhe të ndalen dukuritë e këqija, siç është edhe mosndarja e pronës së barabartë nga prindërit ndaj fëmijëve, pa

marrë parasysh gjininë e tyre. Rasti më i rëndë që kemi pas në Kosovë që nga paslufta është i Shyhrete Berishës. Një grua që ka parë ferrin me sy ku vritet bashkëshorti dhe katër fëmijët dhe për të cilët ende nuk e di se ku i kanë trupat, familja e burrit mundohet t'ia mohojë të drejtën e pronës, ku e ka ndërtuar një jetë të tërë me bashkëshortin dhe fëmijët e saj.

Shyhretja nuk është e vetme, kemi shumë e shumë gra të tjera, ku për shkak të humbjes së bashkëshortit u është mohuar e drejta e pronës. Papërgjegjësia e institucioneve i ka lënë shumë nëna me fëmijë në rrugë dhe pamundësi që të sigurojnë ushqim dhe veshmbathje, për shkak se ish-bashkëshortët nuk u përmbahen vendimeve gjyqësore, ku janë të obliguar për të kontribuar në mirëqenien e fëmijëve të tyre, si dhe mos ndarjes së pronës së përbashkët. Të dyja këto të drejta të shkelura në mënyrë sistematike janë dhunë e strukturuar ndaj grave në Kosovë, ndaj nuk ka asnjë arsye të heshtim pa i adresuar plotësisht e pa punuar me këmbëngulje.

Tani do të lexoj një letër nga Merita Mustafa, gjithashtu të gjithë ju e keni një doracak, ku janë dokumentuar tregimet e grave që janë duke u ballafaquar me këto vështirësi ekstreme.

Letër nga Merita Mustafa, nënë kryefamiljare, drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, 8 mars 2018:

“A e dini se sa gra kryefamiljare ka sot në vendin tonë të divorcuara dhe të veja? A e dini se si jetojnë ato dhe fëmijët e tyre? A e dini se cili është institucioni apo mekanizmi që do t'i kishte adresuar problemet e tyre? Sot do të flas në emër të të gjithave, meqenëse një pjesë e madhe prej jush supozoj se nuk i dini përgjigjet e pyetjeve të lartpërmendura, unë do t'ju tregoj. Ne gratë e divorcuara dhe të veja bashkë me fëmijët tanë jemi një grup i izoluar dhe i diskriminuar nga të gjithë, e sidomos nga ish-bashkëshortët, familjarët, gjyqtarët, avokatët, prokurorët, deputetët, ministrinë, Qendrat për Punë Sociale, Policia dhe rrethi i gjerë. Në qoftë se divorcohesh apo je grua kryefamiljare në Kosovë, shanset për të realizuar të drejtën e pronës janë zero, për çka mund të përfundosh në rrugë dhe kur je nënë me fëmijë. Shanset për të realizuar të drejtën e ushqimit për fëmijë janë shumë të vogla, për çka fëmija mund edhe të vdesë urie. Shanset për punësim janë edhe më të vogla, sepse dihet se ka mungesë të theksuar të vendeve të punës, e sidomos punësimi bëhet edhe më i vështirë për ato, të cilat nuk kanë profesion. Në Kosovë ne gratë e divorcuara dhe të veja nga një jetë normale që kishim, papritur jemi gjetur në një situatë tepër të vështirë, duke mbetur pa kulm mbi kokë, pa ushqim dhe pa asnjë përkrahje. Për shkak të neglizhimit e diskriminimit që na bëhet nga bashkëshortët, gjyqtarët dhe përkrahësit e së keqes, ne dhe fëmijët tanë bëhemi raste sociale edhe atëherë kur nuk ka nevojë.

Pra, edhe atëherë kur burrat tanë gëzojnë pasuri, bëjnë një jetë luksoze, ata mobilizohen dhe korruptojnë të gjitha mekanizmat shtetërorë për të siguruar veten, duke mos ndarë pasurinë dhe duke mos paguar ushqimin dhe veshmbathjen për fëmijët e tyre. Ndonëse, këto janë të drejta bazike që janë garantuar me Kushtetutë dhe ligj, ato vazhdojnë të mos zbatohen për shkak të

mentalitetit patriarkal, i cili është prezent pothuajse në çdo segment të jetës. Sot në gjykatat tona gratë i kanë kërkuar këto të drejta, mirëpo për faj të gjykatësve të pandërgjegjshëm, të korruptuar dhe të anshëm, ato asnjëherë nuk kanë arritur që t'i gëzojnë. Ka gra, të cilat kanë kërkuar të drejtën e pronës në gjykata, mirëpo për shkak të intervenimeve të burrave në gjykata, procedura ka zgjatur deri më 6 vjet, 10, 14 apo edhe 18, e kjo e fundit madje edhe ka ndërruar jetë duke pritur shqyrtimin e lëndës për ndarjen e pronës.

Të nderuar deputetë,

Sot për gjininë mashkullore në vendin tonë divorci mbetet një akt shumë i lehtë, sepse ata përfitojnë nga dobësitë e aparatit shtetëror, i cili nuk arrin që t'i obligojë ata për të marrë përgjegjësi ligjore ndaj gruas dhe fëmijëve të tyre. Është tejet dekurajuese kur shoh biznesmenë dhe profesionistë të pasur, të cilët edhe pse kanë kushte materiale për të siguruar mirëqenie për fëmijët e tyre, ata nuk bëjnë një gjë të tillë, sepse janë të vetëdijshëm se nuk do të obligohen nga askush.

Të nderuar deputetë,

Numri i divorceve në vendin tonë është në rritje e sipër, ndërsa ne si shtet nuk jemi aspak të përgatitur për të trajtuar dhe ndihmuar këto gra dhe fëmijët e tyre. Për të adresuar si duhet këtë problematikë, ne kemi nevojë të bëhemi bashkë dhe ta bëjmë prioritet këtë çështje, duke hartuar ligje më të favorshme dhe duke zbatuar ato ekzistuese, të cilat do të garantojnë zbatimin e të drejtave të grave dhe fëmijëve të tyre. Ato nuk duhet t'i bëhen barrë as shtetit dhe askujt tjetër, përderisa përgjegjësia kryesore u takon prindërve, në këtë rast babait. Për fund, ju lus që të mendoni këtë çështje dhe të gjeni vullnet për të na ndihmuar, e këtë më së shumti bëjeni për hir të fëmijëve tanë”.

Kjo ishte nga Merita.

Merita Mustafa është vetëm një nga shumë gra që ballafaqohen me sfida të shumta në shoqërinë tonë. Sido që të jetë, unë akoma shpresoj se ne gratë dhe vajzat do të gjejmë forcë për të realizuar të drejtat tona. Unë jam rritur me gra të mençura, të guximshme dhe shumë punëtore, dhe kjo më ka mësuar shumë për forcën që kemi për të qenë pjesë e ndryshimeve në këtë vend. Urime 8 Marsi për të gjitha gratë dhe vajzat e këtij vendi! Uroj që në vitet në vijim përnjëmend të festojmë të gjitha së bashku, me shpresën që do të arrijmë të ndërtojmë një jetë më të mirë, sidomos për gjeneratat e reja. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shiniq.)

MUFERA SHINIK: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Urime të gjitha grave festën e 8 Marsit!

Meqenëse u fol shumë deri më tani në seancë, unë me të vërtetë, duke respektuar gjithçka çka koleget kanë biseduar rreth kësaj tematike, dua të vë theksin në fjalën time te një çështje, e cila nuk u diskutua deri më tani, nuk lidhet drejtpërdrejt me dhunën në familje, por gjithsesi është e ndikuar nga dhuna në familje.

Të nderuar kolegë,

Fjalën e kam për bulizmin në shkolla. “Bulizmi” është term i huazuar që përdoret për ta përshkruar dhunën fizike dhe psikike që ushtron një grup i individëve ndaj një grupi tjetër, ose ndaj ndonjë individi, në këtë rast një grup i nxënësve ndaj një nxënësi ose një grupi më të vogël të nxënësve. Gjithë ju që i keni fëmijët në shkolla, keni dëgjuar tregimet se si disa nxënës në shkollë përqeshen për pamjen e tyre, për veshjen e tyre, për performansën e tyre në shkollë, se si askush nuk luan me ta, askush nuk ulet me ta dhe në njëfarë forme, gjatë gjithë kohës ushtrohet dhunë fizike dhe dhunë psikike. Në këto raste, kjo dhunë ndodh në shkollë, por gjithsesi është lidhur me dhunën që në shumicën e rasteve fëmijët përjetojnë në shtëpi, sepse sikur këta fëmijë të kenë mbrojtjen dhe kujdesin prindëror, sigurisht që kjo çështje do të adresohet nga prindërit e tyre, por në shumicën e rasteve këta janë fëmijë, të cilët janë të dhunuar edhe në familjet e tyre, e si rezultat kjo i bën të dallueshëm në shkolla, para së gjithash i bën të duken të pambrojtur dhe këta janë domethënë cak i këtij fenomeni.

Unë konsideroj që ne thjesht këtë çështje nuk mund ta adresojmë përmes rekomandimeve dhe diskutimeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo çështje është shumëdimensionale, është çështje e psikologëve që duhet të jenë prezentë në secilën shkollë të Kosovës dhe do të ishte mirë që faktikisht diçka e tillë të ndodhte, që secila shkollë në Kosovë, e mesme dhe fillore, të ketë psikologun, detyrë e të cilit ose e të cilës do të ishte që pikërisht të merrej me këto probleme të nxënësve. Kjo është një dukuri, e cila shkatërron një segment të shoqërisë dhe është me pasoja të parikuperueshme, për shkak se një fëmijë i dhunuar gjatë fëmijërisë së vet s’ka si të rritet ndryshe vetëm që të bëhet një dhunues më vonë. Unë konsideroj që përpos psikologëve, me këtë çështje duhet të merren edhe institucionet e tjera, e para së gjithash prindërit duhet të punojnë shumë me fëmijët e tyre, në mënyrë që ata t’i edukojnë që shokët dhe shoqet t’i trajtojnë në mënyrë të barabartë.

Kaq kisha për këtë, konsideroj që është një temë që ndoshta një ditë duhet ta diskutojmë si temë të veçantë. Për temën për të cilën diskutuam sot, unë i pashë përfaqësuesit e Qeverisë që disa herë morën fjalën, herë për të na treguara se çfarë po bëjnë për barazi gjinore, e herë për të na uruar, mirëpo ajo çfarë nuk morëm përgjigje sot, ndoshta edhe nuk kërkuam që të përgjigjen, është që të shohim sa është implementuar strategjia për mbrojtje nga dhuna në familje dhe plani i

veprimit që është një strategji prej 350 faqeve, e aprovuar në vitin 2016 dhe përfshin vitet 2016-2020.

Unë dërgova mesazh edhe tek anëtarët e Parlamentit, të cilët tanimë po i përgatisin rekomandimet që do të ishte e rëndësishme që njëra ndër rekomandimet të jetë pikërisht kjo që në një të ardhme të afërt, ndoshta brenda një muaji, ministri i Drejtësisë t'i raportojë ose Komisionit Funkcional, ose Kuvendit rreth implementimit të strategjisë 2016-2020 dhe planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Shfrytëzoj rastin t'ju uroj 8 Marsin nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Kosovës. Çestitam vam 8 Mart! Bütün kadınlarımızın 8 Mart Dünya Kadınlar Gününü kutlarım!

Fjalën e ka Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesuese!

Në fillim të seancës ose para se të fillojë seanca, sinjerisht e kam parashikuar që shumicën e diskutimeve do t'i kemi ne deputetet, gra. Është pak demotivuese, sepse nëse edhe këtu mendohet që punën edhe çështjen e mbrojtjes së të drejtave të gruas e ka gruaja, atëherë mendoj që është shumë gabim. Sidoqoftë, i falënderoj kolegët deputetë dhe i përhëndes për motivin që të qëndrojnë në sallë, disa tërë kohën, edhe për fjalimet që i patën, shumica me vend.

Fillimisht e mendoj si pozitive vetëdijesimin dhe aktivitetin e shumë grave sot në vendin tonë që kanë zgjedhur një lloj proteste dhe pjesëmarrje në konferenca e aktivitete vetëdijesuese, në vend që të zgjidhnin sot një festë bosh me urime shabllone, me këngë dhe valle dhe të nesërmen të vazhdojë një jetë rutinë, me pabarazi. Andaj kam shpresuar që kjo seancë e sotme të ketë këtë frymë të diskutimit në kuadër të vetëdijesimit. Marr pjesë edhe unë në këtë debat parlamentar me vullnetin pozitiv të dëgjoj dhe të kontribuoj, bashkë me ju, kolegë dhe kolege deputete, në vlerësim dhe propozim të agjendave që çojnë përpara këtë sfidë për shoqërinë tonë, barazinë gjinore e sociale, ndalimin e çfarëdo dhune, dënimin e saj duke pasur adresë institucionet tona. Ligji e përcakton dhunën në familje si çdo formë abuzimi, e ushtruar nga një person në një person tjetër, e cila rezulton në dhunim të integritetit të tij fizik, moral, psikologjik, seksual, social ose ekonomik.

Nevoja për reduktimin e dhunës në familje, rastet që i dëgjojmë në përditshmërinë tonë krijojnë emergjencë për infrastrukturë e mekanizma më efikas për zbatim të ligjeve, por mendoj, shumë më shumë se të kërkojmë ligjin si të vetmin mjet, ne duhet të punojmë në emancipim kulturor të shoqërisë sonë, në përgjithësi.

Sepse, në rrënjë të çdo akti dhune, prej asaj fizike, emocionale deri në vrasje. Është ky mentalitet që prodhon këtë fatkeqësi patriarkale, për mendimin tim, ku në thelb burri e sheh gruan si pronën e vet, si qenie inferiore që nuk ka dinjitet, nuk ka pavarësi, s'ka ëndrra, s'ka dëshira.

Mendësi të tilla që i bëjnë marrëdhëniet e dhunshme dhe shoqërinë jo të shëndetshme janë rastet më të shpeshta që raportohen në Polici. Ndryshimi i kësaj mendësie, sigurisht se kërkon forcë dhe vullnet të madh, duke u nisur nga ne këtu në sallë dhe duhet të vazhdojë në gjykata e në Polici, në shkolla dhe gjithkund në shoqëri.

Cilët faktorë e çojnë dhunën në familje? Dhuna në familje pra është një sjellje që rezulton gati gjithmonë e prirë nga nevoja për të treguar pushtet. Kush ndaj kujt? Shumicën e herëve ndaj gruas, ndaj fëmijëve, kohëve të fundit kemi dëgjuar edhe ndaj pleqve. Shumë raste të raportuara në Polici kanë si justifikim konsumimin e alkoolit, drogës, dhe janë bërë shkak për dhunë në familje. Dehja apo të qenit nën efektin e drogës, fatkeqësisht pastaj ka raste kur në Polici kërkohet dhe negociohet për të falur viktimën abuzuesin. Dhe, gratë në raste të tilla që janë viktimë dhe shumë nga to ka që s'kanë, ose edhe s'dinë adresë tjetër institucionale, pos Policisë, mbështetja nga familja u mungon edhe dorëzohen në stacionin e parë. Kthehen përsëri në shtëpi dhe pas një kohe bëhen përsëri viktimë, pastaj e humbin besimin në institucione dhe ka nga to që tutje hezitojnë edhe të raportojnë.

Të nderuar kolegë,

Të respektuar qytetarë,

Më shumë se kurrë mendoj se ka nevojë për një informim anekënd vendit, fushatë me gra dhe vajza, shkurt e shqip t'i informojmë për të drejtën e tyre, për adresat dhe format se si mund të informojnë institucionet për rastet e dhunës.

Po e jap një shembull, unë prita nga Milaimi që po jep nga Suedia, meqenëse kam shumë familjarë dhe më interesojnë këto tema, shpeshherë konsultohem kur kemi raste të veçanta, për shembull, në kopshte fëmijët që nga dita e parë edukohen të raportojnë, nëse fillimisht prindërit, ose kujdestarët abuzojnë me fizikun e tyre, pastaj këta fëmijë, të dy gjinitë, mësohen që këtë t'ua besojnë institucioneve. Edhe në raste kur femrat nuk kanë mundësi të adresojnë me telefonata, edhe në tualete publike vendosen numra të kontaktit, ku ato mund të adresojnë shpejt e shpejt një thirrje për ambiente që mund të jenë të rrezikshme për to, ose raste të tilla.

Unë kërkoj nga organet e drejtësisë vëmendje shumë më të madhe në raste kur kërkohet mbrojtje nga dhuna, vëmendje shumë të shtuar nga policia jonë, në rastet kur gratë raportojnë në Polici. Të ofrohen pra policet gra, që të dëgjojnë gratë në rastet e dhunës, sepse policet gra shumë rrallë, gati kurrë nuk do të kërkojnë asnjëherë që abuzuesi të falet dhe të krijohet një lloj pajtimi në dhomën e Policisë. Dhe, gratë e frikësuara mendojnë shpeshherë, se ato janë fajtores për dhunën që është ushtruar ndaj tyre. Abuzimi mund të prekë, pra çdo aspekt të jetës së këtij personi.

Mund të cenojë shëndetin, edhe mendor, edhe fizik, aftësinë për të vazhduar me punë për të fituar pagën, pastaj raportet me fëmijë, por të qenit viktimë e abuzimit mund të shkatërrojë vetëvlerësimin dhe vetëbesimin dhe, fatkeqësisht, kemi pasur shumë raste kur këto të abuzuara kanë përfunduar me vetëvrasje.

Abuzimi shkatërron ata që nuk viktimizohen pastaj drejtpërdrejtë, janë fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpitë e tyre dhe mund të kenë vështirësi serioze emocionale zhvilluese në jetën e tyre. Pastaj, kemi edhe raste që ata bëhen adoleshentë që emocionalisht janë shumë të paqëndrueshëm dhe ka agresivë nga ata. Megjithëse, ligji tashmë është përforcuar dhe përcakton që dhuna në familje është e gabuar dhe kategorikisht e papranueshme, dhuna në familje ende po mund të konsiderohet nga disa fatkeqësisht si çështje private familjare. Në raste të tilla, të nderuara gra dhe vajza, në raste të tilla mos u dekurajoni dhe përgatituni për të këmbëngulur që të drejtat e juaja të respektohen. Ka njerëz që mund të ju ndihmojnë.

Unë përshëndes vendimin e ministrit, meqenëse shkoi, për reformat në drejtësi dhe besoj se ne si deputete do ta përcjellim hap pas hapi të gjitha këto që i tha më parë dhe unë kam besim, se kjo do të prekë edhe këtë problematikë. Në raste të tilla duhet të qëndrojmë bashkë, pra si gra deputete. Nëse sot vërtet e kemi qëllimin që debati të prodhojë hapa konkretë në ndihmë të kësaj problematike shpresoj që kjo iniciativë nuk e kishte qëllimin e fitimit të poenëve politikë, sepse do të krijonte iritim për të gjitha nga ne, tek viktimat që edhe tani mund të na shikojnë e ndoshta edhe kanë dilema të vazhdojnë të qëndrojnë nën dhunë apo ta raportojnë atë. Kurrë s'do të humbni, gra të dashura, nëse raportoni dhunën, sepse ju do të forcoheni për veten dhe fëmijët e juaj. Abuzuesit do të marrin dënimin dhe do të mësohen edhe të tjerët, që mos t'ia mësyjnë, sepse sot secili qytetar mund të jetë një gazetar në terren.

Unë do të jem kontribuuese në çdo rrethanë, kur e shoh këtë qëllim pozitiv dhe nuk do të kem asnjë pengesë që më shmang të jem pjesë në iniciativa të tilla, që do të rrisin mundësinë për të forcuar këta mekanizma, që mbrojnë qytetarin e qytetaren nga abuzimi i çfarëdo lloji.

Sidoqoftë, gratë në gjithë vendin i uroj nga zemra për arritjet në çdo lëmi, ato që të drejtën e tyre, shkollimin, edukimin, punën profesionale e kanë arritur me forcën e vetë, me shumë vetëbesim. I uroj, jo vetëm një ditë feste, por suksesin e kurajën për çdo ditë të jetës së tyre, për çdo hap që e bëjnë nga mëngjesi në mbrëmje në mbështetje të familjes dhe vetes së tyre. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Tash me theksua që s'është Qeveria, po shihet, por edhe po të ishin këtu nuk kam shpresë se do ta adresonin ndonjë nga rekomandimet e dala nga ky debat, meqë nuk ka ndodhur as në të kaluarën e nuk po shihet se do të ndodh as në të ardhmen.

Unë sot do të flas për gratë të cilat këtë seancë e shohin prapa grilave, pra janë në Qendrën e Paraburgimit dhe në Burgun e Lipjanit, të cilat si pasojë e dhunës në familje dhe dështimit të vazhdueshëm të shtetit për t'u dalë në mbrojtje, përfundojnë në bankën e të akuzuarve, përfundojnë në paraburgim dhe të dënuara me vite të gjata, duke qenë se në shumicën e rasteve ato kanë vrarë apo sulmuar në vetëmbrojtje. Pra, po flas për ato gra të cilat pasi raportuan dhunën e ushtruar ndaj tyre me dhjetëra herë dhe pasi shteti nuk i mbrojti, përkundrazi sa herë që ato raportuan u gjykuan nga mentaliteti patriarkal, i cili ishte prezent qysh nga stacioni i policisë e deri tek trajtimi në burg, ato nga viktimat u kthyen shumë shpesh në agresorë. Pra, atyre u bëhet gjyqi ende pa u marrë vendimi dhe ato gjykohen dy herë.

Po filloj me Policinë, e cila në shumë raste nuk arrin të ju ofrojë përkrahje, kur ato kërkojnë mbrojtje për veten e tyre, ose për fëmijët, për të kaluar te prokuroria e gjykatat, të cilat në mungesë të kapaciteteve i neglizhojnë rastet e dhunës në familje, e ku spiralja e kësaj dhune shpeshherë kthehet në tragjedi. Dhe, vetëm kur tragjedia ndodh, pra kur gruaja vret ose vritet, atëherë na kujtohet që hallka e mekanizmave të sigurisë shtetërore ka dështuar.

Ato automatikisht dërgohen në paraburgim, ku përsëri për shkak të gjendjes së tyre të rëndë socio-ekonomike, sepse kryesisht këto gra vijnë nga familje të varfra dhe kanë një gjendje shumë të rëndë ekonomike, janë të papuna, nuk kanë mundësi materiale që të paguajnë avokat, pra nuk kanë asnjë mbrojtje, seancat gjyqësore ndaj tyre zvarriten, vonohen dhe ato mbesin të harruara, shpeshherë të braktisura, sepse paragjykojnë edhe nga familjarë në paraburgim, që është në kundërshtim me ligjin, por është edhe shkelje flagrante e të drejtave të njeriut.

Për shkak të tenderomanisë, prej viti në vit, ushqimi në këto qendra dhe kushtet është tepër i rëndë. Qëndrimi me vite të tëra nën masën më të rreptë, që është paraburgimi, pra kur ato janë të mbyllura për 22 orë, rrezikon shëndetin e tyre. Ka raste kur dështimi flagrant për të vënë drejtësi na sjell në situatë, kur në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan qëndron një grua që është dëshmitare, pra ajo nuk akuzohet për një vepër të caktuar, por qëndron aty e paraburgosur pa asnjë seancë gjyqësore me muaj të tërë, për shkak se ka qëlluar në rastin e caktuar, ku kryerësi i veprës ka ikur nga vendi i ngjarjes dhe tani ajo mbahet peng. Pra, kjo është drejtësia jonë.

Në rast të sëmundjeve të rënda, kur ato kanë kancer, burgun nuk u siguron terapi dhe ato varen nga mundësitë e familjes. E sa i shtrenjtë është kurimi në të gjithë, e dinë edhe shumica e qytetarëve të Republikës, të cilët janë ballafaquar me raste të tilla.

Çfarë po bëjmë ne? Po takohemi një herë në vit, sigurisht për 8 Mars, ose ndonjë datë simbolike, e mbajmë këtu një debat i cili nganjëherë prodhon edhe disa rekomandime dhe ndonjë rezolutë, mirëpo këtu përfundon gjithçka. Këtu përfundon gjithçka, sepse nuk ekziston një vullnet që këto rekomandime dhe këto rezoluta të kthehen, ose të përkthehen në një strategji mbarëkombëtare, të cilës do t'i prijë Qeveria dhe e cila do të vijë në zbatim përmes dikastereve ministror. Pra,

gjithçka mbetet këtu në Parlament, në debate të thata, ndërkohë që gjendja e tyre vazhdon të vështirësohet prej viti në vit, sepse, të nderuar të pranishëm, çështja e barazisë gjinore fillon nga barazia ekonomike, fillon nga prona, fillon nga sundimi i ligjit, të cilat nuk kanë qenë asnjëherë prioritet, as i qeverive të kaluara, e as i kësaj Qeverie.

Po shihet se gratë në Kosovë nuk jetojnë në një oazë, nuk janë të ndara, prandaj ne sot kur flasim për gratë të gjitha këto probleme janë në fakt problemet e shoqërisë sonë, janë çështje të cilat preokupojnë të gjithë, edhe gratë, edhe fëmijët, edhe burrat, mirëpo për shkak të specifikave që ato kanë, gratë mbi supet e tyre e bartin peshën më të rëndë. Sigurisht, se ne duhet t'i njohim edhe disa të arritura, por nuk mund të mjaftohemi me kaq, sepse nuk mund të kënaqemi dhe të festojmë. Në rast se festojmë do të nënkuptohet se ne e kemi përfunduar punën. Mendoj se në gjendjen në të cilën jemi ne kemi ende shumë punë për të bërë.

Prandaj, unë sot nuk do të ju them “Urime!”, por do të ju thërras që ta vazhdojmë përkushtimin dhe mobilizimin dhe të mos ndalemi për asnjë ditë, sepse vetëm një ditë e harruar dhe një ditë me pak përkushtim për çështjen e barazisë gjinore, do të thotë prapakthim për shumë vite prapa. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Donikë! Fjalën e ka Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zonja nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Mbi të gjitha të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës dhe ju që i përcillni seancat më me kujdes dhe më shpesh,

Besoj e keni vërejtur gati çdo vit kur i mbajmë këto seanca për 8 Mars, që këto janë takimet tona me më së paku interesim e pjesëmarrje të deputetëve. Janë po ashtu seancat me më së paku pjesëmarrje në diskutim të burrave, edhe pse më duhet ta pranoj që jam pak e inkurajuar sot që në të gjitha grupet parlamentare ka një numër deri diku më të madh të pjesëmarrjes në diskutim dhe atë diskutime kualitative që e njohin problematikën, krahasuar me vitet e kaluara dhe po ashtu, një ndër seancat e rralla, kur i vjen radha për udhëheqje një nënkryetareje grua, sepse burrat janë larguar nga udhëheqja e seancës.

Tema që është përzgjedhur sot dhe është kërkuar nga propozuesit e debatit, natyrisht se nuk mund të trajtohet në ngushtësinë e saj, prandaj do ta trajtoj nga tri aspekte të ndryshme: e para dhunën fizike, e dyta dhunën psikologjike dhe e treta dhunën ekonomike. Sa i përket dhunës fizike për shumë njerëz asnjë vend nuk krijon më shumë ngrohtësi, siguri, dashuri dhe qetësi shpirtërore, më shumë se sa momenti i hyrjes në shtëpi dhe kalimi i kohës me familjen. Fatkeqësisht, për shumë gra e vajza shtëpia e tyre është çfarëdo tjetër, pos një vend ku gjejnë ngrohtësi e strehim. Dhuna fizike që ushtrohet kryesisht, por jo ekskluzivisht, ndaj vajzave dhe grave në familje dhe plagët në trupin e tyre fatkeqësisht nuk janë plagët e vetme.

Pasojat që i lë kjo dhunë janë edhe të natyrës psikologjike dhe ato mbesin si plagë të përhershme, jo vetëm tek viktimat e dhunës, por edhe tek anëtarët tjerë të familjes. Prandaj, do të ndalem pak edhe te dhuna psikologjike e cila çdo ditë e më shumë po trajtohet në vendet e përparuara, që ndër të tjera përbën edhe numër më të madh të dhunës në familje, se sa ato që ne mendojmë se po tregohen nëpër institucione apo përmenden nëpër institucione.

Kjo dhunë, pra dhuna psikologjike, ushtrohet jo vetëm në shtëpi, por në shumë raste edhe në vende pune. Kjo mund të jetë më e shpeshtë se ajo fizike, lë pasojat edhe më të mëdha, rezulton me krijimin e ndjenjës së frikës, ndjenjës së inferioritetit, humbjes së vetëbesimit e në raste të caktuara çon edhe deri në vetëvrasje.

Për dhunën psikologjike në shoqërinë tonë flitet shumë pak. Konsiderohet si diçka normale ashtu siç konsiderohej edhe dhuna fizike në familje para disa dekadash. Në anën tjetër, dhuna ekonomike në familje, e cila qysh tani vonë ka filluar të trajtohet si fenomen, që ka të bëjë me pabarazinë ekonomike, me mungesën e pronës së trashëgimisë dhe në veçanti me atë që rezulton, pra me pabarazinë e grave në vendet e punës, tregon shumë drejtë se sot në Kosovë jemi shumë prapa në trajtimin e drejtë të këtyre temave. Mbi 80% të grave sot nuk punojnë, pra nga ato që kanë të drejtë pune në tregun kosovar dhe një problem i madh që edhe sot u trajtua nga disa kolege deputete, është edhe fakti që shumica e nënave vetushqyese trajtohen në mënyrë të padrejtë edhe nga institucione gjyqësore, qoftë sa i përket pronës, qoftë sa i përket alimentacionit.

Shihni tash, në ndërkohë në Kuvendin e Kosovës vjen Ligji për ndërmjetësim, ku ndër të tjera propozohet që ndërmjetësuesit të kenë kompetencën e pajtimit të grave dhe burrave në qoftë se përdoret dhunë fizike apo psikologjike ndaj tyre. Mendoj se ky do të ishte një gabim jashtëzakonisht i madh, për shkak se dhuna fizike apo psikologjike e edhe ekonomike në raste të ndryshme krijojnë, siç e thash, edhe ndjenjën e frikës tek gratë dhe kjo asesi nuk do të duhej lënë në duart e ndërmjetësuesve, sepse dhuna fizike, por edhe mundësitë apo fenomenet tjera të abuzimit duhet patjetër të vazhdojnë të trajtohen, jo vetëm si vepra penale, por edhe vepra që trajtohen në gjykata.

Nga ministri i Drejtësisë u përmend më herët Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, i cili parasheh dënimin me gjobë deri në 3 vjet në raste të dhunës fizike, psikologjike apo fenomeneve të tjera të ngjashme. Unë mendoj se mundësia e dënimit me gjobë duhet të largohet në tërësi. Duke qenë person që ka punuar një kohë në gjykata dhe duke parë raste të shumta edhe të trajtohen raste të incestit familjar, edhe raste të dhunës në familje, fatkeqësisht në shumë prej këtyre rasteve, por edhe nga broshura që sot u shpërnda, e shihni një padrejtësi të madhe në trajtimin e tyre nga ana e gjykatave. Pra, shumë prej tyre trajtohen vetëm me gjobë, duke i lënë pastaj gratë prapë nën mëshirën e dhunës.

Prandaj ne, jo vetëm gratë deputete, por edhe burrat, që tani duhet të refuzojmë mundësi të tilla, siç ishte edhe lënia e kësaj kompetence në duart e ndërmjetësuesve, sepse siç e ka thënë edhe një senatore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëse nuk je pjesë e tavolinës ku merren vendimet, patjetër që do të jesh pjesë e menysë. Kështu që nuk duhet të lejojmë që ne të jemi pjesë e menysë dhe dikush tjetër të marrë qëndrimet e grave në institucione, por edhe në emër të të gjitha atyre që nuk mund të flasin, të vendosim për çështje të tilla.

Përfundimisht, më duhet të përmend, siç e thash edhe në fillim, që ka edhe zhvillime inkurajuese duke filluar nga fakti që shumë më shumë burra po marrin pjesë në këtë debat krahasuar me vitet e kaluara, por akoma shumë pak në numër krahasuar me sa shqetësuese është kjo temë. E dyta, para disa ditësh dëgjuam një veprim inkurajues, për të cilin kemi bërë thirrje bashkë me shumë kolegë e pavarësisht në cilën parti janë, emërimin e parë të një gjeneraleje grua, që jep mesazhin se nuk duhet të ketë dallim mes profesionesh dhe është një shuplakë ndaj secilit zyrtar, përfshi edhe disa zëvendësministra që në të kaluarën thoshin “ushtria e diplomacia nuk janë për gra”. Pas shumë vitesh me përpjekje të shumë grave deputete e politikane të të gjitha niveleve, trajtimi i temës së viktimave të dhunës seksuale më nuk është tabu, por shpresoj që secili prej jush do të vazhdojë të japë kontribut në këtë aspekt. Natyrisht, që secili prej nesh e kupton që lufta për barazi gjinore nuk është e vetëm kësaj gjenerate. Unë e kam parë në mënyra të ndryshme këtë luftë ta bëjnë dy gjyshet e mija, e kam parë në mënyra të ndryshme këtë luftë ta bëjë nëna ime, natyrisht e bëj edhe unë, ndonëse shpresoj se do ta rris intensitetin e kësaj lufte së bashku me të gjithë ju që besoni në barazi në këtë shoqëri dhe jam e bindur, se këtë luftë do ta vazhdojnë edhe dy vajzat e mia. Mirëpo, shpresoj shumë që betejat në të cilat kam kaluar edhe unë në profesionet e mija, po besoj edhe shumë prej jush si gra në politikë, nuk do t’i kenë vajzat tona.

Shpresoj shumë që lufta jonë do t’i eliminojë shumë prej pengesave që ne i kemi pasur, në mënyrë që betejat e tyre të jenë më ndryshe dhe më kualitative.

Dhe përfundimisht, siç e tha edhe kolegja Kadaj, kemi prodhuar vërtet shumë rezoluta, shumë letra, që kanë mbetur në fiokat e këtij Kuvendi, të cilat nuk po implementohen sot dhe kjo na dëshmon se kjo më shumë se sa çështje strategjish, çështje dokumentesh e letrash, është çështje mentaliteti. Prandaj, në çdo debat dhe jo vetëm më 8 Mars, por çdo ditë, ne duhet ta kujtojmë fotografinë e Zejnepes, Dianës e shumë viktimave të tjera të dhunës dhe në qoftë se, nuk e kuptojmë se ky mentalitet nuk ndryshon përderisa secili prej jush, burra e gra, nuk e kupton që në atë fotografi një ditë mund të jetë cilado vajzë, e cilësdo familje, atëherë ky mentalitet nuk do të ndryshojë. Në atë fotografi, përtej buzëqeshjes, ne secili duhet ta shohim vuajtjen, zymtësinë, por mbi të gjitha turpin e kësaj shoqërie, të cilin duhet ta luftojmë me më shumë, se sa dokumente që prodhohen në këtë Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Evgjëni Thaçi-Drăgusha.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Meqenëse jemi afër përfundimit të debatit, u konstatua se dhuna në familje në trajta të ndryshme ekziston kudo, ekziston edhe në Kosovë. Si e tillë, është e vjetër sa vetë shoqëria. Nga vetë definicioni i saj dhuna në familje përfshin të dy gjinitë, prandaj inkurajoj të gjithë deputetët pavarësisht nga gjinia, që të inkuadrohen në diskutim dhe të japin kontributin e tyre me ide për zbutjen e këtij problemi.

Po ashtu, u konstatua se kemi ligje që rregullojnë këtë problem, për të cilat pajtohem se duhet të ndryshohen dhe plotësohen, sepse nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme në parandalimin e dhunës dhe në mbrojtjen e viktimave, mirëpo është e lehtë të bëhen ligje të mira e problemi ekziston në zbatueshmërinë e tyre.

Është shumë shqetësuese që pikërisht organet dhe njerëzit, që janë të thirrur të zbatojnë ligjin dhe të mbrojnë qytetarët, jo rrallëherë janë pikërisht ata që kryejnë dhunë në familjet e tyre. Kemi raste të shumta kur politikanë, policë, avokatë, paditen nga bashkëshortet e tyre për ushtrim të dhunës. Fatkeqësisht, këto raste heshtën dhe kalohen sikur të mos kishin ndodhur kurrë, mbesin si sekrete publike. Janë raportuar raste kur viktimat e dhunës janë pritur me fjalë të ashpra e nënçmuese. Kjo shkon në favor të dekurajimit të viktimave për të kërkuar ndihmë, mbrojtje e drejtësi. Kjo nuk i përket një shoqërie demokratike ku respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Familja është celula e shoqërisë dhe e shtetit dhe duhet ta mbrojmë dhe respektojmë atë me çdo mekanizëm që kemi në dispozicion. Në këtë kauzë ju ftoj të jemi të bashkuar pa asnjë dallim, qoftë partie, ideologjie, etnie apo dallim tjetër që mund të na ndajë.

Një aspekt tjetër ku duhet të punojmë paralelisht për parandalimin e dhunës në familje është edukimi dhe puna me fëmijë, djem dhe vajza të reja, për të promovuar marrëdhënie respekti dhe barazie. Puna me të rinjtë është për përparim të shpejtë dhe të qëndrueshëm për parandalimin dhe çrrënjosjen e dhunës në bazë gjinore. Fëmijëria është mosha më e rëndësishme për krijimin e vlerave dhe normave, që i përkasin një shoqërie të shëndoshë. Për këtë duhet mobilizim i të gjithëve, duke filluar nga prindërit, mësuesit, e po ashtu mediet dhe institucionet shtetërore për ta ngritur vetëdijen për këtë problem. Shtëpia ku jetojmë duhet të jetë strehë e sigurt për banorët e saj.

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Më lejoni që me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, dita kur ne festojmë të arriturat e grave në mbarë botën, dita kur ne ngremë zërin për mbështetje dhe njohje të të drejtave tona për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike dhe ekonomike, t'i uroj vajzat, gratë, nënat dhe gjyshet tona të dashura dhe t'u shpreh mirënjohje për çdo gjë që kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë për familjen dhe vendin tonë. Unë shpreh nderim dhe përkulje për vuajtjet dhe sakrificat e tyre. Sot

ndjej krenari me historinë dhe të arriturat tona. Jemi treguar të zonjat në mbrojtjen e atdheut, duke përmendur Shotë Galicën e gra para saj, e më vonë Xhevë Lladrovcin e deri te gjeneralja e FKS-së, e graduar së fundmi.

Jemi treguar të zonjat në shkencë dhe krenohemi me doktoreshat, mësueset, inxhinieret e deri te astrologia e re, që sivjet u nderua nga NASSA. Krenohemi me sportistet tona, të cilat na emocionojnë me paraqitjet e tyre anembanë Botës duke ngritur flamurin e Kosovës aty ku asnjë nga ne nuk kemi mundur të imagjinojmë të ndodh diçka e tillë. Në muzikë, në art, përgjithësisht vajzat tona na e zbardhin fytyrën. Në politikë mos të harrojmë se kemi qenë vendi i parë në rajon me një grua për presidente të Kosovës. Gratë ambasadore, ministre dhe pozita të tjera politike bëjnë përfaqësimin më dinjitoz të mundshëm në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Këtu në Kuvend ka gra aktiviste të hershme, humaniste, ish të burgosura politike, të cilat nuk ngurruan që edhe jetën e vet ta rrezikojnë për Lirinë dhe Pavarësinë e këtij vendi. Ka gra profesioniste të cilat mbrojtën Pavarësinë e Kosovës sa herë që u desh, deri në instancat më të larta të drejtësisë ndërkombëtare. Ka gra të zonja, që me përkushtim dhe vendosmëri e kryejnë çdo detyrë që marrin si deputete të këtij vendi.

Kolege të nderuara,

Unë dhe Kosova krenohemi çdo ditë me ju, ashtu siç krenohemi edhe me deputetet e tjera nga legjislaturat e kaluara. Nga ana tjetër, ka akoma shumë punë për të bërë, në mënyrë që gratë të trajtohen me dinjitet dhe respekt, ta kenë pozitën që u takon në shoqëri. Në fund të fundit, t'i gëzojmë të drejtat dhe liritë që na i ka dhënë Zoti, së bashku me jetën. Varet nga ne se sa jemi këmbëngulës që t'i mbrojmë ato në një shoqëri patriarkale, siç është kjo e jona. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka Fitore Pacolli.

FITORE PACOLLI: Faleminderit!

E nderuar nënkryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Dhuna ndaj grave është çështje pushteti dhe kjo po dëshmohet çdo ditë edhe në këtë Parlament.

Kryeministri s'qenka këtu, mirëpo nëse e keni dëgjuar kryeministrin sa herë që u drejtohet deputetëve, u drejtohet me fjalën "burra". Pra, kryeministri duhet ta mësojë se nëse flet për trajtimin e barabartë të grave, trajtimin e barabartë të grave duhet ta fillojë që nga Kuvendi. Kur Albulena e ngriti çështjen e fyerjeve që ju bënë grave në këtë Kuvend nga disa burra, për çudi reagon vetëm disa deputete të PDK-së. Kjo më solli në mendje argumentin e shkencëtares politike N. Phillips, e cila argumenton se burrat nuk mund të përfaqësojnë gratë në politikë, sepse

gratë kanë interesa, nevoja dhe eksperiencia të ndryshme nga burrat dhe se çështjet që kanë të bëjnë me gratë, si dhuna në familje, abuzimi dhe diskriminimi seksual, varfëria te gratë e shumë çështje të tjera, mund të përfaqësohen vetëm nga gratë dhe për këtë arsye duhet të ketë përfaqësim të barabartë të të dy gjinive në parlament.

Unë pajtohem këtu me N. Phillips se në Parlament duhet të ketë 50% gra dhe 50% burra, por në Kuvend duhet të ketë gra që njëmend përfaqësojnë gratë dhe vajzat e jo si ato deputete të PDK-së, të cilat e përkrahën liderin e tyre dhe të tjerët të cilët kanë fyer në këtë Kuvend edhe kur ata i shkelën të drejtat e grave deputete këtu.

Është mirë që sot këtu kemi veshur këto bluzat që na i dhuruan në fillim, ku shkruan “Ti je një luledielli” për të përkrahur fushatën për ndihmën fëmijëve të prekur nga sëmundjet e gjakut si leukemia dhe kanceri, por nuk mjafton me kaq. Këtu disa prej deputeteve gra dhe deputetëve burra veshën këto fanella dhe po mendojnë se kjo mjafton, mirëpo kur u kërkua nga këta burra dhe këto gra që të votojnë për më shumë edukatorë nëpër shkolla, ku kemi fëmijë me nevoja të veçanta dhe kanë nevojë për edukatorë shtesë, atëherë këta votuan kundër.

Pra, kjo është një hipokrizi. Mos i vishni këto fanella, nëse nuk i përkrahni këta fëmijë dhe mos i vishni fanellat vetëm që të dukeni mirë në publik dhe të bëni fotografi.

Shoqëria jonë është ende patriarkale, fatkeqësisht. Ende vazhdon t'i mësojë fëmijët qysh në moshën e hershme për pushtetin, pushtetin që e kanë djemtë mbi vajzat e pastaj burrat mbi gratë. Ky lloj pushteti në Kosovë ka marrë përmasa shqetësuese dhe ky lloj pushteti po vret shoqërisht, mendërisht e jo rrallë edhe fizikisht. Sot si shoqëri po ballafaqohemi me këtë fenomen të rrezikshëm i cili mund të marrë përmasa edhe më të rrezikshme nëse nuk e adresojmë saktë dhe drejtë. Numri i grave të cilat po vriten nga burrat është në rritje, ndërsa numri i burrave që po dënohen për veprën e kryer është përherë më i vogël. Krimi që po kryhet nuk po ndëshkohet. Ky fenomen nuk po prek vetëm gratë, por po prek shoqërinë në tërësi, po prek sidomos fëmijët dhe burrat.

Pabarazia gjinore është një gjendje shoqërore e karakterizuar nga vlera e pabarabartë, që u jepet burrave dhe grave dhe një shpërndarje e pabarabartë e fuqisë, burimeve dhe mundësive ndërmjet tyre. Normat, praktikat dhe strukturat e tilla inkurajojnë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë të miratojnë identitete të dallueshme gjinore dhe role të stereotipizuara gjinore brenda një hierarchie gjinore, që historikisht i pozicionon burrat si superiorë ndaj grave.

Një shoqëri pa dhunë ndaj grave nuk është një shoqëri ku gratë janë vetëm të sigurta, por ku gratë respektohen, vlerësohen dhe trajtohen të barabarta në jetën private e publike. Studimet e Kombeve të Bashkuara të Komisionit Evropian të Bankës Botërore dhe të Organizatës Botërore

të Shëndetësisë gjejnë se arsyet kryesore, ose kushtet që dërgojnë tek dhuna ndaj grave në kontekstin social është pabarazia.

Në Kosovë, si për shumë çështje tjera qeveritë që nga paslufta kanë hartuar shumë strategji, në mesin e tyre edhe Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për mbrojtjen nga dhuna në familje për vitin 2016-2020, por si gjithnjë këto strategji kanë përfunduar nëpër sirtarët e institucioneve përkatëse. Janë organizuar edhe shumë kampanja vetëdijesuese nga shoqëria civile dhe shumë protesta kundër dhunës, që po merr jetë grash. Por, pavarësisht efekteve që mund të kenë pasur këto aktivitete dhuna mbi gratë po vazhdon. Shteti i Kosovës dhe shoqëria në përgjithësi ka bërë shumë pak për të shpëtuar jetën e Donjetës, Zejnepes, Dianës e shumë grave tjera. Ne sot kemi përfunduar në një shoqëri e cila reagon vetëm kur akti të ketë ndodhur. Sot në vendet perëndimore ka konsensus të gjerë se parandalimi është i mundur dhe se ka mundësi edhe praktika, të cilat mund të parandalojnë dhunën e vazhdueshme ndaj grave. Prandaj, si shtet duhet të fokusohemi në parandalim.

Studime dhe analiza të shumta ndërkombëtare po ashtu edhe lokale kanë treguar që dhuna ndaj grave është dukshëm dhe vazhdimisht më e ulët në vendet ku ka të drejta ekonomike, sociale e politike dhe në vendet ku këto të drejta ekonomike, sociale e politike mbrohen pra të grave mbrohen më mirë dhe ku pushteti dhe burimet janë të shpërndara në mënyrë të barabartë midis burrave dhe grave.

Prandaj, më shumë të drejta ekonomike, sociale e politike për të gjitha gratë dhe ndarje të barabartë të pushtetit dhe burimeve në mes grave dhe burrave do të kemi më pak dhunë në shoqërinë tonë. Andaj, ne sot kemi ftuar debat nga i cili kemi propozuar që t'i nxjerrim disa veprime konkrete.

Përpjekja për të drejtat, është një përpjekje e sakrificës. Njëjtë edhe ajo për të drejtat e grave. Pra, kjo përpjekje njihet ndërkombëtarisht prej 8 Marsit 1909 në Nju-Jork, e ende vijon sot këtu në botë. Nuk bën të ndalemi as ne këtu në Kosovë. Organizimi e angazhimi për të drejtat e gruas është një çështje shoqërore e politike, një çështje për të cilën ia vlen të punosh çdo ditë.

Ne angazhohemi që të veprojmë sa më shumë e sa më dendur që mundemi drejt ndryshimit të kësaj gjendjeje të rëndë.

Prandaj, të gjitha gratë duhet të angazhohen dhe së bashku të mos ndalen dhe të veprojnë sa të munden, deri në arritjen e të drejtave të barabarta në shoqëri. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Xhevahire Izmaqi, dy minuta i ke, Xhevahire.

XHEVAHIRE IZMAKU: Unë e kuptoj se si deputete e re po mundohet zonja që sa foli të dalë në televizor pak më e theksuar, duke e përmendur PDK-në, por reagimi ynë ndaj zonjës Haxhiu ishte për arsye që ishte hipokrizi ajo çka foli, se ne e dimë shumë mirë që ne vetë iu kemi nënshtruar dhunës si gra në këtë Parlament pikërisht duke përdorur atë dhunë edhe metodat, e fatkeqësisht zonja Haxhiu ka qenë nën urdhrat e kolegëve të vet.

Ndërsa sa për fyerje, e dimë shumë mirë se çka i ka bërë partia e vet zonjës Dërguti, edhe asnjë reagim kurrë nuk e ka pasur, domethënë fyerjet e linçimet më të mëdha janë brenda subjektit të vet. Kështu që mendoj që s'ka kurrfarë logjike çka ajo foli, domethënë nuk ishit aspak të interesuar në atë kërkesë që e keni bërë për dhunën ndaj gruas, po ishit të interesuar t'i fitoni disa poenë, por realisht nuk i fituat ata poenë, sepse e dimë shumë mirë kush ka qenë ushtrues dhe promovues i dhunës në këtë sallë, asnjëherë s'kanë qenë gratë e PDK-së, po kanë qenë pikërisht gratë e "Vetëvendosjes", e fatkeqësisht mendoj që edhe janë keqpërdorur.

Pra, nuk është qëllimi të reagoj ndaj fjalës, po ndaj veprimeve që kanë ndodhur, e dimë shumë mirë ku na çojnë ato vendime, asnjëherë nuk keni reaguar, po edhe fyerjet brenda subjektit tuaj, e tash po reagon për kolegen.

Më vjen keq, nuk i kisha reaguar zonjës Haxhiu me kohë, mirëpo tash më bëri përshtypje, sepse si duket e ka pritur këtë moment Fitorja të dalë pak më shumë e theksuar në televizor, po PDK-ja kurrë s'i ka prirë dhunës, as nuk i prin. Më së paku gratë e PDK-së kanë marrë pjesë në këtë aktivitet. Faleminderit, kryesuese!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Kundër-replikë, fjalën e ka Fitore Pacolli, një minutë e ke, Fitore.

FITORE PACOLLI: Xhevahire, nuk është poenta të dal në televizor, po duket se t'i e paske atë problem.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë, atëherë nuk kam qenë deputete, i kam parë në televizor, ashtu si i kanë parë të gjithë qytetarët e Kosovës, kur kryetari i këtij Kuvendi fyen rëndë deputeten tonë, po ashtu edhe deputetët e tjerë, të cilët kanë përdorur fjalë të pamatura ndaj deputeteve.

Prandaj, si deputete duhet të bashkohesh bashkë me ne dhe t'i kundërshtojmë, sepse liderët nuk duhet t'i mbrojmë kur ata i shkelin gratë e tjera, sepse nuk ka të ardhme në këtë mënyrë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputetja Besa Gaxheri.

BESA GAXHERI: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolege e kolegë deputetë,

Sot ne po diskutojmë për një temë, siç është dhuna në familje, e familja është bazament i çdo shteti.

Fatkeqësisht interesimi është minimal, në radhë të parë i Qeverisë, e pastaj edhe i ne deputetëve për të qenë në sallë dhe për të qenë të angazhuar rreth kësaj çështjeje.

Megjithatë, pasi ne sot kemi vendosur për datën 8 mars të diskutojmë për këtë temë, nuk mund të anashkalojmë pa e shfrytëzuar rastin t'i uroj të gjitha gratë për 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, dhe normalisht që kisha pasur dëshirë që sot në këtë ditë të veçantë për gruan, e në veçanti për gruan shqiptare, me historinë e gjatë tonën të dhimbshme, kisha pasur qejf të dal para atyre me suksese dhe rezultate shumë më të mëdha.

Ne edhe kur duam të diskutojmë për temën, siç është dhuna në familje, fatkeqësisht asocion në dhunën ndaj gruas.

Kjo temë është e gjerë, por unë do të fokusoj diskutimin tim duke u orientuar në gjendjen aktuale të dhunës në familje në Republikën e Kosovës, edhe në legjislacionin, i cili ishte dashur të parandalojë dhunën si dhe shkaktarët dhe pasojat.

Kur flasim për gjendjen aktuale të dhunës në familje në Republikën e Kosovës, nuk kisha pasur dëshirë të thirrem në statistika, sepse kjo çështje është përtej statistikave, është emocion, është dhimbje, është trishtim dhe është papërgjegjësi e institucioneve, në radhë të parë.

Dhe, pa dashur të relativizojë gjendjen, nëse bëjmë krahasimin me regjionin edhe më gjerë shohim se dhuna në familje është e shprehur në çdo vend të botës, veçse dallimi është në faktorë dhe specifika të vendeve. Dallimi është efënca e ndëshkueshmërisë, pra respektimi i ligjeve, të cilat janë në mbrojtje të viktimave, e në këto raste shumica e viktimave janë gratë dhe fëmijët.

Po e theksoj vetëm vitin 2017, kemi të dhëna se janë evidentuar 1196 raste të dhunë në familje.

Terminologjia “dhunë” është e gjerë: dhunë fizike, dhunë emocionale, dhunë seksuale, deri tek vrasja, pra, me dhunë. Ne arsyeshëm fokusohemi te rastet më të rënda, siç janë vrasjet, e që fatkeqësisht pothuajse çdo vit kemi së paku nga një grua apo vajë të privuar nga jeta.

Ndërsa për lloje të tjera të dhunës, të cilat janë shkak që pason vrasja, ne nuk i trajtojmë fare apo vetëm përciptazi.

Atëherë shtrohet pyetja, sa janë përgjegjëse institucionet e vendit për të parandaluar dhunën në familje? A kemi në ligjet e mjaftueshme për këtë çështje? A zbatohen ato? A ka drejtësi dhe mbështetje për viktimat e dhunës në familje dhe fatkeqësisht përgjigja është: jo mjaftueshëm!

Do të ndalem te legjislacioni për dhunën në familje në Republikën e Kosovës. Kosova ka miratuar disa detyrime ndërkombëtare, duke inkorporuar standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si pjesë e së drejtës së aplikueshme.

Kosova emëroi në mënyrë specifike konventat ndërkombëtare, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokollet e saj të zbatueshme drejtpërdrejt në ligjet e Kosovës.

Kosova, pra ka hequr dorë nga zbatueshmëria e ligjeve të saj dhe akteve të tjera të institucioneve publike në rastet kur ato bien ndesh me dispozitat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kosova kështu i konsideron këto dispozita ndërkombëtare që të kenë prioritet mbi ligjet e Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës thekson se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Dhuna në familje është akt që shkel të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut janë të drejta themelore, në të cilat ka të drejtë çdo qenie njerëzore.

Zbatimi praktik i këtyre klauzolave kushtetuese rrallë është përdorur në gjykatat e Kosovës.

Në instancat e tjera, në kuadër të gjykatave të ligjit dispozita kushtetuese për zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të dispozitave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk është dokumentuar sa duhet në Kosovë.

Pra, janë bërë 10 vjet nga hyrja në fuqi e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, nga viti 2008 e deri më sot më shumë se 15 gra janë vrarë, mbi 20 mijë gra kanë raportuar për dhunë në familje, mbi 68% të grave kanë përjetuar dhunë në forma të ndryshme.

Jemi të sigurt që drejtësia për secilën grua është e stërvonuar me vetë faktin se sa lëndë janë të trajtuara nga ana e drejtësisë, edhe ato pak raste që janë trajtuar nga vetë gjykata, dënimet kanë qenë shumë të buta në krahasim me krimet e bëra në familje.

Për të mos i përmendur të gjitha vrasjet e grave dhe dënimet për këto vrasje, po e përmend gjykimin e fundit të mbajtur para dy ditëve për vrasjen e Donjeta Pajazitajt.

Të gjithë jemi shokuar, i dyshuari mbahet dy vjet e gjysmë në burg dhe në fund lirohet i pafajshëm.

Dhe shtrohe pyetja, çfarë drejtësie është kjo, kur organet e sigurisë, prokurori dhe gjykatat, për vrasjen makabre të Donjetës burgoset një të dyshuar dhe pas dy vjetësh e gjysmë thonë: “Jo, ky nuk qenka vrasësi”.

Në këtë rast organet kanë dëmtuar familjen që prite drejtësi, pra, familjen e Donjetës dhe kanë dëmtuar edhe të dyshuarin, në qoftë se vërtet ai s’qenka vrasësi.

Ky është shembulli konkret se sa funksionon drejtësia në Kosovë, e sidomos kur vrahët një vajzë apo një grua.

Të nderuar kolegë deputetë,

Disa nga shkaktarët që shkaktojnë dhunë në familje janë dhuna shekullore e regjimeve mbi popullin shqiptar që ka ricikluar dhunë mbi ne me të dobëtin dhe është bërë pjesë e sjelljes së shoqërisë sonë.

Traumat e patrajtuara të shkaktuara nga lufta e fundit, e tmerrshme dhe e pabarabartë në Kosovë.

Gjendja ekonomike dhe sociale e rëndë në Kosovë, privimi i gruas nga e drejta në trashëgimi familjare.

Cilësia e dobët në arsim dhe edukim.

Mosfunksionimi i drejtësisë.

Pra, i kemi pasojat, me një fjalë, në atë shtet ku dhunohet, vritet e nuk respektohet gruaja, nuk ka të ardhme.

Të nderuar kolegë deputetë sot në këtë sallë dhe në veçanti kolege deputete,

Ju ftoj, sepse ne vërtet jemi dëshmitare, sidomos në historinë tonë të dhimbshme të Kosovës që kemi përjetuar gjithfarë lloj etapash të historisë, me dhimbje, me sakrificë dhe ne nuk jemi dorëzuar dhe s’do të dorëzohemi.

Kosova ka ndryshuar shumë, por para vetes kemi obligime të mëdha dhe ne bashkë mund ta ndryshojmë mirëqenien e familjes tonë dhe mund ta largojmë dhunën nga familjet tona.

Ne gratë, ne politikanet, jemi dëshmitare ose kemi të drejtë të jemi krenare që në shtetet më të zhvilluara sot, kudo që gratë bëjnë politikë, nuk kanë përjetuar si ne etapa historike siç ishte apartheidi, lufta, tranzicioni dhe bërja e shtetit.

Prandaj, ne jemi dëshmi para të gjithëve se mund të ndryshojmë gjendje dhe këtë do ta bëjmë dhe duhet ta bëjmë. Faleminderit!.

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Gaxheri! Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zonja Shinik!

Me që jemi në fund të debatit, realisht u thanë shumë gjëra, ndoshta edhe do të përsëritëm me kolegët e mi që ishin sot në këtë sallë dhe në këtë debat.

Natyrisht që edhe unë jam e inkurajuar me faktin që krahasuar me herëve të tjera ka pasur një përfshirje më të madhe dhe të kolegëve tanë, të cilët e kanë adresuar shqetësimin e dhunë në familje dhe në këtë seancë, por po ashtu ka pasur edhe tentime në fillim të seancës që kjo seancë të devijojë nga ata që e kanë thirrur, për faktin se është hipokrizi, qysh e thanë edhe kolegët e mi, që të ftohet një seancë kundër dhunës në familje dhe në adresimin e parë të përdoret, do të thotë një diskurs i tillë nga ata që më së paku kanë të drejtë që të flasin dhe të moralizojnë që janë kundër dhunës.

Ne i kemi parë rastet e fundit vetë brenda subjekteve politike, sa e vështirë është beteja politike, veçmas për gra, të cilat i tejkalojnë kornizat politike dhe të cilat linçohen nga kolegët e tyre vetëm e vetëm se kanë një mendim ndryshe.

Unë besoj shumë që raste të tilla do të jenë më të paketa, sepse çka kemi parë gjatë muajve të fundit, debatet e brendshme, diskursin tejet të rëndë, vetë brenda grave në subjekte politike, kjo besoj që nuk do t'i kontribuojë asesi jo vetëm përfshirjes së gruas në vendimmarrje, por asesi nuk do t'i kontribuojë edhe vetë shoqërisë kosovare.

Ne i kemi dekurajuar qytetarët e Republikës së Kosovës që të besojnë në deputetët e tyre të zgjedhur, që të besojnë në ata të cilët i kanë votuar, të cilët kanë ardhur në këtë Kuvend duke shkatërruar shtetin, duke shkatërruar institucionet dhe duke proklamuar mbrojtjen e një kategorie, qysh u tha edhe më herët, në fillim të seancës.

Megjithatë, unë kam disa adresime që do t'i përmend në fjalën time kështu, shpresoj të mos përsëriten, sepse janë thanë shumë, natyrisht që ka përparime nëse krahasohemi me seanca të kaluara.

Grupi i grave deputete në të kaluarën ka adresuar një pjesë të madhe të shqetësimeve, veçmas që prekin gratë, jemi munduar që të adresojmë secilin shqetësim të rasteve të rënda të dhunës në familje.

E thashë që përparimet nuk janë të mëdha, ka pasur imponime shumë të mëdha për kuotën, e së fundi, megjithëse kemi bërë një Ligj për barazinë gjinore, domethënë jodomosdoshmërisht e kemi parë që ky ligj nuk po aplikohet, kemi vendosur partitë politike që të kemi kuota si mekanizëm brenda subjekteve tona politike për të arritur përfshirjen e gruas në shoqëri, por kjo nuk është arritur dhe natyrisht që sa më pak që gratë janë të përfshira në politikë dhe sa më pak që ato adresojnë shqetësimet dhe rastet e dhunës, jo vetëm gratë, por edhe kolegët e tyre deputetë, atëherë edhe shoqëria jonë do ta ketë të vështirë këtë përballje.

Ligjet janë të jashtëzakonshme, ne kemi bërë ligje në letër në masë të madhe, por kur të vjen puna të implementimi, kemi pasur vazhdimisht hendeqe sa i përket implementimit të këtyre ligjeve, në letër shumë të rrepta, por që sistemi ynë nuk ka arritur që të menaxhojë si duhet dhe ka pasur diku një shkarje me raste të shumta që i kemi parë viteve të fundit.

Pra, dhuna, e thashë, është e pranishme në familjet tona dhe këtë e thonë të gjitha statistikat, por është edhe një lloj dhune tjetër, që është dhuna verbale, që veçanërisht ka prekur gratë në politikë dhe që është vërejtur shumë gjatë kohës së fundit, do të thotë zakonisht kur është ngritur zëri brenda forumeve të ndryshme politike.

Megjithatë, unë dua të kaloj, sepse ky është problem i vogël, këtë do ta rregullojnë vetë subjektet politike brenda tyre, por problem i madh mbetet edhe më tutje vrasjet e mëdha të grave, të cilat çdo ditë e më tepër po i shohim në media, por edhe ato raste të izoluar, për të cilat ne nuk informohemi dhe nuk dimë çfarë ndodhë brenda familjeve kosovare, meqë problemet e tilla të adresimit të dhunës vazhdojnë të quhen si probleme private dhe të mos trajtohen në mënyrën institucionale.

Unë bashkohem me kolegët e mia dhe sot natyrisht që nuk mund ta ndal diskutimin e sotëm nëse nuk përmend rastin e Zejnepes, të Donjetës, të Dafinës, Dianës e shumë e shumë grave të tjera, të cilave nuk arritëm që t'ua mësojmë emrat, sepse e thashë që dhuna dhe vrasja e tyre u tentua të mbahen brenda mureve të shtëpisë.

Duke marrë në dorë vetë drejtësinë për të na dëshmuar neve se jeta e grave nuk është e vlefshme sa jeta e burrave dhe se problemet shoqërore, të tilla, konsiderohen çështje familjare, por assesi që dhuna dhe vrasjet janë problem i shoqërisë sonë.

Janë 1 200 raste të dhunës familjare vetëm gjatë vitit 2017, prej të cilave do të thotë i kemi 5 raste që kanë përfunduar me fatalitet, nëse kthehemi në vitin 2016 i kemi 7 raste të cilat kanë

përfunduar me fatalitet dhe, merreni me mend, të gjitha këto janë gra, janë nëna dhe motra tona, të cilat në mënyrën më të dhunshme u privuan nga jeta, natyrisht që ky është problem, është problem shumë i madh, problem i cili nuk duhet të adresohet vetëm për data të tilla të 8 marsit, kur ne meritojmë që të trajtojmë problemet jetike të qytetarëve tanë, t'i adresojmë shqetësimet e shumë grave që nuk kanë arritur të gjejnë një vend pune, të shumë amviseve, të cilat ballafaqohen me shumë e shumë probleme në jetën e tyre, të shumë grave, të cilat janë bartëse të familjes, të rasteve të alimentacionit që sot u përmend, e shumë e shumë probleme të tjera.

Nëse flasim vetëm te rastet e dhunës, unë nuk mund të mos them që kjo është gjithësi e lidhur me shkallën e ulët të punësimit të grave. Janë vetëm 12.9% të grave, të cilat do të thotë janë të punësuar dhe kjo shifër aq e ulët, natyrisht që e krijon edhe një hendek të madh, sepse gratë kur nuk janë financiarisht të liruar, atëherë rastet e dhunës gjithmonë janë raste në rritje.

Por, nëse i shohim statistikën sa i përket shkallës universitare, do të thotë janë kryesisht vajzat dhe gratë që prijnë në raport me gjininë tjetër sa i përket universitetit.

Diskriminimi godet më fort gratë në sektorin privat, janë shumë probleme, janë orë të gjatë të punës së papaguara, është sektori ku ato privohen nga e drejta për fëmijë, për shkak se kemi pasur shumë e shumë raste ku nënat e reja janë detyruar që të mos mbesin shtatzënë, të mos lindin fëmijë për të siguruar një vend të tyre të punës, dhe kjo është shkalla më e rëndë e shkeljes së të drejtave të njeriut që duhet të adresohet në institucionet tona dhe të merret shumë seriozisht.

E drejta e pronës dhe e trashëgimisë janë probleme të tjera që janë shumë shqetësuese, me të cilat ballafaqohen gratë në Republikën e Kosovës.

Natyrisht që për të trashëguar në mentalitetin tonë është e drejtë absolute që trashëgimi ashtu me norma tradicionale i takon vetëm djalit dhe vajza është konsideruar dhe po vazhdon të konsiderohet si e derës së huaj, apo siç është thënë në Kanun: “Gruaja nuk ka tagër”, gjë që dëshmohet edhe me rastin e shumë përfolur të zonjës Shyhrete Berisha, të cilës nuk i kanë takuar as kujtimet e fëmijëve dhe të bashkëshortit të saj, po ashtu është kryqëzuar presidentja e vendit vetëm e vetëm pse ka mbrojtur një kauzë të drejtë, duke kërkuar një të drejtë që duhet ta ketë zonja Shyhrete, një e drejtë që e kemi kërkuar me vite, nuk ka pasur mbështetje, përkundrazi është munduar që presidentja Jahjaga të kritikohet në mënyrën më të ashpër, të linçohet për qasjen e saj të drejtë që ka adresuar me vite të tëra problemin e zonjës Berisha.

Me këtë rast unë dua të përmend edhe shembuj pozitivë që janë shumë inkurajues për vendin. Është rasti i Rinës tonë prej Drenasit, e cila me aktivitetin e saj për të drejtën e vajzave në trashëgimi dhe pronë u bë personazhi më i mirë i gazetave vendëse dhe ndërkombëtare. Ky është, mendoj, investimi më i mirë që mund të bëjmë ne vajzat dhe djemtë, por edhe vajzat e djemtë e tjerë si Rina që të ecim përpara dhe të bëjmë Kosovën një vend të barabartë dhe të

drejtë jo vetëm me ligje të shkruara në letër dhe me Kushtetutë, por një vend që i trajtojnë këto të drejta të tyre.

Vetëm 5% të grave kanë shtëpi apo banesë në emrin e tyre dhe këto janë të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Vetëm 4.9% të grave janë bartëse të pronës dhe tokës bujqësore në Kosovë, regjistrimi i bujqësisë në Kosovë i vitit 2014 thotë që janë vetëm 3% të grave kanë pronë të tyre bujqësore.

Institucionet e rrugët, merrni me mend, sa pak emra grash kanë. Ka pasur shumë emra të rëndësishëm të grave që nga koha e hershme që kanë dhënë shumë, qoftë për vendin, qoftë edhe ato gra dhe vajza që kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ne kemi dështuar, sepse nuk kemi arritur që këto gra dhe vajza që e kanë dhënë jetën e tyre për këtë vend t'i kemi pjesë të rrugëve të institucioneve tona të rëndësishme.

Edhe pse është përmendur kontributi i tyre vazhdimisht, do të thotë është minimizuar roli i gruas në masë të madhe, sepse kanë qenë kryesisht burrat që janë përmendur vazhdimisht.

Është inkurajues edhe rasti i fundit i zonjës së FSK-së, e cila arriti një gradë që na bëri të gjithëve krenarë, por edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Përshëndetje për të gjithë,

Po e shfrytëzoj rastin që grave dhe vajzave t'ua uroj 8 Marsin, Ditën e Gruas dhe t'i inkurajoj që të luftojnë më shumë për barazi gjinore, sepse tanimë është vërtetuar se barazia nuk vjen si rezultat i lutjeve, kërkesave ose ankesave, por vjen si rezultat i pushtimit të saj, do të thotë i marrjes së të drejtave që atyre u takojnë.

Sot për pabarazinë dhe padrejtësitë, edhe dhunën në këtë Kuvend folën shumë deputete dhe deputetë, por bazuar në dokumentin mbi situatën e dhunës ndaj fëmijëve në Kosovë, të cilën na e ka shpërndarë koalicioni i organizatave joqeveritare për mbrojtjen e fëmijëve KOMF, del se fëmijët janë viktima më të mëdha të dhunës në Kosovë.

Prandaj, unë në fjalën time do të fokusohem në ushtrimin e dhunës mbi fëmijët.

Përkundër përpjekjeve që veprimet e dhunshme t'i parandalojmë përmes legjislacionit vendor, përdorimi i dhunës në vendin tonë mbetet i lartë.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 61.4% e fëmijëve në Kosovë kanë konfirmuar përvojat e dhunës fizike dhe psikologjike brenda mjedisit familjar.

Gjatë muajit të fundit të intervistimeve, 59% të fëmijëve kanë deklaruar se kanë pësuar dhunë psikologjike, kurse 24% e tyre janë deklaruar se kanë pësuar ndëshkime fizike.

Në këtë situatë, kur legjislacioni në fuqi nuk arrin t'i mbrojë nga dhuna fëmijët, rekomandohet zhvillim i programeve për disiplinimin pozitiv të kujdestarëve të mësimdhënësve, të profesionistëve që punojnë me fëmijë dhe të prindërve të fëmijëve.

Duhet të theksohet se Qendrat për Punë Sociale në Kosovë janë të mbingarkuara për shkak të numrit të vogël të këtyre qendrave, e kjo ndodh për shkak të buxhetit të vogël që ndan shteti i Kosovës për Qendrat për Punë Sociale.

Problem në veti është edhe mosraportimi i dhunës si nga institucionet, të cilat janë të obliguara që të raportojnë për dhunën dhe të ndërmarrin masa që ta evitojnë atë, po ashtu edhe nga vetë fëmijët, të cilët rrallëherë raportojnë për dhunën.

Prandaj, është shumë e nevojshme që ne si shoqëri ta inkurajojmë raportimin e dhunës edhe nga ata që pësojnë dhunë, por edhe nga të tjerët, të cilët janë dëshmitarë të përdorimit të dhunës.

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna është obligim kushtetues në Republikën e Kosovës. Çdo fëmijë ka të drejtën e integritetit fizik dhe personal të tij dhe të mbrojtjes nga të gjitha format e dhunës.

Kosova ka përgjegjësi për t'i mbrojtur fëmijët nga dhuna, abuzimi, neglizhenca si dhe për të garantuar të drejtat e tyre që u takojnë edhe me ligjet tona, edhe me konventat ndërkombëtare.

Institucionet edukative në vendin tonë duhet ta kryejnë obligimin e tyre, duke i vetëdijesuar familjet që të mos ushtrojnë dhunë mbi fëmijët, por edhe të tjerët dhe po ashtu t'i vetëdijesojmë fëmijët se sa herë që janë viktima të dhunës, atë ta raportojnë në institucionet e duhura, kurse institucionet e drejtësisë janë të obliguara t'i marrin masat e nevojshme ligjore që do ta evitojnë përdorimin e dhunës ndaj kujdo qoftë, e sidomos ndaj fëmijëve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Armend Zemaj, Armendi nuk është i pranishëm, Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryesuese!

Koncepti i dhunës në familje është shumë i gjerë, dhuna në familje kërkon një qasje profesionale, të argumentuar, çka duhet të bëjmë ne si deputetë dhe institucionet në përgjegjësi për të adresuar problemin e dhunës në familje?

Edhe sot, si shumë herë të tjera, dëgjuam fjalë fyese, shantazhe ndaj njëri-tjetrit të pabazuara, kështu nuk i kontribuohet zgjidhjes së problemit të dhunës në familje, po shkaktojmë dhunë psikike dhe psiko-sociale në familjet tona.

Diskutimet tona i dëgjojnë fëmijët dhe është koha që të kursehemi nga fjalët fyese, denigruese, si “hajn ordiner”, “kriminel”, etj., etj., dhe të mos ndikojmë indirekt në dhunën psikike në familjet tona.

Megjithatë, unë vlerësoj idetë dhe qëndrimet pozitive që u dhanë këtu nga disa deputetë, të cilat është mirë t'i koordinojmë për t'i mbrojtur interesat e të gjitha vajzave dhe grave, interesat e shoqërisë tonë.

Më vjen mirë që sot shpalesëm shumë punë të bëra, shumë të arritura të grave dhe vajzave, të cilat na bëjnë të ndihemi krenare në kontributin tyre në politikë, në ekonomi, në sport, në shëndetësi, në kulturë, në arsim dhe në shoqëri në përgjithësi.

Femrat ishin ato që e fuqizuan emrin e shtetit tonë të pavarur, Republikës së Kosovës, në arenën ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Edhe përkundër legjislacionit që hap perspektivën për barazi gjinore, ende jemi larg në mes të asaj që është në ligj dhe asaj që praktikisht është arritur në zbatueshmërinë e tyre.

Statistikat nuk janë shumë shpresëdhënëse në këtë drejtim sa i përket barazisë gjinore.

Ne duhet të kontribuojmë në rritjen e efikasitetit dhe përgjegjësive për të përfshirë analizat gjinore në politika, duke përfshirë këtu edhe analizat për buxhetimin gjinor dhe të kontribuojmë në zhvillimin e programeve që kontribuojnë në barazinë gjinore dhe në marrjen e masave afirmative dhe iniciativave stimuluuese për ngritjen dhe pjesëmarrjen e grave në programe që rrisin fuqizimin ekonomik të gruas. Edhe më tutje duhet të kontribuojmë në rritjen e qasjes së grave në biznes përmes lehtësimeve që bëhen nga rregullat ligjore.

Nëse ne arrijmë të hapim perspektivën ekonomike për gruan, ne kontribuojmë në uljen e dhunës ndaj saj, sepse një grua e pavarur financiarisht ka guxim në marrjen e vendimeve për të ardhmen e saj, të fëmijëve të saj, ka guxim më të madh për të ngritur zërin për vetveten dhe familjen e saj si dhe duke qenë e fuqizuar ekonomikisht, gruaja është më pak e ekspozuar ndaj dhunës në familje.

Të nderuara deputete,

Gruaja në Kosovën e pasluftës tregoi forcën e mbijetesës. Shumë gra që përjetuan tragjedinë e luftës gjetën forcën të mbajnë familjet e tyre, krijuan biznese të vogla dhe biznese familjare, u organizuan në OJQ që bashkërisht të përballen me vështirësi të ekzistencës.

Nuk mund të mos e theksoj se në vendin tonë ende janë plagët e hapura nga e kaluara e dhimbshme e Kosovës, gratë të cilat përjetuan dhunën në luftë u stigmatizuan për vite të tëra dhe vetëm këtë vit filloi të bëhet diçka për to, duke krijuar fondin për to, që edhe ato të konsiderohen të barabarta me ata të tjerët, të cilët kontribuuan për lirinë e vendit tonë.

Të nderuara kolege deputete,

Edhe më tutje mbetet sfida në shtetin tonë zbatimi i ligjeve, në mënyrë që të ndërtojmë një shtet demokratik.

Nuk dua të paragjykoj asnjë rast që kalon përmes drejtësisë, jam e prirur që t'u besoj institucioneve, por rasti i dhunës ndaj Donjeta Pajazitit që i kushtoi me jetë asaj, drejtësia e vonuar dhe, në fund, e dështuar, është shqetësuese dhe të bënë të shohësh me skepticizëm institucionet e drejtësisë.

Vlerësoj hetimet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, por të shuhet jeta e një vajze të re, e pas të gjitha atyre hetimeve të mbyllet rasti, siç ndodhi para dy ditësh, është thjesht padrejtësi.

Jam për hetimin e pavarur dhe të rasteve të tjera, ku shuhen jetë njerëzish, por drejtësia duhet të gjejë vrasësit e Donjeta Pajazitit nga Strelci i Deçanit, e cila u zhduk në derë të shtëpisë së saj dhe u gjet pas disa ditësh e masakruar.

Donjetën e kam njohur, ishte vajzë me karakter, me ëndrra shumë për të ardhmen për t'i ndihmuar familjen dhe për të kontribuar për vendin tonë.

Drejtësia duhet të jetë drejtësi përgjithë secilin, ne duhet të bëjmë punë si deputetë, të angazhohemi fuqishëm që në institucionet e drejtësisë të ketë zbatim të ligjit, të ketë rregull dhe t'i fuqizojnë institucionet e drejtësisë edhe me buxhet, nëse veç themi se duam drejtësi, rregull e shtet ligjor.

Edhe pse femra ka bërë hapa pozitivë në biznes, në politikë, në institucione, ende femra në Kosovë nuk e ka zënë pozitën e duhur në vendimmarrje. Nuk udhëhiqen shumë ndërmarrje të rëndësishme publike nga femrat, nuk drejtohet ndonjë institucion i fuqishëm ekonomik nga femrat dhe vetëm dy femra i kemi ministre.

Nëse analizojmë seriozisht këto pozita, atëherë ne si deputetë, si femra politikanë që secila kemi ardhur nga subjekte të ndryshme politike, duhet këtë çështje ta trajtojmë me seriozitet në radhë të parë brenda subjekteve tona politike, në mënyrë që nga aty t'i fuqizojmë pozitën tona vendimmarrëse e të kontribuojmë në fuqizimin ekonomik të gruas dhe vajzës shqiptare.

Ne do të jemi ato që do të luftojmë për hapësirën e veprimit të të gjitha grave që ato t'i dëshmojnë vlerat e tyre intelektuale, profesionale dhe vlerat e tyre, të cilat i kanë të veçanta edhe në sferën politike. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputetja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetare!

Përsëritje për deputetët dhe deputetët që po më duket sot jemi në barazi të plotë në këta pak numra të mbetur në sallën e Kuvendit.

Momentin kur u thirr kjo seancë e jashtëzakonshme lind ideja pse sot duhet, vetëm sot të diskutohet për dhunën ndaj gruas. Në fakt, në një lëvizje botërore në të gjitha rrethet, qofshin artistike, akademike, të korporatës, në veçanti në botën e zhvilluar është lëvizja "Koha ka kaluar" apo "Times Up" për ngacmimet dhe dhunën që shkaktohet ndaj grave me vite të tëra. Nga ndarja e grupimeve se më 8 Mars duhet të festojmë apo duhet të protestojmë, unë besoj se kemi arsye për të festuar e protestuar bashkë. Sot është një moment shumë i mirë për të reflektuar se ku ishin gratë dhe vajzat e vendit tonë para dhjetë vjetëve, para njëzetë a tridhjetë vjetëve, por gjithashtu për të gjitha ne bashkë që jemi në jetën publike dhe vendimmarrëse të gjejmë më tepër forcë edhe kurajë nga reflektimet e shumta për të vazhduar përpjekjet tona për barazi.

Pabarazitë dhe dhuna ndodh çdo ditë, ndodh edhe në këtë institucion, është e vërtetë. Ka gjuhë seksiste, ka ofendime, ka fytyrë, ka sharje. Sot, ndoshta ne mes vete nuk duhet të fokusohemi në atë çka ndodh mes nesh, se në fund të fundit, mbi 30% të deputetëve këtu, gra dhe vajza, unë besoj që është momenti që ne së paku të reflektojmë vetë me atë se sa vajza të tjetra i kemi ngritur, u kemi ndihmuar që të kenë një jetë më të lehtë, ne gratë dhe vajzat e këtij Kuvendi, e para. E dyta, që ne bashkarish të kuptojmë se një shoqëri e barabartë do të jetë kur të gjithë ta kuptojmë barazinë, jo kur të kemi grupe, e cila në një element ndihet superiore ndaj tjetrit. Sot, fuqizimi ekonomik i gruas është mekanizmi kryesor i ndaljes së dhunës ndaj gruas.

Nga krejt statistikat që u përmendën për dhunën që ndodh sot në familje, që fillon që nga ditët e hershme të vajzave të vogla e djemve, e deri tek gruaja në rrahjet nga burri apo anëtarët e tjerë të familjes, elementi që i mban ato të qëndrojnë në atë shtëpi është elementi i mosfuqizimit ekonomik. Nga statistika të thjeshta, 19% të bizneseve sot në Kosovë të regjistruara janë në pronësi të grave, në vitin 2016, në vitin 2017 nuk është nxjerrë ende statistika e tyre. Është një

rritje, por nuk është i kënaqshëm, për shkak se jo rrallë gratë janë aty vetëm për të qenë si mbulesë për burrin që i ka 1 ose 2 biznese, apo për vëllain, apo për babanë.

Një prej elementeve substanciale në barazinë në shoqëri është ajo se çfarë i edukojmë vajzat dhe djemtë në shkollën fillore. Një problem shumë serioz ne e kemi sot në kurrikulën dhe me tekstet shkollore. Nëse i shikoni tekstet shkollore të fëmijëve mund të shihni se gratë janë të portretizuara si kuzhiniera, si amvise, ndërsa burrat ose djemtë janë të portretizuar si minatorë ose pilotë. Nëse duam të ndryshojmë substancialisht qasjen e elementit gjinor, duhet filluar nga rishikimi i mirëfilltë i librave në shkolla dhe të ndërrohen stereotipat. Gruaja mund të jetë pilote, mund të jetë kirurge, natyrisht, mund të jetë në shumë pozita të tjera, por shefat më të mëdhenj të kuzhinave në botë ose më të njohur janë burra dhe kjo duhet të ketë portretizimin e duhur në libra shkollorë, e jo të kuptohet se vendi i gruas është vetëm në kuzhinë.

Ajo çka ne kemi parë në strukturën qeverisëse, një diskriminim të mëtutjeshëm të gruas në ekzekutivin kosovar. Dorën në zemër, kurrë s'ka pasur më tepër se tri gra ose katra, nëse nuk gaboj në ekzekutivin e kaluar, por tash prej 22, domethënë ka shtim të numrit të ministrive, i kemi vetëm 2 gra ministre, ndërsa nga 72 zëvendësministra, vetëm katër janë gra. Kjo flet në vetvete se cila është sot pozita e gruas në sytë e ekzekutivit kosovar. Ajo çka ne duhet të bëjmë si hap i parë, përveçse të konkludojmë për problemet, të cilat i ka shoqëria jonë, është marrja e një sërë mekanizmave, pjesë e të cilit është edhe ky Kuvend. E para, Kuvendi i Republikës së Kosovës në krejt funksionimin e tij që prej periudhës së pasluftës asnjëherë nuk ka bërë buxhetim gjinor. Buxhetimi gjinor është bërë në disa institucione individuale, në ministri, në komuna, më vjen mirë që prej vitit 2015 Komuna e Gjakovës e ka buxhetimin gjinor, buxhetim ky i cili në esencë e analizon secilin investim që bëhet nga buxheti publik, gjegjësisht nga paraaja publike.

Jo rrallë harrohet të mendohet ose të trajtohen se çështjet e sigurisë, e ndriçimit, e transportit, janë çështje të drejtpërdrejta në ndikim në buxhetimin gjinor. U përmendën më herët gjithashtu kopshtet, si një prej elementeve kryesore të pengesave ose heqjes së pengesës për angazhimin e gruas apo nënës së re në tregun e punës. Ne sot e kemi problemin e shkeljes së të drejtave të vajzave dhe grave në tregun e punës, ministri i Punës është këtu, të pyetët ministrin se cilat janë statistikatat e fundit e Inspektoratit të Punës për ditët e fundjavat, të shtunën dhe të dielën për orët e gjata të punës, për kontratat e punës që shumica e vajzave dhe grave i kanë apo nuk i kanë dhe në vazhdimësi mbahen vetëm për atë rrogë për shkak se është ekzistenciale apo është substanciale për ato që të kenë një ekzistencë.

Çka ne kemi mundësi tjetër të bëjmë, është që të kemi fondin e drejtpërdrejtë, i cili targeton bizneset e grave. Sot 4 ministri të Republikës së Kosovës kanë fonde të subvencioneve. Mua shumë më kishte interesuar, sikur të ishin ministrat e pranishëm ta di, cili prej këtyre fondeve subvencioneve për ndërmarrësi ka kuotë gjinore? Është shumë e thjeshtë, prej atyre mjeteve të

cilat jepen vendoset një përqindje gjinore në të cilën thuhet se prej këtij fondi 30 ose 40% të bizneseve të grave duhet të financohen domosdoshmërisht. Kjo është forma më e mirë e mundshme drejtë heqjes së barrierës për fuqizimin ekonomik të grave. Shumë shpejt në këtë Kuvend vjen në lexim të dytë Ligji për shoqëritë tregtare. Në atë ligj kam propozuar një amendament, në kuadër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, nenin 34, më konkretisht, i cili parasheh se numri i anëtarëve të Bordit të drejtorëve të shoqërive aksionare private duhet të përmbajë kuotë gjinore. Reagimi i menjëhershëm i deputetëve, kolegëve të mi në Kuvendin e Kosovës “s’ mundesh, janë kompani private, nuk mund t’u përzihesh”. Pse ne mundemi sektorit privat që t’u përzihemi për taksa, tarifa, elemente të ndryshme, kur vjen te elementi gjinor, jo s’ mund t’u përzihesh, se ata vendosin vetë kënd e kanë në bord. Nuk është ashtu!

Sot në Kosovë janë të regjistruara kompani ose shoqëri aksionare diku 240 krejt total në krejt Kosovën, prej tyre secili e ka një Bord nga 3 anëtarë që do të thotë se minimumi një grua duhet ta kenë në këtë bord, atëherë në krejt Kosovën ne nuk mund t’i kemi 240 gra ose vajza profesionale në fushën ekonomike që mund të shërbejnë në këto borde? Në rrethana të barabarta midis atyre që janë afër, kolegë dhe bashkëpunëtorë me bizneset, zakonisht nuk janë shokë të kafesë apo të rakisë, ndonjë grua ose ndonjë vajzë, shoqe e shkollës ose kolege, janë burrat. Por, në momentin kur është e përcaktuar me ligj dhe në momentin kur ka sanksione për mosimplementimin e këtij standardi gjinor, atëherë duhet të mendohet ndryshe dhe menjëherë do të mendohet për atë shoqen ose kolegen, ose për një profesioniste tjetër, e cila drejtpërdrejt inkadrohet në botën e vendimmarrjes korporative.

Për ne është shumë e rëndësishme të dimë se kualitet dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nuk mund të kemi pa përfshirje të përgjithshme të të gjitha strukturave, në veçanti gjinore. Nuk mund të jetë ekonomia e zhvilluar nëse 50% e trurit në formën e mirëfilltë nuk është e përfshirë në kontributin për zhvillimin ekonomik dhe kjo duhet të fillojë këtu, në Parlament, ku përgatiten ligjet, ku përgatiten norma dhe rregullativa, të cilat pastaj përcaktojnë funksionimin e jetës në formën e mirëfilltë. Dhe, krejt në fund, secili dhe secila duhet ta dimë se prej çfarë pozite kemi ardhur deri në këtë pozitë, e na takon neve, prapë po kthehem tek ne, gratë deputete që të jemi më të zëshme, që natyrisht të jemi më këmbëngulëse në atë që kemi ardhur deri këtu pse e kemi merituar. Se nuk jemi ardhur deri këtu për shkak se dikush na ka hapur derën ose pse dikush e ka dhënë një kuotë dhe tash ne jemi konform asaj kuote.

Le të jetë prezenca e grave deputete domosdoshmëri që vërehet nga të gjithë, jo një kuotë ose një pamje, e cila duket mirë për të tjerët dhe themi se në Parlamentin e Republikës së Kosovës kemi kuotë. Kemi nevojë për afatizim të kuotës, në mënyrë që të gjithë ta kuptojmë se rruga deri këtu i ka përpjekjet e veta, por edhe gjithë të tjerat ta kuptojnë se ky vend nuk mund të jetë në rregull nëse gjysmën e popullsisë nuk e ka të përfshirë në të gjitha proceset vendimmarrëse. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka ministri Skender Reçica.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Po e ndjej obligim që të jap disa sqarime rreth disa çështjeve që u ngritën sa i përket angazhimit të Qeverisë, qoftë për viktimat e dhunës seksuale në luftën e fundit, qoftë për atë se çfarë jemi duke bërë rreth trajtimit meritore të lehonave në Kosovë, qoftë për zbatimin e kontratave, në veçanti për gratë.

U tha që Qeveria nuk ka bërë asgjë, asnjë vendim sa i përket trajtimit të viktimave të dhunës seksuale. Ju them që brenda një kohe rekord, për më pak se dy muaj në Qeveri kemi marrë vendimin për përcaktimin e shumës së pensionit për kompensimin e viktimave të dhunës seksuale. Dhe, nga 30 janar, kur e kemi lansuar periudhën për pranimin e aplikacioneve që zyrtarisht ka filluar më 5 shkurt, sekretaria shtetërore deri më tani ka pranuar mbi 100 aplikacione, do të thotë se është bërë diçka, janë bërë veprime konkrete sa i përket trajtimit meritore të viktimave të dhunës seksuale.

Po ashtu, u fol këtu që nuk është duke u punuar për trajtimin e lehonave. Unë e them një gjë, nuk duhet të bëhet brengë jona në mungesë të buxhetit nataliteti dhe ne po punojmë shumë që kësaj çështjeje, që nënat lehonë në Kosovë ta ketë vendin e merituar, ta ketë dorën e shtetit, madje-madje jo vetëm nënat lehonë që janë duke punuar, por edhe ato që nuk janë duke punuar dhe për këtë shumë shpejt ne do të bëjmë veprime konkrete sa i përket trajtimit meritore e shtetëror të nënave lehonë në Kosovë. U fol për moszbatimin e kontratës sa i përket relacionit punëdhënës-punëmarrës. Unë jam i vetëdijshëm që një situatë rreth kësaj çështjeje ne e kemi trashëguar dhe nuk është më e mira që ne e kemi gjetur, dhe për këtë jemi duke punuar shumë. Jemi në procedurë e sipër në draftimin e konceptit të Ligjit të ri të punës, jemi duke punuar në finalizimin e Ligjit të ri të Inspektoratit që shumë shpejt do të përcillet edhe në Parlament për t'u miratuar. Dhe, janë këto dy ligje, të cilat neve do të na ndihmojnë në të ardhmen që marrëdhëniet kontraktuale punëdhënës-punëmarrës, jo vetëm sa i përket gjinisë femërore, vetëm sa i përket grave, por në përgjithësi, në relacionin punëdhënës-punëmarrës ta kenë qasjen më të saktë dhe të jenë në zbatim ashtu si kërkohet.

Ajo që dua në fund t'ju siguroj, të nderuar deputetë, përmes kësaj foltoreje, edhe qytetarët që nuk po shikojmë vetëm mundësinë se si të gjejmë rrugë që për raste të caktuara, qoftë të viktimave gra, qoftë edhe të fëmijëve, të gjejmë mënyrë se si ato t'i kompensojmë. Ne jemi duke punuar shumë që krahas kompensimeve ligjore që mund të jenë për raste të caktuara, të krijojmë mundësi më të mëdha që gratë, e veçanërisht ato të përfshira nga dhuna, qoftë në familje, qoftë ndonjë dhunë tjetër, të integrohen qoftë në jetën institucionale, por edhe të sigurojmë vende të punës që integrimi i tyre në marrëdhënie të punës të jetë një lehtësi për tejkalimin e situatave të tilla. Faleminderit!

KRYESUESA: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka deputeti Shemsi Syla.

SHEMSI SYLA: Zonja kryesuese!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Shfrytëzoj rastin t’jua uroj 8 Marsin juve, kolege deputete dhe të gjitha grave të botës.

Të nderuar deputetë,

Problemet që lidhen me këtë debat të ftuar sot nga Lëvizja “Vetëvendosje” janë të shumta, por unë dua të mundohem të vë në pah dhe të trajtoj dukuritë e dhunës familjare se si ato trajtohen nga Policia e Kosovës. Në dhjetor të vitit 2016, Kosova miratoi strategjinë e dytë kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe planin e veprimit për periudhën 2016-2020. Që prej asaj kohe janë ndërmarrë disa nisma, në të cilat është synuar të ngrihet kapaciteti i institucioneve publike për të zbatuar këtë dokument dhe të caktohen përgjegjësi të tjera ligjore në lidhje me dhunën në familje.

Pothuajse nuk ka mbetur polic që nuk ka ndjekur trajnime të ndryshme lidhur me dhunën në familje. Këto trajnime i kushtuan shtrenjtë buxhetit të Kosovës, Policia e Kosovës ka detyrimin e përgjithshëm që të hetojë të gjitha krimet e kësaj kategorie në pajtim me Kodin Penal të Kosovës. Kur këto vepra kryhen në kuadrin e marrëdhënies familjare, ato përbëjnë vepra penale dhe patjetër duhet të ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare, në këtë mënyrë Policia është pika e parë e kontaktit për viktimat e dhunës në familje. Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje parasheh që Policia mund të nxjerrë edhe urdhra mbrojtës të përkohshëm kur gjykatat nuk punojnë. Policia duhet t’u përgjigjet denoncimeve për kërcënime apo akte të dhunës, t’i shoqërojë viktimat dhe në rast se Policia dyshon për ndonjë krim që do të bëjë me dhunë në familje, automatikisht duhet ta arrestojë autorin e veprës.

Viktimat përfundojnë tragjikisht me trauma dhe me pasoja të rënda e të përhershme, duke qenë e pamundur të theksojmë të gjithë ato shkelje, do të përmend vetëm disa raste, sa për të ilustruar. Rasti i Diana Kastratit, e më pastaj edhe i Zejnepe Bytyqi janë dy nga rastet, të cilat prekën thellë ndjenjat e çdo qytetari. Kushtetuta vërtetoi se shteti kishte shkelur të drejtën për jetë, duke mos i ofruar mbrojtje viktimës dhe një herë u vërtetua se organet e drejtësisë nuk morën në bazë tragjedinë që kishte pësuar disa vjet më parë Diana, kjo vërtetoi edhe një herë se dhuna në familje vazhdon të trajtohet nga institucionet tona si problem privat, zgjidhja e secilit u lihet në dorë çifteve.

Asnjëherë, edhe pse u kërkuan nga Inspektorati Policor i Kosovës, nuk u tregua si është trajtuar viktima Zejnepe Bytyqi. Edhe pse rasti ishte i paraqitur disa herë në Polici nga vetë viktima, e që edhe një herë kishte tentuar edhe të vetëvritej. Vrasësi qëndronte nga dy javë në burg, në gjashtë

mujorin e parë po të atij viti 2015, kur ndodhi ky krim, në Kosovë u raportuan 460 raste, ku 381 femra ishin viktime të dhunës nga burrat. Shokuere është edhe rasti i këtyre ditëve, lirimi i të akuzuarit për vrasjen e Donjeta Pajazitit pas dy vjetëve të qëndrimit në burg. Është një dështim i plotë i tërë sistemit të sigurisë e të drejtësisë në Kosovë. Në shumë raste të vëzhguara nga monitoruesit, policia i mban viktimat në stacion të policisë për 48 orë, ndërkohë që autorët e dhunës i dërgon në shtëpi.

Nëse ka dyshime se është kryer ndonjë krim, Policia duhet të ndalojë autorin e krimit dhe jo viktimën. Shpeshherë punonjësit social raportojnë se në disa raste në vend të zyrtarëve të Njësisë së Hetimeve kundër dhunës në familje, viktimat i intervistojnë zyrtarët e policisë pa praninë e punonjësit social, gjë që i traumatizon viktimat. Të dhënat lënë të kuptohet se disa policë vazhdojnë të përpiqen t'i bashkojnë e t'i pajtojnë familjet. Për shembull, në një raport policor thuhet: "Ajo u intervistua nga Njësia Hetimore e Policisë në prani të një punonjësi të Qendrës për Punë Sociale dhe deklaroi se është dakord të shkojë të jetojë me bashkëshortin e saj".

Deklarata që viktime është dakord të kthehet në shtëpi, nënkupton që zyrtari i policisë ose punon si social mund të ketë nxitur që të marrë një vendim të tillë. Nga kompetenca që ka policia dihet se këshillimi familjar për qëllime ribashkimi nuk është as detyrë dhe as përgjegjësi e Policisë.

Dhuna seksuale vazhdon të mbetet tabu, ndërkohë që viktimat mund t'u druhen rrethanave sociale që ndërlidhen me raportin e saj. Kjo bën që raportimi të jetë i ulët, të kenë ndodhur më shumë raste të dhunës seksuale, mirëpo viktimat nuk i kanë raportuar rastet, por as policia nuk i ka regjistruar këto raste. Për shembull, një grua e re raportoi te policia se ishte ngacmuar seksualisht në rrugë nga një person i panjohur. Policia i kishte thënë: "Nuk mund të bëjmë dot asgjë, sepse nuk kemi kamera në qytet dhe nuk kemi asnjë provë". Një rast tjetër të vitit 2016 që kishte të bënte me përdhunimin, se si disa zyrtarë policorë fajësonin vetë viktimën. Së pari, zyrtari i policisë që intervistonte viktimën, duke e pyetur nëse ajo ishte e virgjër, pak kohë më vonë viktimës i kërkuan të jepte deklaratë një zyrtar tjetër i Policisë, i cili e ndërpriste atë vazhdimisht me pyetje joprofesionale dhe shumë provokative, si: "Nuk mund të besoj se si dikush, sidomos një grua mund të shkojë te shtëpia e një të huaji". Më tej ai e pyeti viktimën edhe me pyetje më të rënda që ishin thellësisht shqetësuese për viktimën. Ky rast ilustronte se si normat kulturore kanë të bëjnë me virgjërinë dhe kontrollin shoqëror mbi trupin e gruas që ndikuan në reagimet e disa zyrtarëve të Policisë ndaj rasteve të dhunës seksuale.

Për më tepër, në të njëjtin rast viktimës iu kërkua të përsëriste historinë e saj tri herë, në mënyrë të ndryshme, para audiencës që kishte të pranishëm edhe burra. Kërkesa që viktime të përsëris disa herë rrëfimin e saj është traumatizuese, kështu viktimës iu desh të përjetojë ngjarje të tmerrshme.

Policia nuk duhet të mbrojtë gruan nga shoqëria, por nga krimi, sepse ajo nuk është në rrezik nga shoqëria, por nga kriminelët. Ne si grup parlamentar jemi të bindur se ka shumë hapësirë që ligjvënësit të veprojnë dhe veprimi ynë mund të bëjë dallimin, ndaj kemi propozuar masa konkrete dhe qëndrojmë pas këtyre kërkesave derisa të plotësohen tërësisht. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë, veçanërisht qytetare, Më lejoni që fillimisht t'ju uroj 8 Marsin, Ditën e Gruas, por unë në veçanti t'ua uroj grave që kanë pasur kontribut të jashtëzakonshëm në jetën time, nënës time, gruas edhe motrave. Sot është një ditë feste, po besoj është një mundësi që të reflektojmë, të reflektojmë për kontributin që ne mund ta japim lidhur me atë që është tema e diskutimit të sotëm, pra dhuna në familje.

E vërtetë është që dhuna në familje është një dukuri që ndodh në dy drejtimet, po e vërtetë e hidhur gjithashtu është që pjesa dërrmuese e viktimave të dhunës në familje janë, në fakt, gratë. Për atë arsye nuk mundemi kurrsesi të flasim për dhunën në familje pa e adresuar edhe çështjen e barazisë së grave në shoqërinë tonë, që fatkeqësisht nuk është vetëm dukuri negative e shoqërisë sonë, por është edhe dukuri negative gjithandej botës, natyrisht në nivele të ndryshme. Pra, të reflektojmë ne sot se çka mund të bëjmë që të kontribuojmë për këtë barazi. Shpeshherë flitet për t'u dhënë të drejta grave, unë nuk besoj që bëhet fjalë që të japim diçka, sepse barazia e grave në shoqërinë tonë nuk është diçka jona, thjesht ne mund të kontribuojmë drejt asaj që të mos jemi pengesë që gratë të realizojnë atë që duhet të jetë e drejtë automatike e tyre, pra për barazi në shoqërinë tonë.

Dhuna në familje është vetëm një pjesë e pabarazisë që u bëhet grave në shoqërinë e Kosovës. Dhe, fatkeqësisht dhuna nuk mund të konsiderohet vetëm si dukuri brenda familjes. Dhunë është në të njëjtën kohë kur diskriminohet një grua në punësim, dhunë është edhe ajo fizike, por edhe ajo psikike. Sot e pashë një slogan në protestë, ku e kishin nxjerrë një vizatim dhe kishin thënë: "Mos shërbe çaj". Do të thotë, dhunë është edhe kur detyrohet një grua e familjes që të ngrihet në këmbë 10-15 herë që të qesë çaj për familjarët e tyre. Kjo është fatkeqësi, dhuna krijon viktime jo vetëm te ajo drejtpërdrejt, por edhe te familjarët e tjerë, te fëmijët që rriten në një ambient fatkeq, ku kuptojnë që është në rregull të goditet një anëtar i familjes që duhet të trajtohet me dashuri, por në të kundërtën, dhunohet dita-ditës.

Pra, reflektimi ynë duhet të jetë grupor e individual. Në njëërën anë grupor në Parlament shumë shpejt do të vijë edhe Ligji për ndërmjetësim, për trajtim dhe miratim, me ç'rast e kemi kontributin e shumë palëve të interesit, por fatkeqësisht është një iniciativë që të barazojë gruan e dhunuar me dhunuesin. Pra, që ta qesin atë në tavolinën e ndërmjetësimit dhe gruaja e dhunuar,

për shembull, të trajtohet dhe të negociojë me dhunuesin për dëmin që është shkaktuar. Kjo padrejtësi nuk guxon të lejohet dhe besoj të gjithë ne si grup mund të kontribuojmë që iniciativat e tilla t'i parandalojmë që nga zanafilla.

Nëse flitet për këtë rast, duhet të kuptohet sindromi i gruas së goditur ose dhunuar që shkenca psikologjike, por njëkohësisht edhe shkencat juridike e kanë njohur si një koncept ose një sindrom ku personi i dhunuar nuk mund, nuk ka kapacitet psikik ta nxjerrë veten nga një situatë e dhunës së përditësuar. Natyrisht, ne nuk mund të presim që ai person të ulet dhe të negociojë për të mirën e vet me dhunuesin. Në aspektin individual, ne mund të flasim për reflektim individual në familje. Pra, duke filluar nga familja, në biznes, tek punësimi, tek mosdiskriminimi ndaj grave, të cilat për shkak që janë në moshën që mund të bëjnë fëmijë, në vazhdimësi diskriminohen që të mos e shfrytëzojnë pushimin e lehonisë.

Në mjekësi, ku shpesh shkojnë viktimat e dhunës në familje, por mjekët nuk i raportojnë ato tek organet përkatëse, tek avokatët, të cilët edhe pse përfaqësojnë viktima, ndoshta nuk e dhënë 100% duke i shkelur edhe të drejtat e klientëve të tyre, apo edhe një gjyqtar që e gjobit dhunuesin. Çfarë politike ndëshkimore është ajo e cila e gjobit një person që e trajton në atë mënyrë familjarin e tyre? Krejt kjo çka do të bëjë, nëse reflektojmë edhe kontribuojmë gjithanshëm, edhe në aspektin personal, edhe grupor, do të vijë deri te ndërrimi i mentalitetit, e është pikërisht ndërrimi i mentalitetit ai që kërkohet në shoqërinë tonë për ta avancuar pozitën e gruas, e dashtë Zoti me përpjekjet tona që ta barazojë atë në nivelin që i takon asaj.

Edhe një herë, urime 8 Marsi me shpresë që radhën tjetër në Parlament të flasim për gjëra, për të arriturat tona në këtë drejtim, të ketë më shumë të pranishëm njerëz e ndoshta edhe t'u japim pushim grave deputete që ato së paku një ditë ta kenë pushim nga përpjekjet e tyre të përditshme që i bëjnë për të qenë të barabarta në shoqërinë tonë, e ne burrat të flasim për të gjitha ato që i kemi bërë për t'ua mundësuar grave tona barazinë që ju takon. Faleminderit! Urime!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuara dhe të respektuara femra, urime 8 Marsin, Ditën e Gruas, nder dhe respekt i veçantë nënës Zahide Jashari, nënës së heronjve Adem dhe Hamëz Jashari, nënës së komandantit legjendar Adem Jashari dhe përmes saj dua të respektoj dhe të përçoj mesazhin e respektit të veçantë për të gjitha femrat shqiptare, për ato heroina që lindin, rriten dhe edukuan ushtarët e lirisë.

Nëna shqiptare asnjëherë nuk u dorëzua, as kur bijtë e saj po dergjeshin burgjeve të Serbisë, e as kur ata ktheheshin në arkivol nga armata serbe, e as kur ata binin në vijat e nderit, në vijat e frontit. Femra shqiptare rezistoi dhe qëndroi me dinjitet, prandaj i falemi veprës së saj në këtë ditë të shenjtë të Tetë Marsit. Pra, femra shqiptare ka pasur një rol të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare që nga koha e ilirëve e deri më sot. Edukimi, vetëdija e lartë kombëtare e femrës shqiptare dhe morali i saj i lartë ka trasuar rrugën tonë drejt lirisë dhe pavarësisë. Debatin e sotëm e konsideroj në këtë ditë si shumë të rëndësishëm, sepse përkon edhe me 8 Marsin, por edhe për dhunën në familje. E konsideroj si një bashkëdyzim, përmes të cilit ne tentojmë, si përfaqësues të popullit, të përçojmë një mesazh që kjo dukuri e pranishme në shoqërinë tonë, e theksuar edhe nga kolegët deputetë që vetëm në vitin 2017 kanë qenë mbi 2 mijë raste të dhunës në familje, të shërbejë edhe si sensibilizim jo vetëm për institucionet përgjegjëse që kanë për detyrë dhe obligim ligjor luftimin e kësaj dukurie, por që në tërësi si shoqëri të reflektojmë më tepër.

Pjesëmarrja jo e mjaftueshme e deputetëve në këtë debat, sikur po krijon përshtypjen se ky është një problem vetëm i gjinisë femërore dhe jo edhe i gjinisë mashkullore. Në fakt, problemi i dhunës në familje buron nga gjinia mashkullore, sepse në 95% e më shumë të rasteve shkaktarët e dhunës në familje janë meshkujt, apo burrat në familje dhe kjo e predispozon që ne duhet të punojmë jo vetëm në emancipimin dhe edukimin e femrës, por më shumë në edukimin e burrave, sepse edukimi dhe emancipimi i burrave e parandalon përdorimin e dhunës në familje. Dhuna në familje, përveç anëve të tjera negative dhe të dëmshme që i cakton për një shoqëri, është shumë me rëndësi të ceket ana psikologjike, pasojat që dhuna në familje në aspektin psikologjik i ka për një fëmijë, i cili është rritur në një ambient të dhunshëm familjar. Sepse, një fëmijë, i cili është rritur në një ambient të dhunshëm familjar, do të jetë i dhunshëm më pas kur të rritet për shoqërinë dhe këtë e kanë dëshmuar dhjetëra e dhjetëra fakte.

Pra, jo vetëm për mbrojtjen e familjeve të caktuara, të cilat janë nënshtruar dhunës në familje, por edhe për mbrojtjen e shoqërisë nga dhuna. Është me rëndësi që kjo dukuri të luftohet në vazhdimësi nga institucionet përgjegjëse. Ne si deputetë e kemi për obligim dhe detyrë t'i monitorojmë institucionet tona qeveritare sa i përket kësaj dukurie dhe luftimit të saj. Ministria e Drejtësisë në vitin 2016 ka nxjerrë një strategji kombëtare të Republikës së Kosovës për luftimin e kësaj dukurie, pra dhunës në familje. Një plan të veprimit 2016-2020 dhe ne po zhvillojmë këtë debat parlamentar me prezencën e vetëm një ministri këtu, sikur të ishte ky një problem i ndarë i shoqërisë sonë dhe pa prezencën edhe të dikastereve qeveritare, përgjegjëse për veprimin dhe luftimin e kësaj dukurie. Në atë plan të veprimit, e mendoj që edhe nga ky debat duhet të rezultojnë pastaj rekomandimet e duhura, të përfshihet parandalimi dhe vetëdijesimi, mbrojtja dhe koordinimi, legjislacioni, hetimi dhe procedimi i rasteve, rehabilitimi pastaj i atyre që është ushtruar dhunës në familje, riintegrimi dhe një plan veprimi konkret.

Pra, kur jemi te pozita e femrës në shoqërinë tonë mund të themi lirisht në fund të këtij debati, se pozita e femrës në shoqërinë shqiptare asnjëherë nuk ka qenë më e mirë se sa është sot, sepse e dimë pozitën e gruas dhe femrës shqiptare në vitet e kaluara. Por, kjo nuk mjafton, sepse duhet punuar edhe më shumë që ajo të jetë në pozitën e merituar dhe të kënaqshme. Pra, ne për pesë vjet kemi pasur presidente të Republikës së Kosovës, e cila na ka përfaqësuar në arenën ndërkombëtare dhe besoj se të gjithë ata janë ndjerë krenarë me prezantimin e presidentes në arenën kombëtare.

Ne ndihemi krenarë me të arriturat e Majlinda Kelmendit dhe të sportistëve tjerë. Jemi krenarë edhe me të arriturat e Rita Orës dhe Dua Lipës në kulturë, por po ashtu ndihemi krenarë edhe me Vlora Çitakun në politikë dhe prezantimin që ajo i bën Republikës së Kosovës në Amerikë dhe në Këshillin e Sigurimit në diplomaci. Ndhemi krenar dhe na bëjnë nder shumë deputete këtu sot të pranishme në Parlamentin e Kosovës dhe besoj shumë që për shumë të rinj e të reja janë motiv dhe përdoren si shëmbëlltyrë e mirë për angazhimin në politikë, sepse qasja e tyre profesionale, diskutimet, debatet dhe mbrojtja e shumë çështjeve me argumente këtu në Kuvend ka bërë që të shihen si promotore edhe të të drejtave të grave, por edhe mbrojtjes së vendit dhe luftimit të dukurive negative.

Është shumë me rëndësi që sa më shumë gra të ketë në qeverisje, sepse deri më tani ka rezultuar se gratë janë edhe më pak të korruptueshme dhe do të ndihmonin edhe në luftimin e një dukurie shumë të pranishme në vendin tonë dhe e domosdoshme për integrimin tonë në Bashkimin Evropian. Ne si politikanë, si përfaqësues të popullit, sa më shumë që punojmë për luftimin e këtyre dukurive dhe nuk e përdorim dhunën për arritjen e qëllimeve politike, kjo do ndikonte që dhuna pastaj të zvogëlohej edhe në dukuritë tjera në shoqërinë tonë. Pra, duke e përçarur një mesazh të argumentimit dhe ikjes së debateve dhe konflikteve dhe fyerjeve të panevojshme, ne e përçojmë një mesazh të tillë të e gjithë shoqëria jonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Fisnik Ismajli.

FISNIK ISMAJLI: Ishim në shpi, tue hangër darkë. Veç kur thanë: “Hynë te kojshitë. Hynë e po marrin burra e djem të rij”. S’kemi ditë gja, veç kur hynë edhe te na. Burri mule me u ikë për dritare. E vranë. Katër veta shprazën automata. Tue e gjuejtë, ma vranë edhe çikën. Ngat babës së vet kish qëllue. Mue më morën tue më ngrehë për flokësh. Ngreh e ngreh, zhag për tokë. Më futën në një xhip e më çuen në stacion të policisë.

Aty filluen. Në stacion. Mbas një kohe kur... kur e kryen ata... u çuem. Mbas katër orësh. Më lëshuen. Po, kah me ia mbajtë, kah me shkue? Qysh m’u kthye n’atë shpi, që m’u kish ba vorri i burrit, i çikës.

E robi si asht ma, a e ke pa? Si te nana që gjen mirë, nuk gjen kurrkund. E t'u nisa me shkue te nana. Kur mbërrij, krejt bijat aty.

Nana:

- Çka të ka gjetë? Çka je ba kështu?

Në fillim s'deshta me kallxue çka më kish ba vaki. As te shpia, as për... në stacion. Çka me i tmerrue edhe ma shumë këta? Po nana:

- Çka krisi mori në mahallën tuej?

Qaty më ka ra të ligët. U çue vllau, ma hoq të ligtit. Nisi unë po kallxoj, kadale, burrin, çikën qysh m'i vranë.

E, s'kemi ditë gja, veç kur të na erdhën edhe te vllau. Vllaun e lidhën, tue e rrehë e qitën. As s'ë kena pa, as ditë ma gja për te s'kena. Deri mbas lufte. Të na hynë mandej e po na marrin me bija. Nanën e rrehën. Para syve tonë ia kanë ba.

- O kuklla! Kqyrni, kqyrni, se edhe juve kemi me jua ba njisoj! - na thojshin në serbisht.

Na ngarkuen në kamion, e mandej, me kunatë, me halla, me teze, me çka qëlluem aty, na bájshin; sa andej, sa këndej.

E të na çuen te njifarë vendi, ish aty një... shkollë ish, po e kishin ba stacion të policisë. Herë i thojshin shkollë, herë stacion. Na kanë marrë rend. Si sot më kujtohet - një kallaballëk gra. Tap, e tap, e tap. Rend. Këtyne grave që nuk i lejshin, e nxirrshin thikën e iu sulshin.

Krejt trupin shenja thikash e kam. Krejt. Deri s'mujta me i ba ma ballë kurrnji sendi. Kur i shihsha motrat, kunatën, tezen, çikat e vllazënve, u lutsha: o Zot i madhi, le të na vrasin para se me na ba çka po na bajnë.

Aty, njani hyn e tjetri dil, njani hyn e tjetri dil, si të çmendun. Njani Jovan, e thirr tjetrin Jovan, e tjetrin prap Jovan.

Qitshin raki, qitshin ujë, edhe dofarë gjylpanash na i bajshin... Tash e di çka ishin ato. Atëherë s'ë disha. Qai, njani prej qatyne Jovan që i thojshin:

- Po ju japim me ju forcue! - se na pa hangër, pa pi, kurrë hiç kurrnja.

Kur e kishin krye atë punën e vet, qata ujë na e rrasshin me shishe në gojë, se na u pakshim prej keqtrajtimeve.

Prap na ngarkuen në kamion Mbas do ditësh. Lidhë kambë e duer, qashtu të përgjakta. Ka dy veta na ngjitshin me na shtie në kamion, se trohë takati s'kishim me lëvizë. Pesëmbëdhjetë kile pata ra.

Tue na hypë, po i pyesin do tjerë ndër ta:

- Kah këto, për kah?

- Për Zveçan p'i çojmë, se po i lypë Arkani!"

Ky ishte një ekstrakt, i dëshmisë së një grueje të dhunueme gjatë luftës. Një grueje që, qysh po tregon edhe vetë, nuk ishte e vetme.

Këtë libër, "Fëllanzat", ua lë në tavolinat tueja mbas këtij fjalimi. E ky libër është frymëzue nga një libër tjetër, me titull "Unë dua të dëgjohem", publikim i organizatave joqeveritare, Integra dhe ForumZFD, me rrëfimet e shumë grave të mbijetueme të torturës gjatë luftës se fundit në Kosovë, të cilin e gjeni në kutitë tueja.

Këto libra, të nderuem kolegë deputetë, janë pak a shumë krejt çka është bë deri sot për ato afro 20 000 gra të dhunueme gjatë luftës.

Këtyne grave ka vazhdue me iu dhunue dinjiteti për vite me radhë prej mbasluftës, nga vetë kjo shoqëri, e nga vetë ky shtet.

Hiç më larg se deputetë që hala janë në këtë sallë, në vitin 2014 patën votue kundër të drejtave të këtyne grave. Sot, 20 vjet më vonë, tek kanë fillue me u trajtue këto raste, e me u ndërmarrë hapa të vegjël për me kërkue drejtësi për to. Se qysh kemi me ua kthye dinjitetin mbas gjithë këtyne vitesh injorimi, kur as një kërkimfalje të vetme s'ua dha kush, unë nuk e di.

Vetëm e di se këto gra, këto heroina të cilat me një vullnet të paimagjinueshëm i janë kthye jetës në këtë shoqëri, me tanë përbuzjen, e me tanë mllefën që s'kanë mujtë me ia shprehë askujt, e kanë pasë tmerrësisht vështirë gjithë këto vjet, me fajin e krejt neve si shoqëri.

Sot, 20 vjet më vonë, është ironike, madje mua po më duket edhe hipokrizi, që na hala temat e dhunës ndaj grues i hapim vetëm me 8 mars, kur kjo duhet me qenë temë e çdo dite të lume të vitit. Një shoqëri që e shukatë me vjet dhunën e tmerrshme ndaj grues në momentet më të rënda të historisë tonë, ka tendenca me e shukatë edhe dhunën që ndodh sot në shumë shtëpi, për të

cilën na nuk dijmë kurrë. Deri të dëgjojmë në lajme se edhe një grue u vra nga burri sot, e dy javë më vonë i njëjti burrë ecë i lirshëm, pa therë në kambë.

E na? Na mbledhemi këtu vetëm mbasi të ndodhë tragjedia, e fëmijët mbesin pa nanë, sepse përveç që s'kemi mekanizma të drejtësisë për me e parandaluar këtë dukuni, e duke i liruar ata burra, na ua humbim guximin krejt atyne grave, të cilat sot me çivita në fytyrë të fshehuna në shtëpi, nuk guxojnë me e ngritë zanin ndaj dhunës që u bahet çdo ditë.

Të nderuem kolegë deputetë,

Detyra jonë kryesore, nëse vërtet dojmë me i ndihmue grues në këtë shoqëri, është me ua dhanë guximin me folë. Përderisa nuk thehet kjo heshtje, e përderisa piskamat e grues që rifet në kojshi mbetet punë private familjare, e jo problem shoqëror, rastet si të Dianës, Dafinës e shumë grave të tjera s'kanë me u ndalë.

Prandej, sot, në vend të urimit për ditën e grues, i baj thirrje çdo grueje, çdo burri, çdo kojshie, çdo vjehre e çdo nane, ME FOLË! Me e lajmëruar çdo rast të dhunshëm në familje. Nëse jo në polici, hajdeni te na, deputetët, sepse reagimi i juj sot, e shpëton një nanë nesër, e fëmijët nuk i rriten jetima.

Na qetu, në këtë sallë, e kemi për obligim me vepruar, jo vetëm me mbajtë fjalime, kur drejtësia dështon. Sepse, nëse dikujt i kemi vërtet borxh, janë gratë e nanat e kësaj shoqërie. Posaçërisht ato që u neglizhuen që 20 vjet. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Të nderuara dhe të respektuara gra të Republikës së Kosovës,

Sigurisht se edhe unë i bashkëngjitëm urimit të festës së 8 Marsit dhe do të doja që seanca të tilla herëve tjera të jenë në frymën edukative, ndoshta edhe frymëzuese e më shumë motivuese dhe të flasim për vlerësimin, kontributin e çmuar të gruas në shoqërinë e Kosovës, të arriturat e saj qoftë brenda edhe në arenën ndërkombëtare.

Sigurisht se kjo do të ishte edhe një mesazh më i mirë edhe për fëmijët, do të ishte edhe më edukative por do të ishte edhe më frymëzuese që gratë të kërkojnë të drejtat e tyre sipas ligjeve pozitive, ashtu siç e garanton edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, por edhe konventat ndërkombëtare. Andaj edhe sot kur diskutojmë besoj që nuk do të duhej ta biem në pikëpyetje rëndësinë, rolin apo edhe të drejtat që duhet t'i kenë gratë në republikën e Kosovës. Më shumë duhet të vëmë në pah të metat, qofshin ato legjislative, mbikëqyrjes parlamentare, por edhe të ekzekutivit të organeve të drejtësisë ndaj fenomeneve negative, që mbizotërojnë në Republikën e

Kosovës, sidomos në segmentin e asaj që po e quajmë dhunë familjare apo edhe një segmenti që është më pak i apostrofuuar - trajtimit të viktimave të trafikimit.

Unë po e shfrytëzoj praninë e ministrit të vetëm këtu që është e i cili është kompetent për një fushë të caktuar, pavarësisht që ka elemente të ngërthyera ligjore në trajtimin e strehimoreve për gratë e viktimave të trafikimit dhe do të doja që krahas kësaj të kemi, jo vetëm mbikëqyrjen parlamentare, sepse po ia filloj nga komisioni përkatës, nga deputetet dhe deputetët që pothuajse asnjëherë nuk i ka trajtuar Kuvendi i Kosovës strehimoret apo ato që quhen shtëpi të sigurta për viktimat e trafikimit.

Viktima të trafikimit nuk janë vetëm ato që nënkuptohen si pjesë e trafikimit të qenieve njerëzore, por janë edhe ato nga martesat e detyruara, nga puna e detyruar, nga shfrytëzimi i viktimave në raste të caktuara dhe besoj që ministri ndoshta do të kishte mundësi, që me dy fjalë të na drejtohet, a i ka vizituar personalisht ndonjëherë nga strehimoret në Republikën e Kosovës?

Nuk po e pyes në aspektin personal por në aspektin e trajtimit që i ka bërë Republika e Kosovës kësaj sfere, ta quaj, e cila më shumë është lënë në mëshirën e OJQ-ve dhe të mekanizmave apo partnerëve ndërkombëtarë, se si obligim i shtetit. Edhe pse, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar një ligj dhe nga ajo sa jam unë në dijeni, ekziston edhe një udhëzim administrativ për shtëpitë apo edhe për trajtimin ligjor të tyre, unë do dëshiroja që pjesa e sigurisë dhe qëndrimi i shtetit të Kosovës ndaj strehimoreve të arrijë në nivel tjetër, atë siç e kanë vendet demokratike. Ky do të ishte edhe zëri ynë dhe përkushtimi ynë, jo vetëm i grave deputete, jo vetëm i komisionit përkatës, por edhe i ministrisë edhe i vetëdijesimit të organeve të sigurisë.

Ajo që e tha një kolege këtu, nëse nuk gaboj zonja Mexhide, tha dhuna jo vetëm që nuk pranohet, por edhe nuk raportohet. Unë besoj se e tha me shumë të drejtë. Kjo na sjell edhe te faktet dhe te viktimat që kanë pasuar nga ajo që quhet tolerim i shkeljeve të të drejtave të njeriut. Kjo është në gjithë Botën, të jemi të sinqertë, sepse dhuna ndaj grave dhe vajzave mbetet një nga shkeljet më të rënda dhe fatkeqësisht më të toleruara të të drejtave të njeriut në Botë. Por, duke mos dashur që të përdor metoda krahasuese me vendet që kanë në aspektin negativ të trajtimit të gruas, unë do të dëshiroja që të kemi masa konkrete. Edhe këto debate të shfrytëzohen me masa konkrete, jo vetëm të debatojmë. Mos ta koncentroj në atë se vetëm në një profil të caktuar të kësaj problematike, as mos ta them që ta shfrytëzojmë në aspektin e publicitetit, çfarë e përdorim ne si politikë, por më shumë në shërbim të interesave dhe të mbrojtjes së grave, sidomos këto që janë të viktimave të trafikimit.

Unë, zoti ministër, ju kisha lutur që të kërkonti përkrahjen e Kuvendit, të kërkonti përkrahjen buxhetore, që strehimore në Republikën e Kosovës të kenë trajtim ligjor shtetëror, jo trajtim ligjor të OJQ-ve. Ajo nga e kaluara ka dhënë shembuj pozitivë, por ka dhënë edhe shembuj negativë. Në ato strehimore ka edhe nëna me fëmijë dhe është edhe pjesa edukative e asaj

gjenerate e cila pëson nga dhuna në familje, nga martesat e detyruara dhe nga viktimat e trafikimit. Kështu që, këto probleme ne duhet t'i vëmë në sipërfaqe, në sipërfaqe të aspektit ligjor dhe të aspektit ekzekutiv të masave të cilat duhet t'i marrë ekzekutivi, duke marrë parasysh që këtu mungon edhe qasja e sektorit të drejtësisë, neglizhenca, trajtimi i tyre, ku fatkeqësisht pa i përmendur ato rastet më të rënda, humbja e jetës siç ishte edhe e Dianës, Zejnepes e të tjera.

Unë po e përfundoj me një mesazh më të mirë, jo vetëm të vetëdijesimit, jo vetëm të ngritjes së zërit për datën 8 Mars, por të obligimit ligjor dhe obligimit që ka Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbikëqyrjen parlamentare të implementimit të ligjeve, të cilat janë pozitive në Republikën e Kosovës. Ndërsa, dhuna në familje, aspekti i trafikimit të qenieve njerëzore është negativ në raport me legjislacionin pozitiv dhe këtu është ajo pikëpyetja e madhe se kah duhet ta orientojmë ne zërin tonë dhe kah duhet ta orientojmë ne ndikimin tonë, pa dashur t'i harrojmë edhe atë që është më e ndjeshme, viktimat që kanë qenë pjesë e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri Reçica. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar deputet Zemaj,

Përveç qendrave për punë sociale si organe shtetërore që kanë për obligim ligjor përkujdesjen ndaj rasteve sociale, por edhe ndaj rasteve të viktimave të dhunës në familje, qoftë gra, qoftë fëmijë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të kompetencave të saj ka të licencuara disa organizata joqeveritare, konkretisht strehimore që ofrojnë strehim 24 orë për viktimat e dhunës në familje, gra apo fëmijë.

Situata në këto strehimore që ofrojnë shërbim 24 orë nuk është më e mira, sipas mendimit tim. Ekipi im ka vizituar disa nga këto qendra. Nuk kam arritur personalisht t'i vizitoj, por ekipi im ka vizituar disa nga këto qendra dhe ua rikujtoj se në janar të këtij viti me kërkesë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Qeveria e Kosovës ka miratuar një vendim me të cilin i ka akorduar 65 000 euro për këto organizata për t'u dalë në ndihmë në ushtrimin e veprimtarisë, konkretisht në mbikëqyrjen që ofrojnë për kategoritë e cenuara si rezultat i dhunës në familje.

Po e përsëris, nuk është situata më e mira në këto strehimore, por e kemi trashëguar një situatë të tillë dhe po përpiqemi ta bëjmë më të mirën për to.

Aktualisht, e thash edhe në fjalimin e mëhershëm, jemi duke punuar dhe jemi në fazën finale të thirrjes që për këto organizata të cilat janë të licencuara dhe ofrojnë shërbim për këto kategori, të ofrojmë një buxhet që do të jetë i mjaftueshëm për zhvillimin e veprimtarive të tyre karshi numri të viktimave, të cilat ofrojnë përkujdesje. Unë mendoj që nuk mund të realizohet, nuk mund të zgjidhet kjo situatë duke financuar organizatat joqeveritare, pajtohem plotësisht me të. Në çdo

diskutim timin e nxjerr çdo ditë e më tepër në publik, që ne duhet të punojmë më tepër në drejtim të krijimit të grandit specifik për qendrat për punë sociale dhe vetëm atëherë ne mund, në njëfarë mënyre, të flemë të qetë sa i përket trajtimit të rasteve sociale dhe trajtimit të viktimave të dhunës në familje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Në këtë ditë të shënuar për gratë 8 Marsin është me rëndësi që Kosova ka një legjislacion mjaft të fuqishëm, që mbron, ka mbrojtur po ashtu, edhe gratë dhe gruan. Në këtë ditë urojmë që ky 8 Mars dhe 8 marset që do të vijnë për gratë të jenë më të mirë, më të shënuar, më të mbrojtur, më të avancuar. Një fjalë thotë, që guximin nuk ta jep askush, nuk mund ta falë, atë duhet ta kesh dhe për atë duhet të luftosh për qëllimin tënd. Të njëjtën kohë edhe gruaja duhet të angazhohet në përmirësimin e kushteve më të mira për to.

Ne si shqiptarë na njih mjaftë mirë historia dhe na njohin civilizime të ndryshme botërore të kohëve të hershme dhe të tashme për këto avancime dhe këto mbrojtje dhe mbrojtja e femrës po ashtu, nëse ka pasur dikush më herët, ne kemi pasur mbretëreshë Teutën, që nga Iliria. Nëse ka pasur edhe më herët, po ashtu kemi të mbrojtura mjaftë. Këto civilizime kanë ardhur në kohëra të ndryshme, ndërsa te ne gruaja ka qenë e barabartë nga historia deri në ardhjen e pushtesve osmanë në Ballkan. Diskriminimi këtu fillon, po tash a duhet dhe si duhet të mbrohet.

Kuvendi i Kosovës ka me dhjetëra ligje për mbrojtje dhe nuk mbrohen. Për mua është me rëndësi që në këtë Kuvend diskutohet, debatohet për dhunën në familje, por vendet e tjera kanë më shumë dhunë, se sa kemi ne. Edhe ato që konsiderohen më të civilizuara, më demokratike, edhe ato kanë ligje, edhe ato kanë shtete më të fuqishme. Por, megjithatë ne kërkojmë ta mbrojmë përsëri. Intelektualët tanë kanë folur më herët dhe shumë herët kanë folur për mbrojtjen e gruas, për edukimin e saj, për kulturën e saj, për mentalitetin e zhvilluar politik dhe kulturor shqiptar të saj, për veshjet, për doket, zakonet, kanunet, për të gjitha. Të gjitha këto kanë qenë pjesë dhe modele që janë marrë.

Mendoj që të gjitha këto i ka thënë edhe me një fjalë mjaft të mirë ideologu i rilindjes kombëtare, Sami Frashëri, sa është e edukuar gruaja, aq është i emancipuar populli. Këtë e tha edhe Milaim Zeka më herët. Megjithatë, themi që këtë e ka thënë Sami Frashëri, po ai e citoi.

Për neve unë po kërkoj që ata që e kanë thirrur këtë debat ta kenë parasysh monitorimin e ligjeve dhe avancimin individual. Femra në Kosovë është e mbrojtur. Në bazë të Agjencisë së Statistikave që e kemi ne është më e mbrojtura në gjithë rajonin. Ka më pak dhunë në familje, se në gjithë rajonin, ka më pak dhunë se ndoshta edhe në disa shtete evropiane, që i marrim si

model, në daç te italianët, në daç te spanjollët, në daç edhe të tjerët, me përjashtimet që ka edhe më të mbrojtura.

Për ne edhe një herë, Agjencia e Statistikave thotë, për përqindjen e grave që janë ato me 80%, mbi 80%, janë më të mbrojtura dhe më të sigurta. Prandaj, nuk kemi çka shtojmë këtu. Shtojmë vetëm se gruaja ka pasur dhe ka një vend të veçantë në gjithë historinë e kombit tonë, ka qenë e paprekshme, e barabartë dhe e mbrojtur çdoherë, prandaj këto ligje që i kemi bërë dhe këto civilizime e kanë diskriminuar dhe e diskriminojnë vazhdimisht. Prandaj, kërkujmë që ky debat ta ketë një përfundim, e ai të jetë një avancim i gruas dhe, po ashtu, për mbrojtjen e familjes, ose dhunës në familje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi. Më fal Rexhep, replikë ka kërkuar deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Rexhë, më fal, veç 30 sekonda! Shkurt!

Faleminderit, deputet!

Kam vetëm një si pyetje për Mimoza Kusarin, që ajo vjen flet e tani ik, kurrë nuk rri në sallë pas fjalimit.

Në qoftë se ma gjen një ligj në një vend evropian, ku thuhet se parlamenti ia imponon një ndërmarrjeje private se kush duhet të jetë drejtor, ose në bord, dhe proporcionin femra a meshkuj, unë i jap çka të donë, një. Dhe, e dyta, kisha pasur dëshirë në seancën e ardhshme të më përgjigjet mimoza, kur ka qenë ministre sa prej këshilltarëve të vet i ka pasur femra? Faleminderit, kryetar!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro, Rexhep!

REXHEP SELIMI: Një kolege imja me të drejtë tha që kur del kryeministri këtu, tha ai drejtohet me fjalën “burra”. E në fakt, ashtu më duhet ta nis unë sot, se në fakt unë kam mesazh për burrat këtu e jo vetëm për këta këtu, por për gjithë burrat.

Por, paraprakisht dua t’ua uroj 8 Marsin nënave, motrave, vajzave të gjithë Kosovës dhe gjithë shqiptarëve. Fillimisht duke e nisur me një thënie që vlen zakonisht për ushtritë, por po e përsëris se ndoshta vlen edhe për deputetet. Udhëheq sipas shembullit, unë do të doja të kërkoja prej të gjithë atyre burrave që janë përkushtuar më 8 Mars për nënat, gratë, vajzat, motrat, shoqet, koleget... ta bëjnë këtë përditë, jo vetëm më 8 mars dhe mund ta bëjnë kudo që janë tani, kudo që janë më 9 mars, 10 mars e gjithmonë, duke filluar që edhe t’i respektojmë por mbi të gjitha të japim shembull ne burrat se si duhet të respektohet, të nderohet nëna, gruaja, motra, femra, njerëzore në përgjithësi.

Prandaj, unë sot këtu ndoshta jam me shkas më shumë se sa me shkak, për të thënë edhe një herë se ne burrave na takon që ta japim shembullin, jo t'u japim dhe të falim të drejtat, por t'ua respektojmë të drejtat atyre, sepse ne as s'mund t'ua marrim e as s'mund t'ua japim. Edhe një herë, urime 8 Marsi për të gjithë, por kërkoj angazhim dhe përkushtim, jo vetëm respekt dhe lule për 8 Mars por përkushtim për çdo ditë për ato që kanë nevojë dhe dua të manifestoj edhe një herë që burrat nuk janë më të fortë se gratë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është deputeti Lumir Abdixhiku. Urdhëro!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputete e deputetë, faleminderit që qëndruat deri në fund për një debat shumë substancial.

Unë nuk do të flas sot për dhunën fizike ndaj gruas në familje, sepse besoj se u tha mjaft për sot, por diskutimin tim do ta drejtoj drejt një dhune tjetër, asaj ekonomike, që sot në gjendjen që është duhet të na alarmojë të gjithëve.

Do të mjaftonte një vështrim i shpejtë, i thjeshtë në historikun e tranzicionit tonë ekonomik si shoqëri, pra këto 19 viteve të fundit, për të kuptuar se në thelbin e ecjes sonë qëndron pabarazia. Pra, në parime të pabarazisë trajtuese është ndërtuar edhe kjo shoqëri e jona, sepse kur e shikon çështjen e tatimeve e kupton pabarazinë në pagesën e tyre, kur e shikon çështjen e dënimeve e kupton pabarazinë në shqiptimin e tyre, kur e shikon paranë publike e kupton pabarazinë në shpërndarjen e tyre dhe kur shikon punësimin publik e kupton pabarazinë në pranimin e individëve.

Lista e pabarazisë trajtuese të qytetarëve kosovarë është e gjatë. Në gjithë mozaikun pabarazues ka një të tillë, që dallohet e veçohet më shumë. Kjo pabarazi kalon përtej tatimeve, dënimeve, parasë e punësimit publik, është uniforme për një grup të tërë shpërndarë tek të gjithë. Është e qartë se pabarazia më e madhe e krijuar dhe e mirëmbajtur në vend ka karakter gjinor, është pabarazia ndaj gruas. Nëse ka një pabarazi në trajtimin e tatimeve do të ketë një shtesë në trajtimin gjinor brenda trajtimit të tatimeve, nëse ka një pabarazi në shpërndarjen e parasë publike do të ketë një veçim shtesë për gratë brenda trajtimit të shpërndarjes së parasë. Nëse ka një pabarazi në punësim për të gjithë, do të ketë një shtesë tjetër më shumë, për gratë në veçanti.

Ka mbi një dekadë e gjysmë që merremi me adresimin e numrave me interes publik dhe si ekonomist jam interesuar gjithmonë të shoh tregimin që numrat sjellin në vete. Por, në llogaritjen e numrave një grup i tyre në veçanti ka dhënë në vazhdimësi një fotografi alarmante dhe aspak të këndshme, ai i gjendjes së gruas në punësim e aktivitet ekonomik. Sot në Kosovë plot 81% e grave të moshës së punës janë joaktive. S'marrin pjesë aktivisht në treg të punës hiç, thënë

ndryshe rrinë në shtëpi, 81% e grave të Kosovës rrinë në shtëpi. 474 000 gra të moshës së punës prej 18-65 vjet rrinë në shtëpi.

Për ta përkthyer këtë përbërje në sallë të këtij Parlamenti do të thoshte që vetëm dy rreshtat e parë të kësaj salle do të ishin aktivë. E sa për krahasim vetëm 40% e meshkujve janë joaktivë. Joaktiviteti kaq i lartë i grave në moshë pune është alarmant për Kosovën, e vë vendin tonë në pozitë shumë më të rëndë krahasuar me rajonin. Në rajon, në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi e Serbi vetëm 52% e grave janë joaktive. Pra, gati sa gjysma e vendit tonë. Kosova vendoset shumë më keq krahasuar me gjithë Evropën. Madje, vendoset keq po krahasuar me gjithë Amerikën Latine, gjithë Afrikën e pjesën më të madhe të Azisë. Për ta thënë më thjeshtë, sipas të dhënave zyrtare të Bankës Botërore janë vetëm 5 vende të tjera në Botë që kanë normë kaq të lartë joaktiviteti sa ka Kosova, 4 prej të cilave janë në gjendje lufte. Siria, Iraku, Palestina e Afganistani kanë normë joaktiviteti 85%, Kosova ka 81%.

Gjendja e Kosovës në këtë fushë është e barabartë me gjendje lufte. Po atëherë, pse Kosova ka një normë kaq të lartë joaktiviteti, pse 81% e grave të moshës së punës rrinë në shtëpi? Pjesa më e madhe e grave joaktive deklarohen se është përkujdesja ndaj shtëpisë, fëmijëve e familjes që parandalon aktivitetin e tyre, pra kërkesa shtëpiake janë një arsye, por përveç kësaj pasiguria eventuale në punë, punë që këto gra vështirë e marrin përbën arsyen e dytë. Të dekurajuar skajshmërisht, rrjedhimisht mbetin joaktive. Joaktiviteti përbën një problem, por aq shqetësues e i rëndë mbetet edhe raporti i punësimit brenda atyre pak grave që janë aktive. Pra nga ato gra që janë aktive, vetëm 19%, vetëm gjysma punojnë. Për ta përkthyer në numër, sot në Kosovë vetëm 12% e grave punojnë. Vetëm një nga 10 gra në moshën e punës punon. Nga dhjetë gra, pra njëra është e punësuar, njëra është e papunë, tetë rrinë në shtëpi.

Por, një proporcion i tillë s'vlen për burrat. Burrat që janë numër përafërsisht i njëjtë, përveçse janë më aktivë janë edhe më të punësuar. Në numra të gjithëmbarshtëm çdo i dyti mashkull është i punësuar. Një raport si ky tregon mjaft për shoqërinë tonë, për atë se ku është dhe mbi të gjitha se çfarë humb nga humbja e gjysmës së popullsisë së saj.

Pabarazia ndaj gruas nuk përfundon me kaq. Ato gra që punojnë, rreth 76 000 sosh në gjithë Kosovën, kanë kontrata më të rënda, më afatshkurta, më pak kompensuese e shumë herë më të pasigurta. Për punën e njëjtë, vendin e njëjtë të punës, nivelin e njëjtë të edukimit një grua paguhet më pak se një burrë. Sot, përderisa një burrë merr 1 euro, një grua i merr 0,93 centë. Mbi 77% e grave të anketuara në Kosovë tregojnë se përkundër nivelit të njëjtë të edukimit e kualifikimit, ato paguhet më pak se partnerët e tyre.

Një shqetësim tjetër në rritje është përhapja e kontratave afatshkurta dhe më vjen mirë që ministri është sot këtu, ne veçanti për gra. Vetëm 7% e grave në Kosovë në sektorin privat kanë kontratë më të gjatë se njëvjeçare, pjesa më e madhe e tyre, rreth 90%, që kanë një kontratë pune,

kanë afat më të ulët se sa 10 000 orë të vlefshmërisë. Kontrata të tilla nën njëvjeçare ndërtohen për t'u shmangur qëllimisht kontributeve eventuale, që ndërlidhen me Ligjin e punës dhe pushimin e lindjes. Përkujdesja për fëmijë sot vlen vetëm për gra, prandaj 80% e grave të punësuar në sektorin privat janë të brengosura se mund të humbin vendin e tyre të punës në vitin në vijim. Është pikërisht kjo pasiguri, kjo pabarazi, që bën një përpjekje për aktivitet të gruas tërësisht joatraktiv.

Për paradoksin më të madh, kjo pasiguri është ushqyer në vazhdimësi edhe me Ligjin e punës, në veçanti nga Ligji mbi pushimin e lindjes. Shteti i Kosovës, ky Parlament, i nisur nga një qëllim i mirë, nuk ka llogaritur fare dy elemente të rëndësishme që ndodhin rëndom me implementime të ligjit në Kosovë. I pari me koston që njëjtë implikon në sektorin privat, i dyti me paaftësinë e shtetit për të mbikëqyrur implementimin e tij.

Së këndejmi, një ligj i tillë që funksionon në mënyrë perfekte në sektorin publik, është i paimplementueshëm në tërësi në sektorin privat, duke shkaktuar kështu zvogëlimin e numrit të grave të punësuar në të, që nga implementimi i tij.

Joaktiviteti gruas, punësimi i ulët i saj, trajtimi i pabarabartë në mes burrave dhe grave në pagesë e kompensim, si dhe mbi të gjitha pabarazia trajtuese në mes të gruas në sektorin publik e asaj në sektorin privat, janë indikatorë të qartë gjithësesi të trishtueshëm mbi ngecjen shoqërore tonën. Vendi ynë nuk arrin të trajtojë gjysmën e qytetarëve njëjtë dhe përderisa s'trajtojmë gjysmën tonë njëjtë, humbim gjysmën e potencialit ekonomik, ndërmarrës e të punës. Jemi gjithmonë gjysmë potenciali prapa. Ka disa faktorë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm që kjo shoqëri duhet të ndërmarrë në tërësi për të normalizuar gjendjen tonë alarmante që na mban në rang me Sirinë e Afganistanin.

Modernizimi i familjeve kosovare janë të nisur nga ndarja e barabartë e pasurisë e deri tek mundësitë e barabarta për shkollim e karrierë janë domosdoshmëri, siç është domosdoshmëri sistemi më i avancuar edukativ apo hapja e çerdheve e qendrave për kujdes për fëmijë, sidomos nëpër zonat rurale të Kosovës. Madje, për këtë të fundit do të na duhej një plan nacional. Por, mbi të gjitha, ka një masë që është e pazëvendësueshme, ajo ka të bëjë me bërjen atraktive të vendit të punës për gratë. Së pari, me ndryshimin e Ligjit të punës, në veçanti me futjen e pushimit prindëror. Së dyti, jo më pak e rëndësishme, Kosova duhet t'i rrisë kapacitetet vëzhguese të implementimit të Ligjit të punës. Sado që të duket klishe, me nivelin e tanishëm të inspektiveve secila kontratë e secili ligj ka gjasa zero të implementohet.

Kam dëgjuar në vazhdimësi, se kur përmendet çështja e pushimit prindëror përgjigja është se Kosova s'është Skandinavi, por Kosova s'mund të jetë as Siri, as Palestinë e as Afganistan dhe nëse na duhen masa radikale për ndryshim të normave shoqërore, atëherë pse mos t'i marrim masat e tilla menjëherë. Ndarja e pushimit në mes prindërve do të bëjë ndarjen e koston së

punësimin gjinor. Pra, për sektorin punësues privat eventualisht do të bëhet e njëjta marrje në punë si për një burrë dhe një grua dhe përfundimisht, do të reduktonim numrin alarmant të joaktivitetit të gruas në Kosovë. Edhe një herë, 81% është numër alarmant për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka kolegë tjerë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Kështu që, unë ftoj propozuesin e çështjes, deputeten zonjën Kollçaku që pas diskutimeve të paraqesë dhe të arsyetojë projekt-propozimin, rekomandimet. Me sa di unë, grupet parlamentare kanë harmonizuar tekstin e rekomandimeve. Urdhëro!

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Pas harmonizimit të tekstit të Rezolutës me grupet parlamentare para jush, kolegë deputetë, paraqes këto:

R e k o m a n d i m e:

1. Rishikimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje;
2. Ndryshimi në Kodin Penal dhe të procedurës penale për veprën penale të dhunës në familje, si dhe fuqizimi i mekanizmit koordinues për parandalimin dhe ndjekjen penale të dhunës në familje, përfshirë dëmshpërblimin për dëmet emocionale të viktimave të dhunës në familje dhe viktimave në baza gjinore;
3. Të zbatohet në tërësi strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe plani i veprimit 2016/2020, sidomos nenet që kanë të bëjnë me riintegrimin e viktimave të dhunës në familje, si dhe rishikimi i këtyre dokumenteve për të reflektuar ndryshimin në legjislacionin konform pikave 1 dhe 2 të kësaj rezolute;
4. Avancimi i kurrikulave arsimore për edukimin e nxënësve për rëndësinë e barazisë gjinore, si dhe eliminimi i rasteve në kurrikula, ku referohet dhuna në familje si mjet komunikimi;
5. Përfshirja e strehimoreve në planifikimin e ardhshëm buxhetor për vitin 2019 dhe shqyrtimi i mundësisë për ndihmë të jashtëzakonshme me rishikim të buxhetit për vitin 2018;
6. Avancimi i buxhetimit të plotë gjinor në të gjitha institucionet;
7. Programe të qarta dhe marrje parasysh e aspekteve të barazisë gjinore në ministrinë e linjës, që mbështesin gratë në biznes dhe punësim, përfshirë programe për riaftësim profesional dhe inkuadrim të grave në tregun e punës;

8. Mbështetje politike për programe sociale dhe strehim të viktimave, do të thotë strehim afatgjatë të viktimave të dhunës në familje; dhe

9. Mbështetje e qendrave për punë sociale për ofrimin e shërbimeve këshilluese për familje si masë e parandalimit të dhunës dhe ndarjeve të familjes.

Ne presim që Qeveria t'i marrë shumë seriozisht këto rekomandime të dala nga kjo rezolutë, si dhe ne si deputetë besoj se do të zotohemi, që në përpikëri dhe me konsekuencë do ta ndjekim realizimin e tyre.

Prandaj, ju ftoj të gjithë juve që ta miratojmë këtë rezolutë, sepse është e një rëndësie të veçantë. Sa i përket kuorumit është çështje tjetër, por besoj se kjo rezolutë duhet të miratohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, në sallë janë 40 deputetë. Do të thotë që ne s'kemi kuorum që të procedojmë më tutje, kështu që detyrohemi ta ndërpresim seancën këtu. Për kohën e vazhdimin do të vendosë Kryesia e Kuvendit.

Por, unë lus propozuesin që rekomandimet me nënshkrime të shefave të grupeve parlamentare t'ia japë Administratës, që t'i shpërndajë për të gjithë deputetët, në kutinë e secilit. Mirupafshim!

* * *

E enjte, 15 mars 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 8 mars 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Nga seanca plenare, e mbajtur më 8 mars 2018, ka mbetur pa përfunduar:

- Votimi i propozim-Rezolutës në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional

Diskutime kanë përfunduar. E hap votimin, Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatohet që kanë votuar 71 deputetë dhe Kuvendi me 69 për, 1 kundër, 1 abstenim e miratoi Rezolutën në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional.

Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*